



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3257/ 9 prot

Datë 20.01.2026

V E N D I M
Nr.104/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.01.2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*REJ*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-62426-09-23-2025*, me objekt: “*Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës*”, me fond limit 245,035,563.59 (*dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë*) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (*dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë*) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*AIR*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Clean Fast*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*CLEAN FAST*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: “*Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës*”, me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*AIR*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: “*Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës*”, me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 2010.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*AIR*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*REJ*” SHPK me NIPT: J93711608Q dhe me adresë: *Rruga “Dritan Hoxha”, Ngjitur*

me Shkollën "Ahmet Gashi" Kulla Jeshile, Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, H, Tiranë.

Operatori ekonomik "Clean Fast" SHPK me NIPT: L61807037R, dhe me adresë: *Bulevardi "Bajram Curri", Godina ETC, Kati 13, Tiranë.*

Operatori ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK me NIPT: K91413010N, dhe me adresë: *Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga "Fatmir Haxhiu", Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I Tiranë*

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Subjekte të interesuar:

Operatori ekonomik "AIR" SHPK me NIPT: L51712008C, dhe me adresë: *Rruga "Siri i Kodra", Nr. 8340, Nr. Pasurie 5/450, Njësia Administrative Nr.8, Tiranë.*

Operatori ekonomik "Clean Fast" SHPK me NIPT: L61807037R, dhe me adresë: *Bulevardi "Bajram Curri", Godina ETC, Kati 13, Tiranë.*

Operatori ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK me NIPT: K91413010N, dhe me adresë: *Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga "Fatmir Haxhiu" Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I Tiranë.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim

e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

1.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

1.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë interes për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

1.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

1.5. Operatori ekonomik ankimues “*REJ*” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

1.6. Operatori ekonomik ankimues “*Clean Fast*” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

1.7. Operatori ekonomik ankimues “*Pastrime Silvio*” SHPK nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.09.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: “Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e

pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

II.2. Në datë 20.10.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi fazën e parë të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, ku shprehën interesin operatorët ekonomikë, si më poshtë vijon:

1. *Operatori ekonomik "AIR" SHPK*
2. *Operatori ekonomik "Clean Fast" SHPK*
3. *Operatori ekonomik "REJ" SHPK*
4. *Operatori ekonomik "NRG" SHPK*
5. *Operatori ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK*

II.3. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) konstatohet, se në datën 04.11.2025 operatorët ekonomikë të cilët kanë shprehur interesin në fazën e parë në procedurën e prokurimit objekt - ankimi janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të shprehjes së interesit, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|---------------------|
| 1. <i>Operatori ekonomik "AIR" SHPK</i> | <i>kualifikuar</i> |
| 2. <i>Operatori ekonomik "Clean Fast" SHPK</i> | <i>skualifikuar</i> |
| 3. <i>Operatori ekonomik "REJ" SHPK</i> | <i>skualifikuar</i> |
| 4. <i>Operatori ekonomik "NRG" SHPK</i> | <i>skualifikuar</i> |
| 5. <i>Operatori ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK</i> | <i>skualifikuar</i> |

II.4. Në datën 04.11.2025, operatori ekonomik "REJ" SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin në fazën e parë të shprehjes së interesit, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

"1. Operatori ekonomik "Rej" sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës", nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:

- *Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;*
- *Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;*
- *Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.*

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklaratimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.

KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues

dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane të vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Permbledhës i Vetedeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj duke dhënë deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të cilit autoriteti mund të bëjë verifikimin e vetedeklarimeve dhe mosplotësimi i tij në të gjithë seksionet përkatëse perben kusht skualifikimi”.

Te njëjtin qendrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, date 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, date 17.09.2025.

Per sa me sipër operatori ekonomik skualifikohet.

2. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. nuk ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7, e cila përcakton se:

“Operatori ekonomik ofertues, për solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues të renditura në pikën 3, 4, 5, dhe 6 të Seksionit 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit, Shtojca 8, duhet të paraqesë: dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.”

Në përmbushje të kësaj kërkesë, operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim datë 09.10.2025, të lëshuar nga shoqëria “GET klin” sh.p.k., me NIPT: L82420502U, i cili paraqitet në dokument si prodhues i detergjenteve, së bashku me dokumente MSDS për produktet përkatëse.

Nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në rubrikën “Leje/Licenca të lëshuara nga QKB”, rezulton se subjekti “GET klin” sh.p.k., NIPT: L82420502U, nuk është i pajisur me Leje/Licencë për Prodhim të Detergjenteve dhe nuk është i pajisur me asnjë lloj Licence tjetër si prodhues apo leje mjedisore si prodhues i Detergjenteve sipas nenit 4 të Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe Shtojcën 1 të këtij ligji (ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020), ku përcaktohet qartë se: “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzjerja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”

Kjo do të thotë se, çdo subjekt që ushtron aktivitet prodhimi ose përpunimi të detergjentëve, duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzjerja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”, të lëshuar nga autoritetet kompetente.

Në mungesë të një Leje që vërteton se kjo shoqëri është prodhues i produkteve detergjentë, rezulton se MSDS-të nuk janë të lëshuara nga prodhuesi, siç kërkohet shprehimisht nga dokumentet e tenderit.

Për rrjedhojë, KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.7, pasi dokumentet e paraqitura nuk i referohen një prodhuesi të ligjshëm të detergjentëve, duke mos garantuar kështu përmbushjen e specifikimeve teknike dhe kërkesave të sigurisë të parashikuara në tender.

Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, operatori

ekonomik "REJ" sh.p.k. skualifikohet nga procedura e prokurimit.

3. Operatori ekonomik "REJ" sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr.3 ("Solucion zbardhues që përdoret për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve") produktin "Rea Triplex", të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga "Get Klin" sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kërkesat e Specifikimeve Teknike për arsyet si vijon:

- Dokumentacioni i paraqitur nuk përmban asnjë referencë që produkti të përdoret specifikisht për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve, siç kërkohet shprehimisht në DST.
- Nuk përmendet se produkti heq pikat e bardha të ujit (lloji i mbetjeve gëlqerore që formohen në sipërfaqe sanitare).
- Nuk jepen udhëzime për raportin e hollimit 1:150–1:200 me ujë, siç kërkon specifikimi teknik. (Në specifikimin teknik të dokumenteve të tenderit kërkohet që produkti të përdoret edhe për larjen e pllakave të poshtme të tualeteve me hollim 1:150 – 1:200 me ujë. Në MSDS-në e paraqitur nga operatori ekonomik për produktin "Rea Triplex", nuk jepen udhëzime mbi raportin e hollimit ose mënyrën e përdorimit të produktit në kushte të aplikimit praktik.
- Dokumenti nuk provon se produkti bën pjesë në një linjë profesionale pastrimi, siç kërkohet për produktet e kategorisë sanitare industriale dhe sic specifikohet në nenin 2 "Perkufizime", pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 "Per Detergjentet" në të cilin percaktohet se: "Detergjent industrial" është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake."

Për sa më sipër, produktit "Rea Triplex" i mungon përputhshmëria e plotë teknike dhe dokumentare me kërkesat e artikullit 3 të Specifikimeve Teknike dhe me kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7 (MSDS të lëshuar nga prodhuesi).

Si rrjedhojë, operatori ekonomik nuk konsiderohet përmbushës për këtë artikull dhe produkti nuk mund të merret në konsideratë për përmbushjen e kërkesave të kontratës.

4. Operatori ekonomik "REJ" sh.p.k. ka paraqitur, për artikullin nr. 4 ("Solucion për larje pllakash dysHEMEJE"), produktin "Rea Triplex", të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga "Get Klin" sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 "Specifikimet teknike", që lidhen me solucionet e renditura në pikat 3, 4, 5 dhe 6 "Solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues", për arsyet si më poshtë:

Sipas specifikimeve teknike, për artikullin Nr.4, kërkohet: "Solucion për larje pllakash dysHEMEJE. Të jetë sa më i koncentruar (1:200 me ujë). Të lërë aromë të lehtë pas larjes. Të jetë prodhim me standarde

të BE-së dhe i certifikuar sipas këtyre standardeve. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Masa nga 1 deri në 10 litra. Të jetë linjë profesionale.

Niveli i pH (8 +/- 5%).”

Operatori ekonomik i referuar më sipër ka paraqitur MSDS për produktin “Solo Pavimenti IL”, i cili, sipas dokumentit, është zbardhues dhe dezinfektues. Nga analiza rezulton se ky produkt nuk përmbush specifikimet teknike të publikuara në DST për këtë produkt, pasi:

- Nuk jep udhëzime për hollim 1:200 me ujë, siç kërkon specifikimi teknik;
- Nuk jep asnjë informacion që vërteton se produkti është pjesë e një “linje profesionale”, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: “Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”. Në dokument nuk identifikohet asnjë referencë ndaj përdorimit industrial ose profesional,
- Mungojnë të dhënat për certifikimet ose standardet e aplikueshme (p.sh. EN, ISO, ose CE), që të konfirmonin klasifikimin e produktit sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

5. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr. 5 (“Solucion për larje xhamash”) produktin “Rea Cristal”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, për arsyet si më poshtë:

Sipas pikës 5 të specifikimeve teknike, kërkohet:

“Solucion për larje xhamash (me spray). Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Masa të jetë 500–800 ml me spray. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8.5–9).”

Nga shqyrtimi i MSDS-së së produktit “Rea Cristal” rezulton se:

- Megjithatë, MSDS nuk përmban asnjë informacion për masën, paketimin apo ekzistencën e mekanizmit “spray” (500–800 ml), që është kërkesë eksplicite e DST-së;
- Dokumenti është përpiluar nga një subjekt vendas dhe nuk vërteton se produkti është “prodhim me standarde të BE-së”, siç kërkohet në DST;
- Në MSDS nuk specifikohet klasifikimi profesional i produktit (“përdorim profesional”), çka nuk lejon verifikimin nëse produkti i përket “linjës profesionale” të kërkuar dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”;

Për rrjedhojë, operatori ekonomik skualifikohet pasi nuk përmbushë kriteret e kualifikimit.

6. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr. 6 (“Solucion për larje mobiljesh”) produktin “Ana Mobilje”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori

nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, që lidhen me solucionet e renditura në pikat 3, 4, 5 dhe 6 “Solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues”, për arsyet si më poshtë:

Sipas pikës 6 të specifikimeve teknike, kërkohet:

“Solucion për larje mobiljesh (me spray) 500 ml. Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8–9).”

Nga analiza e MSDS-së së produktit “Ana Mobilje” rezulton se:

- Dokumenti nuk përmban asnjë informacion mbi origjinën ose certifikimin e produktit, dhe nuk provon se është “prodhim me standarde të BE-së” apo i certifikuar sipas ndonjë standardi të miratuar nga BE;

- MSDS-ja nuk përcakton qartë nëse produkti është “linjë profesionale”, pra nëse është i destinuar për përdorim profesional apo konsumator, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Për Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”;

Persa me sipër, operatori ekonomik skualifikohet.

7. Operatori ekonomik “REJ” Sh.p.k, nuk ka paraqitur autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për lëndët biocide që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit. Sipas pikës 2.3.8 të specifikimeve teknike, çdo ofrues që përdor lëndë biocide duhet të vërtetojë lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar dhe të sigurojë të dhënat e plota të kontaktit për verifikim nga Autoriteti Kontraktor. Sipas analizës së specifikimeve teknike, përdorimi i lëndëve biocide është I paevitueshëm, sepse shërbimi objekt prokurimi kërkon dezinfektim dhe kontroll të mikroorganizmave patogjenë si psh në Sallat e Operacionit, në Ambjentet e Kujdesit Intesiv dhe në ambjentet e tjera Spitalore që janë me risk shumë të lartë infektimi, për të garantuar standardet e sigurisë dhe higjienës të përcaktuara. Pa përdorimin e biocideve të autorizuar, nuk mund të arrihet niveli i kërkuar i pastrimit dhe mbrojtjes, çka e bën të pamundur përmbushjen e kushteve teknike të kontratës. Për shkak të mungesës së dokumentacionit të autorizimit përkatës, oferta skualifikohet.”.

II.5. Në datën 04.11.2025, operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin në fazën e parë të shprehjes së interesit, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“1. Operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:

- Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;

- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;

- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____ Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklarimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.

KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane te vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Permbledhes i Vetedeklarimit duhet te plotesohet ne te gjithë seksionet e saj duke dhene deklaruar adresen apo dokumentin konkret mbi bazen e te ciles/cilit autoriteti mund te beje verifikimin e vetdeklarimeve dhe mosplotesimi i tij ne te gjithë seksionet perkatese perben kusht skualifikimi”. Te njejtin qendrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, date 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, date 17.09.2025. Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.

2. Sigurimi i ofertës i paraqitur nga operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k., edhe pse në vlerë të saktë, nuk përmbush kriterin 1, shkronja b), pasi afati 150-ditor nuk fillon nga data e mbylljes së tenderit (20.10.2025) por fillon nga data 16.10.2025 deri më 15.03.2026, kur sipas kërkesës duhej të përfshinte periudhën 20.10.2025 – 18.03.2026 (150 dite). Ndryshe nga rasti i trajtuar nga Komisioni i Prokurimeve Publike me Vendimin Nr.1459/2025, datë 16.10.2025, ku sigurimi i ofertës i operatorit Mine Lloshi P.F. ishte lëshuar përpara datës së hapjes së tenderit, por specifikonte se (sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në (njoftimin e kontratës ose ftesën për tender) 150 ditë), në rastin aktual periudha e sigurimit të ofertës nga “Clean Fast” nuk mbulon plotësisht afatin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, operatori “Clean Fast” sh.p.k. skualifikohet, duke u bazuar në kriterin specifik të dokumenteve të tenderit që kërkon mbulimin e të gjithë periudhës së 150 ditëve nga data e dorëzimit të ofertave.

3. Operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k. ka ofruar një solucion pastrimi për mobilie, i cili, sipas të dhënave teknike të paraqitura në katalog, përdoret vetëm për sipërfaqe rezistente ndaj ujit. Ndërkohë, kërkesa teknike e përcaktuar në dokumentet e tenderit parashikon solucion pastrimi të përgjithshëm për mobilie, pa kufizim në llojin e materialit mbi të cilin përdoret. Për rrjedhojë, produkti i ofruar nuk përputhet plotësisht me specifikimet teknike, dhe si i tillë, operatori ekonomik nuk konsiderohet plotësisht përmbushës për këtë artikull. Gjithashtu, autorizimi i datës 13.10.2025, i lëshuar nga prodhuesi “Johannes Kiehl KG” në favor të distributorit në Shqipëri “Globi” sh.p.k., është paraqitur në formë fotokopie, pa u shoqëruar me origjinalin ose me kopje të noterizuar. Për pasojë, duke qenë se autorizimi i paraqitur nuk është origjinal apo i noterizuar dhe produktit i mungon përputhshmëria e plotë me kërkesat teknike, fleta e sigurisë së materialit (MSDS) e paraqitur për solucionin larës të mobilieve nuk mund të merret në konsideratë për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit, sipas pikës 2.3.7 të dokumenteve të tenderit.

4. Operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit,

pikën 2.3.8 ne kombinim me 2.3.7, pasi Autorizimi i leshuar nga distributori nuk është i vlefshëm për arsyet në vijim:

1. Analiza e datave dhe dokumenteve

a) Autorizimi i leshuar nga prodhuesi (Johannes Kiehl KG) për distributorin Globi SHPK mban datën 13.10.2025, nepermjet të cilit konfirmohet Globi SHPK është përfaqësuesi i vetëm zyrtar për produktet “Kiehl” në Shqipëri. Kjo Certifikate hyn në fuqi nga data e lëshimit dhe është e vlefshme “deri në revokim”. Nderkohe, Autorizimi i leshuar nga distributori (Globi SHPK) për shoqërinë “Clean Fast” Sh.p.k mban datën lëshimi 01.10.2025, nepermjet të cilit Globi SHPK autorizon Clean Fast SHPK të përdorë produktet “Kiehl Group” dhe dokumentacionin teknik për një procedurë të caktuar prokurimi. Autorizimi i leshuar nga Globi SHPK mban datën 01.10.2025, ndërsa certifikata që e legjitimon Globin si përfaqësues zyrtar i markës “Kiehl” është 13.10.2025, pra 12 ditë më vonë. Kjo do të thotë se në momentin e lëshimit të autorizimit për Clean Fast SHPK (më 1 tetor), Globi SHPK nuk kishte ende statusin e konfirmuar zyrtarisht nga prodhuesi Kiehl për të qenë përfaqësues ekskluziv në territorin e Shqipërisë. Në momentin e lëshimit të autorizimit të datës 01.10.2025, kompania Globi SHPK nuk kishte ende një certifikim të vlefshëm nga prodhuesi Johannes Kiehl KG që e autorizon të përfaqësojë markën “Kiehl” në territorin e Republikës së Shqipërisë. Certifikata nga prodhuesi mban datën 13.10.2025, pra pas datës së lëshimit të autorizimit ndaj Clean Fast SHPK, çka do të thotë se në kohën e nënshkrimit të autorizimit Globi SHPK nuk kishte kapacitetin juridik për të transferuar të drejta përdorimi, përfaqësimi apo dokumentacioni teknik në emër të Kiehl Group. Për pasojë, autorizimi i datës 01.10.2025 rezulton i pavlefshëm, pasi është leshuar: • pa bazë ligjore dhe pa mandat aktiv nga prodhuesi; • në kundërshtim me parimin e vlefshmërisë kohore të autorizimeve të deleguara. Në kuptim të praktikës së prokurimit publik, kjo përbën mospërmbushje të kërkesës për dokumentacion të vlefshëm për përfaqësim nga prodhuesi, pasi dokumenti i paraqitur (autorizimi nga distributori) nuk mbështetet në një autorizim të vlefshëm në datën e nënshkrimit të tij. Për rrjedhojë, operatori ekonomik skualifikohet.

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k. ka dorëzuar: • Autorizim datë 13.10.2025, leshuar nga prodhuesi “Johannes Kiehl KG” për distributorin në Shqipëri, shoqërinë “Globi” sh.p.k., në gjuhën angleze; • Përkthim në gjuhën shqipe nga përkthyesja e licencuar Edlira Hysa. Gjatë shqyrtimit të dokumenteve, KVO ka konstatuar se: • Dokumenti i autorizimit është fotokopje, pra jo origjinal dhe jo kopje e noterizuar;

• Nuk është paraqitur asnjë akt noterial që të vërtetojë njësishtin e dokumentit të dorëzuar me origjinalin. Në këto kushte, autorizimi nuk mund të konsiderohet dokument i vlefshëm, pasi nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në DST dhe në Manualin e APP-së. Referuar kërkesave të DST-së, ku parashikohet se të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, Manualit nr.1 Datë 24.12.2018 “Për Regjistrimin Operatorëve Ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik., ku në faqen 17 të këtij manuali përcaktohet se Dokumentat e skanuara duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara dhe mosplotesimi i këtyre detyrimeve, përbën mospërmbushje të kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe arsye për skualifikim. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) gjykon se Operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k., me dokumentacionin e

dorëzuar, nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.8 të DST-së, pasi autorizimi i paraqitur nuk është origjinal apo kopje e noterizuar. Në përputhje me sa më sipër, KVO vendos skualifikimin e operatorit ekonomik “Clean Fast” sh.p.k. nga procedura e prokurimit.”.

II.6. Në datën 04.11.2025, operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin në fazën e parë të shprehjes së interesit, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“1. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:

- Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;*
- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.*

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklaratimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.

KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane të vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj duke dhënë deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të ciles/cilit autoriteti mund të beje verifikimin e vetëdeklarimeve dhe mosplotësimi i tij në të gjithë seksionet përkatëse përben kusht skualifikimi”. Te njejtin qendrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, date 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, date 17.09.2025. Per sa me sipër operatori ekonomik skualifikohet.

2. Operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. nuk ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7, i cili përcakton se: “Operatori ekonomik ofertues, për solucionet dhe produktet larëse dhe dezinfektuese të renditura në pikën 3, 4, 5 dhe 6 të Seksionit 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit, Shtojca 8, duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS), të lëshuar nga prodhuesi.”

Në përmbushje të kësaj kërkesë, operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim të datës 20.10.2025, të lëshuar nga shoqëria “ARSEL – DETERGJENT” sh.p.k., e cila në dokument paraqitet si prodhues i detergjentëve, së bashku me dokumentet MSDS përkatëse për produktet e ofruara. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në rubrikën “Leje/Licenca të lëshuara nga QKB”, rezulton se subjekti “ARSEL – DETERGJENT” sh.p.k., me NIPT L01605513C, është i pajisur vetëm me Leje Mjedisore të tipit C (Licenca PN-7447-10-2018), me objekt aktiviteti: “Magazinimi i kimikateve.”-i perket

veprimtarinë 4.7 Ndërkohë, në përputhje me nenin 4 të Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe Shtojcën 1 të këtij ligji (ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020), përcaktohet qartë se: “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”

Kjo do të thotë se, çdo subjekt që ushtron aktivitet prodhimi ose përpunimi të detergjentëve, duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”, të lëshuar nga autoritetet kompetente. Për rrjedhojë, subjekti “ARSEL – DETERGJENT” sh.p.k., i cili zotëron vetëm Leje Mjedisore të tipit C për magazinim kimikatesh, nuk përmbush kërkesat ligjore për të ushtruar aktivitetin e prodhimit apo përpunimit/përzierjes së detergjentëve, dhe për pasojë nuk mund të konsiderohet prodhues i ligjshëm i këtyre produkteve.

Gjithashtu, në pikën 4.1.4 të Lejes Mjedisore të Tipit C, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit – Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Durrës, përcaktohet se: “Kjo leje është e vlefshme vetëm për deklaratimet që subjekti bën në formularin e kërkesës për Leje Mjedisore.”

Kjo vërteton se subjekti nuk zotëron leje për veprimtari prodhimi, por vetëm për magazinim kimikatesh. Në mungesë të një Leje Mjedisore “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”, kjo shoqëri nuk ushtron ligjërisht aktivitetin e prodhimit të detergjentëve, MSDS-të e paraqitura nuk mund të konsiderohen të lëshuara nga prodhuesi, siç kërkohet shprehimisht në dokumentet e tenderit.

Në bazë të sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) vlerëson se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7, pasi dokumentet e paraqitura nuk i referohen një prodhuesi të ligjshëm të produkteve detergjentë, dhe për pasojë operatori skualifikohet.

3. Operator ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, ka paraqitur për artikullin nr. 3 (“Solucion zbardhues që përdoret për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve”) produktin “MAX ACE”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të lëshuar nga “ARSEL DETERGJENT sh.p.k.”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kërkesat e pikës 3 të Specifikimeve Teknike, për arsyet si më poshtë:

- Edhe pse në MSDS është përmendur se produkti ka përmbajtje klori dhe pH 1.5 ± 0.2 , dokumentacioni nuk specifikon përdorimin e produktit për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve, siç kërkohet shprehimisht në DST, dhe nuk deklaron se heq pikat e bardha të ujit (mbetjet gëlqerore karakteristike të sipërfaqeve sanitare).

- Dokumenti nuk provon se produkti bën pjesë në linjë profesionale pastrimi, siç kërkohet për produktet sanitare industriale dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”. • MSDS-ja nuk jep referenca për testime laboratorike ose certifikime të standardeve të BE-së, që lidhen me produktet profesionale (metodat e testimit të referuara në pikën 3, të nenit 12, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”). Si rrjedhojë, operatori ekonomik nuk konsiderohet se përmbush kriterin e kualifikimit dhe kërkesat e DST.

4. Operator ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, ka paraqitur për artikullin nr.4 (“Solucion

për larje pllakash dysHEMEJE”) produktin “MAX CASA”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të lëshuar nga “ARSEL DETERGJENT” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kërkesat e pikës 4 të Specifikimeve Teknike, për arsyet si më poshtë:

- Në dokumentacionin teknik nuk provohet se produkti “Max Casa” është i destinuar për larjen e pllakave të dysHEMEVE, sipas përdorimit specifik të kërkuar në DST. Dokumenti jep përshkrim të përgjithshëm si “produkt i lëngshëm me aromë freskie”, por pa referencë të drejtpërdrejtë për përdorim në sipërfaqe dysHEMEJE.

- Gjithashtu, nuk provohet se produkti bën pjesë në një linjë profesionale për pastrimin industrial, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 te Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”.

- Dokumenti është përpiluar nga subjekti prodhues vendas “Arsel Detergjent sh.p.k.”, por nuk jep asnjë referencë për certifikim të standardeve të BE-së apo testim të pavarur sipas standarteve të BE ose ekuivalente, që janë tipike për produktet profesionale të pastrimit. Si rrjedhojë, operatori ekonomik nuk konsiderohet përmbushës kriterin e kualifikimit dhe specifikimet teknike.

5. Operator ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, ka paraqitur për artikullin nr.5: “Solucion për larje xhamash (me spray)” – produkti “Xhamsil”, prodhues: ARSEL DETERGJENT sh.p.k. (MSDS “Xhamsil”)

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe MSDS-së të paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush plotësisht kërkesat e pikës 5 të Specifikimeve Teknike (“Të jetë prodhim me standarde të BE dhe i certifikuar...; 500–800 ml me spray; linjë profesionale; pH 8.5–9; karta sigurie dhe përbërjeje”), për këto arsye: • “Linjë profesionale”: Nuk ka asnjë provë/deklaratë që produkti i përket linjës profesionale (referencë prodhuesi, katalog profesional, certifikim përdorimi profesional, etj.) dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 te Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”.

Si përfundim, operatori ekonomik nuk konsiderohet se përmbush kriterin e kualifikimit dhe specifikimet teknike për këtë arsye skualifikohet.

6. Operator ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, ka paraqitur për artikullin nr.6: “Solucion Mobiljesh (me spray)” – produkti “Solucion Mobiljesh”, prodhues: ARSEL DETERGJENT sh.p.k. (MSDS “Solucion Mobiljesh”)

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe MSDS-së të paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush plotësisht kërkesat e pikës 6 të Specifikimeve Teknike (“Të jetë prodhim me standarde të BE dhe i certifikuar...; 500 ml me spray; linjë profesionale; pH 8–9; karta sigurie dhe përbërjeje”), për këto arsye: Operator ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, ka paraqitur për artikullin nr. 6: “Solucion për larje mobiljesh (me spray)” – produkti “Solucion Mobiljesh”, prodhues: ARSEL DETERGJENT sh.p.k. (MSDS “Solucion Mobiljesh”) Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe MSDS-së të paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush plotësisht kërkesat e pikës 6 të Specifikimeve Teknike: • Përdorimi

dhe linja profesionale – dokumenti nuk përmban asnjë referencë që produkti është pjesë e një linie profesionale të pastrimit (p.sh. mungojnë katalogë, etiketa profesionale ose certifikata përdorimi profesional) dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake. Operatori ekonomik nuk konsiderohet se përmbush kriterin e kualifikimit dhe specifikimet teknike, për këtë arsye skualifikohet.”.

II.7. Në datën 13.11.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6073, datë 13.11.2025 dhe numër protokoll nr. 3257/2025, datë 13.11.2025 e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK.

Gjithashtu ankimesi kërkon skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AIR” SHPK, si dhe kërkon shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK dhe ofertës së operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3257/1 prot, datë 14.11.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK, si dhe lidhur me kërkesën për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AIR” SHPK dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK dhe të ofertës së operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “AIR” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3257/2 prot., datë 17.11.2025.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimesi “REJ” SHPK me shkresën “Vënie në dijeni” e datës 18.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3257/3 prot, datë 21.11.2025 ka paraqitur informacion shtesë lidhur me pretendimin e tij për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Clean Fast” me numër ankimi elektronik A/2025/6077 datë 14.11.2025 duke e konsideruar të paraqitur jashtë afatit të parashikuar në nenin 110, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II.11. Në datë 25.11.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 2982/14 prot, datë 25.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3257/4 prot, datë 25.11.2025, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “*Vendim KSHA 135/2025*”, datë 21.11.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*REJ*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit konkretisht duke argumentuar: “

II.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit:

ARSYETON:

II.1. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “*REJ*” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për s’kualifikimin e ofertës së tij me arsyen se në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa I “Shkaqet e përjashtimit”, Seksioni D:*

Në Nenin 2 “*Qëllim*” të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në Nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. ...”

Në nenin 76 “*Kriteret detyruese për s’kualifikim*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja 38 detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja "ç", të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e 39 prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona

të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të panjftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të

kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kriterëve.”

Në pikën 1 të nenit 82 “Formulari përmblledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmblledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmblledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënie e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

Në nenin 26 “Formulari përmblledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmblledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmblledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Referuar bazës ligjore të lartpërmendur, si edhe legjislacionit në fuqi në tërësi për prokurimin publik, “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, përbën një provë paraprake në vend të disa vërtetimeve/dokumenteve të lëshuara nga ente të caktuara publike ose palë të tjera të treta dhe në këtë kuptim çdo deklaram i bërë përfshirë edhe dhënien e informacioneve të nevojshme ndihmëse për verifikimin e këtyre deklarameve është barrë dhe përgjegjësi e operatorit ekonomik ofertues.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të operatorit ekonomik ankimues, KSHA konstaton se operatori ekonomik “Rej” shpk nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referuese për plotësimin e të gjitha rubrikave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Konkretisht për rubrikën “Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. Operatori ekonomik lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. Operatori ekonomik nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH”, nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi.

KSHA gjykon se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme. Referuar sa më sipër, KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 9, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e nevojshme për dy prej rubrikave të cituara më sipër në këtë vendim siç ky formular parashikon. KSHA gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më sipër, KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues “Rej” shpk nuk ka dhënë informacionin e nevojshëm lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur deklaramë me karakter thjesht pohues lidhur me respektimin e legjislacionit të punës, mosdiskriminimin, lidhjen e kontratave të punës dhe mungesën e masave ndëshkimore nga ISHPSHSH, këto deklaramë nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për qëllimet e një procesi transparent verifikimi. Vetë natyra e pretendimeve të paraqitura kërkon që operatori të ofrojë sqarime të detajuara dhe indiciet dokumentuese që mundësojnë verifikimin objektiv të këtyre pohimeve.

Deklarimet e përgjithshme nuk përbëjnë provë dhe nuk garantojnë se operatori ekonomik ankimues, në praktikë, ka zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara për sigurinë dhe shëndetin në punë, për mbrojtjen nga diskriminimi apo për administrimin e marrëdhënieve të punës. Për të vërtetuar këto elemente, operatori ishte i detyruar të paraqiste indicie ose të citonte dokumentacion mbështetës, si kontrata pune, evidenca të trajnimeve për sigurinë, procesverbale nga kontrollet e ISHPSHSH, raportime të masave të ndërmarra, apo çdo dokument tjetër zyrtar që provon përputhshmërinë me kërkesat ligjore.

Mungesa e këtyre provave dhe informacioneve e bën të pamundur kryerjen e një verifikimi të plotë, të paanshëm dhe të besueshëm, duke cenuar në këtë mënyrë kërkesën që çdo ofertë duhet të jetë e kontrollueshme dhe e bazuar në fakte. Kjo situatë krijon risk që deklaratimet të jenë vetëm formale dhe jo reale, prandaj operatori kishte detyrimin material dhe procedural të shoqëronte deklaratimet me indicie konkrete dhe sqarime të duhura.

Për më tepër, KSHA thekson se KVO në mbështetje të skualifikimit është referuar dhe në vendimmarrjen e KPP, konkretisht në vendimin Nr.816/2025, datë 27.06.2025. Gjithashtu, në mbështetje të arsyeve të skualifikimit nga KVO të operatorit ekonomik ankimues, KSHA thekson se me të njëjtin arsyetim, KPP në vendimin Nr. 209/2025, datë 07.02.2025 ka gjykuar të drejtë skualifikimin për mosplotësimin e 2 rubrikave të sipërcituara të operatorit ekonomik në procedurën përkatëse, konkretisht me arsyetimin se: *“Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referuese për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Konkretisht për rubrikat: Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate; Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë, nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 10, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e nevojshme për dy prej rubrikave të cituara më sipër në këtë vendim sic ky formular parashikon KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues “4 S” SHPK ka plotësuar disa prej rubrikave të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, ndërsa për dy rubrika të cituara më lart, lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme për kualifikim, nuk ka dhënë informacionin që ky formular kërkon, duke mosplotësuar kështu pikën 2.a të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “REJ” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për s’kualifikimin e ofertës së tij lidhur me faktin që dokumenti me të dhënat e sigurisë (MSDS) nuk është lëshuar nga një prodhues.

Në Nenin 2 “Qëllimi” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. ...”

Në nenin 76 “Kriteret detyruese për s’kualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja 38 detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkëljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi

të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja "ç", të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e 39 prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat

në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

Në dokumentet e tenderit, kapaciteti teknik, pika 2.3.7. citohet se:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, për solucionet e renditur në pikën 3,4,5,6 "Solucionet dhe produktet lares dhe dizifektues", Seksioni 2- Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm", Shtojca 8 "Specifikimet teknike") duhet të paraqesë:

- dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.

Në procesverbalin "Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim", datë 23.09.2025 është argumentuar qartazi se:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenit 13 dhe 15 të Ligjit nr.27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve", VKM nr.9 datë 09.01.2019 "Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë". Është vlerësuar e rëndësishme që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentin me të dhënat e sigurisë të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të produkteve të cituar në këtë kriter, me qëllim që të sigurohet një nivel i lartë mbrojtje ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit, duke shmangur çdo efekt të dëmshëm që mund të vijë nga përdorimi i tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimes konstatohet se dokumenti me të dhënat e sigurisë për solucionet përkatëse (MSDS) është lëshuar nga subjekti "GET klin". Referuar kriterit të sipërcituar është kërkuar qartë që ky dokument duhet të jetë lëshuar nga një subjekt në cilësinë e prodhuesit. Nga verifikimet e kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është konkluduar se subjekti "GET klin" nuk rezulton të jetë prodhues përderisa nuk zotëron asnjë leje/licensë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit cka e bën të pamundur ushtrimin e aktivitetit si prodhues në rastin konkret i detergjentëve dhe solucioneve përkatëse të kësaj fushe.

Ky fakt është thelbësor, pasi licencimi përkatës është një kërkesë ligjore e domosdoshme, jo vetëm lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimesi, por për vetë ushtrimin e aktivitetit ekonomik dhe teknik në Republikën e Shqipërisë. Mungesa e licencës së prodhimit vërteton qartë se subjekti "GET Klin" nuk ka kapacitetin përkatës për të realizuar objektin e kontratës. Si rrjedhojë, deklarimi i tij si prodhues dhe paraqitja e dokumentit me të dhënat e sigurisë (MSDS), bie ndesh me të dhënat zyrtare publike dhe përbën një mospërputhje thelbësore me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit publik, legjitimiteti i aktivitetit të operatorit ekonomik është një element themelor për garantimin e konkurrencës së ndershme, cilësisë së produktit dhe sigurisë së produkteve që do të përdoren në shërbim. Mosplotësimi i këtij kushti e vë subjektin në pozitë të

pabarabartë ndaj operatorëve të tjerë që kanë investuar dhe operojnë në përputhje me kuadrin ligjor.

Gjithashtu, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se dokumenti MSDS, sipas standardeve ndërkombëtare dhe kërkesave ligjore në fuqi, duhet të lëshohet vetëm nga prodhuesi real i produktit, i cili zotëron formulën përkatëse kimike, asetet teknike dhe përgjegjësinë ligjore për sigurinë e tij. Marrja e MSDS-së nga një subjekt që nuk është prodhues, dhe që për më tepër nuk disponon as licencë apo leje për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit, krijon një risk lidhur me origjinën, cilësinë dhe legjitimitetin e vetë produktit të ofruar. Për rrjedhojë, operatori ekonomik ankimes nuk mund të provojë gjurmueshmërinë dhe autenticitetin e produkteve që pretendon se do të furnizojë.

Dokumenti me të dhënat e sigurisë lidhur me produktet kimike si detergjentë apo solumione të ngjashme është një dokument zyrtar që çertifikon përputhshmërinë me kërkesat e sigurisë, si për përdoruesit, ashtu edhe për ambientin. Kur një MSDS nuk buron nga prodhuesi legjitim, ajo humb çdo vlerë ligjore dhe teknike, dhe nuk mund të konsiderohet si e vlefshme nga autoriteti kontraktor.

Në këtë kuptim, mospërmbushja e kërkesave ligjore për licencim nuk është një mangësi formale, por një element thelbësor që cënon integritetin dhe vlefshmërinë e ofertës. Për këto arsye, dokumenti i marrë nga subjekti "GET Klin" nuk mund të konsiderohet i vlefshëm dhe në këtë kontekst operatori ekonomik "Rej" shpik ka dështuar të paraqesë një dokument me të dhënat e sigurisë për solumionet dhe produktet lares dhe dizinfektues nga një subjekt prodhues duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar sipas pikës 2.3.7, të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

II.3. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimes "REJ" shpik mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për s'kualifikimin e ofertës së tij lidhur me faktin që dokumenti me të dhënat e sigurisë (MSDS) nuk reflekton specifikimet teknike të kërkuara

Në Nenin 36 "Specifikimet teknike" të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

1. *Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorët. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve*

ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përsëkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane

Në nenin 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar:

" Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet".

Në Shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar se:

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE "SHËRBIM PASTRIMI PËR SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS"

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi. SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifik prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon

produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SHËRBIMIN E PASTRIMIT TË AMBIENTEVE TË BRËNDSHME

Shërbimi i pastrimit të brendshëm në Spitalin Universitar të Traumës (SUT) ka një rëndësi thelbësore përsa i përket parandalimit të infeksioneve spitalore dhe higjenes në Shërbimet mjekësore dhe duhet të ofrohet me standardet më të larta të cilësisë. Duke qenë se në qendër të veprimtarisë së SUT është ofrimi i një kujdesi cilësor ndaj pacientit, pastrimi i ambienteve ndikon drejtpërdrejt jo vetëm në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të pacientëve, por edhe në garantimin e një mjedisi të sigurt për personelin mjekësor dhe jomjekësor, si dhe për vizitorët që frekuentojnë ambientet e spitalit.

Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme në Spitalin Universitar të Traumës (SUT), Tiranë, është i organizuar në formë të sipërmarrjes private që nga viti 2003. Aktualisht, operatori ekonomik (OE) i kontraktuar është përgjegjës për pastrimin e të gjitha sipërfaqeve të ambienteve të shfrytëzuara, përfshirë bodrumet, shkallët dhe hapësirat deri në daljet e ndërtesës. Gjithashtu, OE realizon pastrimin dhe dezinfektimin e mureve dhe inventarit në dhomat e spitalit.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, OE respekton plotësisht kërkesat e parashikuara në specifikime teknike si dhe në rregulloren e brendshme të SUT. Shërbimi i pastrimit organizohet sipas godinave që janë aktualisht në funksion brënda territorit të SUT, të ndara si më poshtë:

- Godina kryesore – Kjo godinë ndodhet në pjesën qendrore të territorit të SUT-së dhe përmban një sërë shërbimesh kyçe spitalore. Brenda saj ndodhen ambientet e Shërbimi Pranim Urgjenca dhe Blloku Operator i Urgjencës; Klinika e Ortopedive 1,2 dhe 3; Klinika e Kirurgjise se Pergjithshme Nr 2; Shërbimi I Anestezë – Reanimacionit; Shërbimi I ORL- OKULISTIKE, KIRURGJI MAKSILOFACIALE, Shërbimi I Bllokut Operator, Shërbimi I Kirurgjise se Kembes Diabetike dhe Angiokirurgjise; Shërbimi I Neurokirurgjise, si dhe ambientet e personelit te Administratës, Shërbimit te farmacisë dhe njësi të tjera mbështetëse.

- **Godina e Sëmundjeve të Brendshme** – Kjo godinë ndodhet pranë hyrjes kryesore të Spitalit Universitar të Traunës dhe përfshin ambientet e **Konsultave të Specializuara Ambulatore**, Klinikat e **Sëmundjeve të Brendshme 1 (SB1)**, **Sëmundjeve të Brendshme 2 (SB2)** dhe **Klinika e Kirurgjise se Pergjithshme Nr 1** dhe njësi të tjera mbështetëse.
- **Godina e Statistikës dhe Informacionit Mjekësor** – Kjo godinë ndodhet përgjatë rrugës dytësore të SUT-së dhe përfshin ambientet e Statistikës dhe Informacionit Mjekësor, Qendrës së Protezimit dhe Laboratori Klinik-Biokimik-Bakterologjik (FA). Ajo ka funksione të rëndësishme administrative dhe mbështetëse në proceset klinike dhe diagnostike të spitalit.
- **Godina dykatëshe e Poliklinikës** – Kjo godinë ndodhet në hyrje të rrugës dytësore të SUT-së dhe shërben për ofrimin e shërbimeve ambulatorë duke mbështetur konsultat mjekësore dhe shërbime të tjera të specializuara në një mjedis të dedikuar dykatësh.

Të gjitha këto godina ndahen sipas shërbimeve spitalore si më poshtë :

- **Sherbimi I Farmacise**
- **Sherbimi I Anestezi-Reanimacionit**
- **Sherbimi I Imazherise**
- **Sherbimi I Fizioterapise**
- **Sherbimi I Kirurgjise se Këmbes Diabetike dhe Angiokirurgjise**
- **Sektori Mjekesor I Gips Protezimit**
- **Sektori I Koordinimit me pacientin (Recepsioni)**
- **Sherbimi I Konsultave te Specializuara Ambulatore**
- **Klinika e Sëmundjeve te Brendshme Nr 1**
- **Klinika e Sëmundjeve te Brendshme Nr 2**
- **Blloku Operator**
- **Sherbimi Pranim Urgjenca dhe Blloku Operator i Urgjencës**
- **Klinika e Kirurgjise se Pergjithshme Nr 1**
- **Klinika e Kirurgjise se Pergjithshme Nr 2**
- **Klinika e Ortopedise 1**
- **Klinika e Ortopedise 2**
- **Klinika e Ortopedise 3**
- **Sherbimi I ORL-OKULISTIKE, KIRURGJI MAKSILOFACIALE**
- **Sherbimi I Neurokirurgjise**
- **Sherbimi I Urgjences Paraspitalore (Poliklinika)**
- **Sektori Mjekesor I Parandalimit te Infeksioneve Spitalore (Poliklinika)**
- **Sektori I Statistikes dhe Informacionit Mjekesor**
- **Mjekesia e Trupes Parandaluese (Poliklinika)**
- **Administrata (sipas sektoreve) dhe Sallat e Mbledhjeve**
(Sektori I Akreditimit dhe Edukimit ne vazhdim, Sektori I Menaxhimit te Teknologjise, Sektori I Menaxhimit te Ceshtjeve Juridike, Sektori I Prokurimeve, Sektori I Burimeve Njerezore, Sektori I Sekretarise, Sektori I Finances, Sektori I Kostos, Sektori I Sherbimeve Mbeshtetese)
- **Ambientet e ndihmës së shërbimit mjekësor si dhe cdo sipërfaqe tjetër të brendshme që është në shfrytëzim.**

Grupi i punës ka hartuar sipërfaqet për tu pastruar duke patur parasysh faktin se gjatë viteve të fundit janë kryer investime në SUT, të cilat kanë ristrukturuar sipërfaqen e disa pavioneve, si dhe duke patur parasysh faktin se disa hapësira janë dhënë me qera subjekteve private. Si përfundim, sipërfaqet janë përllogaritur sipas kontratave të mëparshme dhe ndryshimeve të ndodhura në tre vitet e fundit por në SUT janë parashikuar të kryhen investime në vitet në vazhdim dhe sipërfaqet do të ndryshojnë sipas projekteve që do të zbatohen.

Grupi i punës ka përllogaritur sipërfaqet e parashikuara (sipërfaqet janë parashikime dhe turnet e punës mund të ndryshojnë sipas kërkesave të SUT) që do të pastrohen sipas metrave katrorë të paraqitur në tabelën si më poshtë:

Tabela nr.1 Sipërfaqe të brendshme për t'u pastruar në SUT

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E SIPERFAQEVE TË BRENDSHME PËR T'U PASTRUAR NË SUT					
NR.REND	AMBJENTET E BRENDSHME	M ²	SIP. ME NJË TURN	SIP. ME DY TURNE	SIP. ME TRE TURNE
1	ADMINISTRATA (Sipas Sektoreve, Sallat e Mbledhjeve)	1606.91			
	Spektori I Statistikes dhe Informacionit Mjekesor	455.65			
	SHUMA M ²	2062.56	2062.56		
2	Sherbimi I Farmacise	191.1			
	Sherbimi I Imazherise (I)	373.54			
	Sherbimi I Fizioterapise	434.32			
	Sherbimi I Konsultave te Specializuara Ambulatore	960			
	Sherbimi I Urgjences Paraspitalore + Mjekesia e Trupes Parandaluese ++ Spektori Mjekesor I Parandalimit te Infeksioneve Spitalore	924.986			
	Spektori Mjekesor I Gips Protezimit	402.392			
	Laboratori Klinik-Biokimik-Bakterologjik (FA)	164			
	Dhoma mjekesh	560			
	SHUMA M ²	4010.338	4010.338		
3	Spektori I Koordinimit me pacientin (Recepsioni)	244.333			
	SHUMA M ²	244.333		244.333	

4	<i>BLLOKU OPERATOR</i>	1524.75			
	<i>SHUMA M²</i>	1524.75		1524.75	
5	<i>Sherbimi Pranim Urgjenca dhe Blloku Operator i Urgjences</i>	1,344.70			
	<i>Sherbimi I Anestezi-Reanimacionit</i>	908.27			
	<i>SHUMA M²</i>	2,252.97			2,252.97
6	<i>Korridore</i>	438.688			
	<i>Sherbimi I Imazherise (II)</i>	890.127			
	<i>Klinika e Ortopedise 1</i>	827.64			
	<i>Klinika e Ortopedise 2+3</i>	722.37			
	<i>Sherbimi I ORL-OKULISTIKE, KIRURGJI MAKSILOFACIALE</i>	400			
	<i>Sherbimi I Neurokirurgjise</i>	722.37			
	<i>Klinika e Kirurgjise se Pergjithshme Nr 2</i>	866.78			
	<i>Klinika e Sëmundjeve te Brendshme Nr 1+2</i>	895			
	<i>Klinika e Kirurgjise se Pergjithshme Nr 1+ Ura lidhese</i>	825			
	<i>Shebimi I Kirurgjise se Këmbes Diabetike dhe Angiokirurgjise (2 kate)</i>	1142.68			
	<i>SHUMA M²</i>	7730.655		7730.655	
	<i>SHUMA M²</i>	6072.898	9499.738	2252.97	
		<i>SIP. ME NJË TURN</i>	<i>SIP. ME DY TURNE</i>	<i>SIP. ME TRE TURNE</i>	

NR.	Sipërfaqe totale per tu pastruar	Njësia	Sasia	Turne	Ditë kalendarike	Sasia 12 muaj	Sasia 36 muaj
1	Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh (2062,56*1) (Administratë)	m ²	2062.56	8-orësh (1)	246	507,389.76	1,522,169.28
2	Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh (4010.338*1) (Shërbime për pacientet)	m ²	4010.338	8-orësh (1)	246	986,543.15	2,959,629.44
3	Pastrim i brendshëm me shërbim 16-orësh (244,333 X 2 turne) Sektori I Koordinimit me pacientin (Recepsioni)	m ²	244.333	16-orësh (2)	365	178,363.09	535,089.27
4	Pastrim i brendshëm me shërbim 16-orësh (1524.75 X 2 turne) (Blloku Operator)	m ²	1524.75	16-orësh (2)	246	750,177.00	2,250,531.00
5	Pastrim i brendshëm me shërbim 24-orësh (2252.97 X 3 turne) (Shërbimi Pranir Urgjencë dhe Blloku Operator i Urgjencës+Reanimacioni)	m ²	2252.97	24-orësh (3)	365	2,467,002.15	7,401,006.45
6	Pastrim i brendshëm me shërbim 16-orësh (7730.655 X 2 turne)	m ²	7730.655	16-orësh (2)	365	5,643,378.15	16,930,134.45
Totali			17,825.606			10,532,853.298	31,598,559.894

Tabela nr.2 Sipërfaqe totale për t'u pastrua

Shënim: Këto sasi janë parashikime sipas gjendjes faktike të sipërfaqeve të brendshme që ndodhen në SUT. Këto sasi mund të ndryshojnë sipas viteve në varësi të ndryshimeve që mund të bëhen duke qënë se në SUT po bëhen rikonstruksione të godinave me qëllim përmirësimin e shërbimeve mjekësore. Këto ndryshime do të pasqyrohen në kërkesat e SUT, kontratave që do të nënshkruhen mes palëve në tre vitet e Marrëveshjes Kuadër dhe në akt rakordimet mujore ku ndryshimet paraqiten me proces verbalet përkatëse.

Autoriteti kontraktor do të kryejë kontrolle ditore dhe periodike dhe do të pasqyrojë me shkrim (sa herë të paraqiten problematika) cdo mangësi apo shkelje të kërkesave të parashikuara në këto specifikime teknike:

- a) kryerjen e shërbimeve të përmendura në kontratë;*
- b) respektimin e standardeve të përcaktuara;*
- c) përbushjen e rregullave dhe cilësisë së kërkuar.*

Në rast të konstatimit të mospërputhjeve ose shkeljeve, autoriteti kontraktor ka të drejtë të vendosë penalitete, gjoha apo ndalesa në përputhje me dispozitat kontraktore dhe legjislacionin në fuqi.

Sipërfaqet e përfshira në objektin e shërbimit përfshijnë, por nuk kufizohen në këto ambiente të brendshme:

- Dhomë mjeku, Dhomë pacienti, Korridore, Zyra, Tualete, Ashensorë, Salla mbledhjesh, Salla Operacioni, Farmaci, Fizioterapi, ambientet e ndihmës së shërbimit mjekësor dhe çdo sipërfaqe tjetër e brendshme që është në shfrytëzim.

Kryerja e shërbimit është ndarë në turne në bazë të orarit ditor që sektorët shërbejnë dhe sipas nevojave të organizimit të punës në SUT.

Tabela nr.3 Shpeshtësia e pastrimit të ambienteve të brendshme sipas sektorëve të SUT

NR.REND	AMBJENTET E BRENDSHME	Frekuenca e pastrimit	Niveli I rrezikshmerise
1	ADMINISTRATA (Sipas Sektoreve, Sallat e Mbledhjeve)	Jo më pak se nje (1) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme	Rezikshmeri e ulet
	Spektori I Statistikes dhe Informacionit Mjekesor		
2	Sherbimi I Farmacise	Jo më pak se dy (2) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme	Rezikshmeri e moderuar
	Sherbimi I Imazherise (I)		
	Sherbimi I Fizioterapise		
	Sherbimi I Konsultave te Specializuara Ambulatore		
	Sherbimi I Urgjences Paraspitalore + Mjekesia e Trupes Parandaluese ++ Spektori Mjekesor I Parandalimit te Infeksioneve Spitalore		
	Spektori Mjekesor I Gips Protezimit		
	Laboratori Klinik-Biokimik-Bakterologjik (FA)		
Dhoma mjekesh			
3	Spektori I Koordinimit me pacientin (Recepsioni)	Jo më pak se tre (3) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme	Rezikshmeri e ulet

4	BLLOKU OPERATOR	Para dhe pas çdo operacioni dhe në fund të ditës	Rezikshmeri e larte
5	Sherbimi Pranim Urgjenca dhe Blloku Operator i Urgjences Sherbimi I Anestezi-Reanimacionit	Pastrimi të bëhet i pandërprerë sipas nevojës gjatë 24-orëve	Rezikshmeri e larte
	Korridore		
	Sherbimi I Imazherise (II)		
	Klinika e Ortopedise 1		
	Klinika e Ortopedise 2+3		
	Sherbimi I ORL-OKULISTIKE , KIRURGJI MAKSILOFACIALE		
	Sherbimi I Neurokirurgjise	Jo më pak se tre (3) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme	Rezikshmeri e moderuar
	Klinika e Kirurgjise se Pergjithshme Nr 2		
6	Klinika e Sëmundjeve te Brendshme Nr 1+2		
	Klinika e Kirurgjise se Pergjithshme Nr 1+ Ura lidhese		
	Shebimi I Kirurgjise se Këmbes Diabetike dhe Angiokirurgjise (2 kate)		

2- Specifikimet teknike të Shërbimit të Pastrimit të Brendshëm dhe të jashtëm

MBI SHËRBIMIN E PASTRIMIT TË AMBJENTEVE TË BRËNDËSHME

Duke iu referuar rëndësisë që ka parandalimi i përhapjes së infeksioneve spitalore, pastrimi i çdo sipërfaqeje të brendshme si dhe gjithë zërat e këtij shërbimi, janë shumë të nevojshëm të kryhen dhe ky shërbim nuk duhet të mungojë asnjë ditë!

Në pastrimin e sipërfaqeve të brendshme përfshihen të gjitha orenditë që ndodhen brenda atij ambjentit, paisjet e zyrave si dhe dyert e dritaret.

Pastrimi i brendshëm do të kryhet nga operatorë ekonomikë të kontraktuar dhe ka për detyrë pastrimin e të gjitha sipërfaqeve të pavioneve, dhomat e të sëmurëve, ballkonet, korridoret,

tualetet, dhomat e dushit, dhomat e shërbimit për mjekët, infermierët, kabinetet, zyrat, ambjentet e shfrytëzueshme në bodrume dhe shkallët deri në dalje nga ndërtesa; bën pastrimin e mureve dhe orenditë e dhomave, sipas specifikimeve teknike si më poshtë :

➤ Pastrimi i ambienteve të brendshme që do të bëhet cdo ditë klasifikohet sipas specifikave të mëposhtme :

1. ADMINISTRATA (Sipas Sektoreve, Sallat e Mbledhjeve); Sektori I Statistikes dhe Informacionit Mjekesor: Me këtë shërbim do të kuptojmë heqjen e mbeturinave nga koshat, ndërrimin e qeseve, fshirjen e larjen e dyshemeve dhe marrjen e pluhurave në të gjitha orenditë e vendosura në këto ambiente. Në zyrat e personelit ky pastrim të bëhet jo më pak se një (1) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme.
2. Sherbimi I Imazherise (I), Sherbimi I Konsultave te Specializuara Ambulatore, Sherbimi I Urgjences Paraspitalore + Mjekesia e Trupes Parandaluese + Sektori Mjekesor I Parandalimit te Infeksioneve Spitalore, Sektori Mjekesor I Gips Protezimit, Laboratori Klinik-Biokimik-Bakterologjik (FA), Dhoma mjekesh: Pastrimi i zyrave dhe dhomave të personelit mjekësor: Me këtë shërbim do të kuptojmë heqjen e mbeturinave nga koshat, ndërrimin e qeseve, fshirjen e larjen e dyshemeve dhe marrjen e pluhurave në të gjitha orenditë e vendosura në këto ambiente. Ky pastrim të bëhet jo më pak se dy (2) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme.
Pastrimi i Sherbimit te Farmacise dhe Sherbimit te Fizioterapise: Me këtë shërbim do të kuptojmë heqjen e mbeturinave nga koshat, ndërrimin e qeseve, fshirjen e larjen e dyshemeve me solucion përkatës dhe marrjen e pluhurave në të gjitha orenditë e vendosura në këto ambiente. Të pastrohen të paktën 2 (dy) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme me solucionet e percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve.
3. Pastrimi i Sektorit te Koordinimit me pacientin (Recepsioni): Me këtë shërbim do të kuptojmë heqjen e mbeturinave nga koshat, ndërrimin e qeseve, fshirjen e larjen e dyshemeve dhe marrjen e pluhurave në të gjitha orenditë e vendosura në këto ambiente me solucionet e percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve. Ky pastrim të bëhet jo më pak se tre (3) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme.
4. Pastrimi i Bllokut Operator:
Sallat e operacionit: Cdo ditë një orë para operacionit kryhet pastrimi i dyshemesë së sallës me solucion larës dizinfektues për përdorim spitalor (i specifikuar për sallat e operacionit - solucionet e percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve.).

Po kështu pastrohen edhe sipërfaqet e orendive të sallave duke përdorur pecetë të njomë me solucion larës dizinfektues të certifikuar për sallat kirurgjikale - me solucionet e percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve.

Pas cdo operacioni kryhet pastrimi i dyshemesë së sallës me solucion larës dizinfektues, për përdorim spitalor (i specifikuar për sallat e operacionit- solucionet e percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve.

Në fund të ditës së punës bëhet ripastrimi i të gjithë sallës së operacionit me solucionet e percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve).

Sanitarja nuk prek instrumente kirurgjikale dhe aparaturat e instaluara në sallë kur pastron ambientet e Bllokut Operator.

5. Pastrimi i Sherbimit Pranim Urgjenca dhe Blloku Operator i Urgjences dhe Sherbimi I Anestezi-Reanimacionit:

Pastrimi të bëhet i pandërprerë sipas nevojës gjatë 24-orëve. Dyshemeja të lahet me solucione te percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

6. Pastrimi i Korridore, Sherbimi I Imazherise (II), Klinika e Ortopedise 1, Klinika e Ortopedise 2+3, Sherbimi I ORL-OKULISTIKE , KIRURGJI MAKSILOFACIALE, Sherbimi I Neurokirurgjise, Klinika e Kirurgjise se Pergjithshme Nr 2, Klinika e Sëmundjeve te Brendshme Nr 1+2, Klinika e Kirurgjise se Pergjithshme Nr 1+ Ura lidhese, Shebimi I Kirurgjise se Këmbes Diabetike dhe Angiokirurgjise (2 kate) :

Pastrimi i pavioneve që do të jenë me dy turne: Me këtë shërbim do të kuptojmë heqjen e mbeturinave nga koshat, ndërrimin e qeseve, fshirjen e larjen e dyshemeve dhe marrjen e pluhurave në të gjitha orenditë e vendosura në këto ambiente me solucione te percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve. Ky pastrim të bëhet të jo më pak se tre (3) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme.

Korridoret, shkallët dhe ashensorët të pastrohen jo më pak se tre (3) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme. Solucionet që do të përdoren duhet të jenë të lejueshme dhe të certifikuara për këto ambiente.

Dhomat e pacientëve të pastrohen jo më pak se tre (3) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme. Me pastrim të dhomës do të kuptohet marrja e pluhurave mbi mobiljet dhe cdo paisjeje tjetër që ndodhet brenda sipërfaqes së dhomës me solucione te percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve. Dyshemeja të lahet me solucione të lejueshme dhe të certifikuara për përdorim në ambientet spitalore. Qeset e mbeturinave të zbrazen jo më pak se tre herë në ditë dhe sipas rastiit në cdo moment të ditës. Pastrimi në dhoma nuk bëhet në orarin e ngrënies së ushqimit dhe në oraret e kryerjes së vizitave të mjekut (Në këtë orar kryhet ndonjë punë tjetër sipas programit).

Pastrimi i Tualeteve në dhomat e pacientëve, tualetet kolektive, Tualetet e personelit të pastrohen jo më pak se tre (3) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme. Bidetë, vaskat dhe pjatat e dushit të pastrohen sa herë të jetë e nevojshme (sipas kërkesave të personelit të SUT).

Pastrimi i dhomave të teknikës (Imazheria (II)): Me këtë shërbim do të kuptojmë heqjen e mbeturinave nga koshat, ndërrimin e qeseve, fshirjen e larjen e dyshemeve me solucion përkatës dhe marrjen e pluhurave në të gjitha orenditë e vendosura në këto ambiente me solucione te percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve. Ky pastrim të bëhet jo më pak se tre (3) herë në ditë dhe sa herë të jetë e nevojshme. Sanitaret nuk duhet të pastrojnë dhe të prekin aparaturat e vendosura në këto ambiente.

Dhomat e mjekimit: Të pastrohen sa herë që është e nevojshme gjatë gjithë kohës që janë në përdorim me solucione te percaktuara per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve.

Shënim: Pastrime të cilat duhet të kryhen me frekuencat e mëposhtme kostoja e të cilave duhet të jetë e përfshirë në cmimet që do të jepen për tabelën nr 2(dy) :

NR.REND	AMBJENTET E BRENDSHME	Frekuenca e pastrimit
1	Sipërfaqet e mureve dhe tavaneve, zhvendosja e dollapeve dhe mobiljeve të mëdha (ku është e mundur) dhe të pastrohet pjesa e mbrapme e tyre, dritaret e fasadës si dhe dritaret e brendshme, dyert e brendshme dhe të jashtme, sifonëve të tualeteve,	Jo më pak se një (1) herë në javë dhe sa herë të jetë e nevojshme
2	Sipërfaqet e mureve dhe tavaneve në ambientet Sherbimit të Pranim Urgjences dhe Blloku Operator i Urgjences dhe Sherbimit të Anestezi-Reanimacionit	Jo më pak se dy (2) herë në javë dhe sa herë të jetë e nevojshme
3	Pastrimi i sistemit të gjithë llojeve të ndricimit	Jo më pak se një (1) herë në muaj dhe sa herë të jetë e nevojshme

1. Pastrimi i ambienteve të brendshme që do të kryhet të paktën një herë në javë

- Të pastrohen sipërfaqet e mureve dhe tavaneve. Aty ku muri është i lyer me bojë vaji apo pllaka të lahen me solucion larës dizinfektues.
- Të zhvendosen dollapet dhe mobiljet e mëdha (ku është e mundur) dhe të pastrohet pjesa e mbrapme e tyre.
- Të pastrohen dritaret e fasadës si dhe dritaret e brendshme me solucion larës dizinfektues.
- Të pastrohen dyert e brendshme dhe të jashtme me solucion larës dizinfektues.
- Pastrim i sifonëve të tualeteve jo më pak se 1 (një) herë në javë. Larja bëhet me solucion larës dizinfektues
- Një herë në javë të bëhet pastrim komplet i sallës së operacionit përfshirë këtu të gjitha anekset si: dhomën e veshjes, dhomën teknike, dhomën e rafteve, etj.

2. Pastrimi i ambienteve të brendshme që do të kryhet të paktën dy herë në javë

- Të pastrohen sipërfaqet e mureve dhe tavaneve sa herë të jetë e nevojshme sipas kërkesave të personelit përkatës në këto pavione por jo më pak se 2 herë në javë.

3. Pastrimi i ambienteve që do të kryhen të paktën një herë në muaj

- Do të pastrohet sistemi i të gjithë llojeve të ndricimit që ndodhen në SUT.
- Pastrimet mujore të bëhen sipas planit të OE të miratuar nga SUT.

Mënyra e kryerjes dhe ndjekjes së shërbimit.

- Kryerja e shërbimit nga OE në pavione ndiqet nga kryeinfiermeret e shërbimeve ose infiermeret sipas grafikut per turnet 2 dhe 3. Ata kërkojnë ripastrimin e sipërfaqeve kur është e nevojshme.

Kryeinfiermeret e pavioneve duhet të mbajnë një regjistër në të cilin do të pasqyrojnë cdo ditë shërbimin e kryer nga sanitaret sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Cdo fund muaji, ecuria e punës do të pasqyrohet në proces-verbal të posacëm dhe do ti dorëzohet ndjekësve të kontratës për të përgatitur akt rakordimet mujore.

Cdo problem apo mangësi e konstatuar do të pasqyrohet në proces-verbal dhe do të bëhet përlllogaritja e dëmit të shkaktuar ndaj SUT

Mbi bazën e proces-verbalit që mbajnë ndjekësit e kontratës me kryeinfiermerët e njësisë sipas pavioneve dhe përgjegjësin e sipërmarrësit bëhet ndalesë në faturë për punën e pakryer.

Për problematikat që mund të krijohen midis palëve (ndjekësit e kontratës dhe kryeinfiermeret e shërbimit nga njëra anë dhe përfaqësuesit të sipërmarrësit nga ana tjetër) do të mbahen proces-verbale dhe do ti dorëzohen Titullarit të Institucionit.

Aktualisht, shërbimi i pastrimit ofrohet nga sanitare të punësuar nga firma sipërmarrëse përkatëse, të cilat janë të gjitha femra dhe janë trajnuar e kualifikuar nga kompania kontraktuese. Sanitaret janë të shpërndara sipas shërbimeve funksionale të institucionit dhe janë të klasifikuara si më poshtë:

- Sanitare në pavione të përgjithshme
- Sanitare në sallat e operacionit
- Sanitare në repartin e reanimacionit
- Sanitare në poliklinikë
- Sanitare në ambientet e administratës
- Si dhe në ambiente të tjera sipas nevojave të institucionit

Ky organizim është ndërtuar në funksion të kërkesave specifike të higjienës dhe kontrollit të infeksioneve për çdo shërbim.

Pastrimi i sipërfaqeve të brendshme realizohet në përputhje me standardet higjieno-sanitare, duke përdorur metodën me shtupë (mop) dhe sistemin me dy kova:

- Kova e parë përdoret për larjen me solucion dezinfektues ose detergjent të miratuar;
- Kova e dytë shërben për shplarjen me ujë të pastër, në mënyrë që të parandalohet ndotja e kryqëzuar dhe përhapja e mikrobeve nga një zonë në tjetrën.
- Pajisjet dhe praktikat ndihmëse për pastrim:
- Mjetet e përdorura për pastrimin e tualeteve ruhen dhe përdoren në mënyrë të veçantë nga ato që përdoren për ambientet e tjera, për të siguruar ndarjen e zonave të ndotura.
- Fshesa përdoret në mënyrë të kufizuar, vetëm në ambiente ku nuk ka shtretër dhe ku qarkullimi i njerëzve është i lartë, si: shkallët, korridoret, ambientet e konsultave dhe hapësira të ngjashme.
- Këto masa kanë për qëllim garantimin e një pastrimi efektiv dhe ruajtjen e kushteve maksimale të higjienës në të gjitha ambientet e institucionit.
- OE ka detyrimin të mirëmbajtë të gjithë koshat e mbetjeve urbane që janë aktualisht në përdorim në ambientet e brendshme të SUT dhe te sigurojë që ata të jenë funksionalë dhe në gjendje të mirë pune gjatë gjithë kohës. Gjithashtu, OE duhet te zëvendësojë çdo kosh që dëmtohet apo bëhet jo funksional, me shpenzimet e veta. OE është gjithashtu përgjegjës

për furnizimin dhe zëvendësimin e rregullt të të gjitha qeseve plastike që përdoren në koshat e mbetjeve urbane me shpenzimet e veta, pa asnjë kosto shtesë për institucionin.

- *Grumbullimi i mbetjeve urbane dhe ndarja e tyre bëhet në kosha te vecante me qese plastike të vendosur në çdo dhomë, tualet, korridor dhe ambient tjetër të përbashkët me qëllim ruajtjen e pastërtisë dhe zbatimin e standardeve higjieno-sanitare.*
- *Punonjëset e OE janë përgjegjëse për mbledhjen dhe largimin fizik të mbetjeve nga ambientet e brendshme të SUT. Largimi i mbetjeve nga pavionet në vendgrumbullimet e përcaktuara (te cilat ndodhen brenda territorit të brendshëm të SUT dhe evadohen nga nje OE i kontraktuar nga SUT) bëhet me Koshë të mëdhenj, të posaçëm për transportin e mbetjeve, të cilët duhet të jenë të mbyllur me kapakë për të siguruar higjienë dhe shmangie të ndotjes ose aromave të pakëndshme. Mbetjet largohen 2 deri në 3 herë në ditë, dhe sa herë që lind nevoja, në varësi të ngarkesës dhe situatës në ambientet spitalore.*
- *Gjatë kryerjes së shërbimit të pastrimit, sanitarja (punonjësja e pastrimit) nuk duhet në asnjë rast:
 1. Të prekë pacientët,
 2. Të ndërveprojë me aparaturat mjekësore, dhe
 3. Të prekë pajisjet mjekësore ose instrumentet e përdorura në trajtimin/shërbimin e pacientëve.Me qëllim që të:
 - Sigurojë kontrollin e infeksioneve spitalore,
 - Mbrojë shëndetin e pacientëve,
 - Dhe ruajë funksionalitetin e pajisjeve mjekësore.*
- *Personeli i Operatorit Ekonomik (OE) duhet të jetë i pajisur me uniformë të veçantë dhe të dallueshme nga ajo e personelit spitalor. Uniforma duhet të ketë të stampuar logon e kompanisë, në mënyrë të dukshme dhe të jetë me ngjyrë të ndryshme nga uniformat e personelit të SUT, për të shmangur çdo konfuzion.*
- *I gjithë personeli i OE duhet të trajnohet, nga OE i kontraktuar, sipas ligjit në fuqi Nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve ngjitëse".*
- *OE ka detyrimin të disponojë dokumentacionin që vërteton trajnimin e stafit të vet në përputhje me kërkesat ligjore dhe kontraktuale. Dokumentacioni duhet të përfshijë: Emrat e personelit të trajnuar, Datat e trajnimeve, Tematikat e trajtuara (me fokus te higjiena, parandalimi i infeksioneve, përdorimi i pajisjeve mbrojtëse, etj.), cdo document që vërteton trajnimin e kryer. Ky dokumentacion duhet të jetë: I aksesueshëm në çdo kohë brenda periudhës së kontratës, I paraqitshëm me kërkesë të institucionit kontraktor (SUT) Ose gjatë inspektimeve të rregullta apo të jashtëzakonshme nga autoritetet përkatëse.*
- *Në të gjitha ambientet spitalore të SUT, personeli i pastrimit është i detyruar të përdorë mjete personale mbrojtëse për të garantuar: Mbrojtjen e vetes, Mbrojtjen e pacientëve dhe Parandalimin e ndotjes dhe përhapjes së infeksioneve. Lista e mjeteve mbrojtëse të detyrueshme është: Doreza plastike njëpërdorimshe, Maska mbrojtëse, Kapuç mbrojtës për flokët, Këpucë gome ose mbrojtëse këpucësh, të përshtatshme për mjedis spitalor. Pajisjet duhet të jenë në gjendje të mirë, të pastra dhe të certifikuara për përdorim në ambiente*

shëndetësore. OE ka detyrimin të: Pajisë rregullisht personelin me këto mjete, Sigurojë zëvendësimin e tyre sa herë që është e nevojshme dhe Trajnojë stafin për përdorimin korrekt të tyre.

- Në ambiente të përbashkëta si: Korridore, Salla pritjeje ose shërbimi, Shkallë dhe çdo hapësirë tjetër publike në SUT personeli i pastrimit duhet të vendosë tabela paralajmëruese provizore që tregojnë: "Dysheme e lagur" ose "Rrezik rrëshqitjeje" apo mesazhe të tjera paralajmëruese standarde me qëllim Parandalimin e aksidenteve dhe ruajtjen e sigurisë në ambientet spitalore
- Shërbimi i pastrimit në ambientet e SUT duhet të kryhet 24 orë në ditë, pa ndërprerje. Organizimi i orareve të punës dhe ndarja në turne bëhet sipas tabelës 1 të specifikimeve teknike të kontratës. OE duhet të sigurojë dhe mbajë gjithmonë në dispozicion inventarin e nevojshëm për pastrim, duke përfshirë: Mjete të ndryshme për pastrim (furça, mopë, kova, etj.), Detergjentë dhe produkte kimike pastruese që janë lejuar dhe të çertifikuara për përdorim në ambiente spitalore. Të gjitha produktet dhe materialet duhet të jenë në përputhje me standardet shëndetësore dhe të sigurojnë efektivitet në pastrim dhe dezinfektim.
- Firma kontraktuese duhet të sigurojë numrin e nevojshëm të personelit për kryerjen e shërbimit të pastrimit në të gjithë ambientet e SUT. Personeli i angazhuar duhet të jetë:
 1. I përshtatshëm për detyrat e pastrimit,
 2. Plotësisht i instruktuar dhe i trajnuar për kryerjen e shërbimit sipas rregullave dhe specifikimeve teknike,
 3. I pajisur me librezë shëndetësore personale të vlefshme, për të garantuar sigurinë shëndetësore të pacientëve dhe stafit.
- OE duhet të vendosë menjëherë në dispozicion të A.K listën emërore të punonjësve të angazhuar: Së bashku me lidhjen e kontratës dhe gjatë gjithë periudhës së zbatimit të saj, për çdo ndryshim që ndodh.
Përveç listës së punonjësve, OE është i detyruar të paraqesë periodikisht dhe në mënyrë të rregullt:
 1. Listat e sigurimeve shoqërore të punonjësve,
 2. Dokumentacionin për pagesat e pagave,
 3. Grafikonin mujor të shërbimit, që tregon organizimin e punës sipas turneve dhe orarit të përcaktuar.
Këto dokumente duhet të jenë të aksesueshme dhe të dorëzohen me kohë, sipas kërkesave të A.K, për të siguruar monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të kontratës.
- OE ndërton dhe organizon strukturën e vet drejtuese, duke siguruar caktimin e përgjegjësive të pastrimit, i cili:
 - Koordinon punën e stafit të pastrimit, ndjeksin dhe monitorimin e punës në terren,
 - Mban kontakte të vazhdueshme me grupin e punës të SUT për çështjet që lidhen me këtë shërbim.
- Në rast se OE e ka të nevojshme të marrë me qera ambiente të SUT-së për magazinimin e materialeve, lidhja e kontratës së qerasë do të bëhet sipas VKM Nr. 54 datë 5.2.2014. Me mbarimin e kontratës, OE i dorëzon ambientet në gjendje të rregullt dhe të gjitha riparimet që do të kryejë në to do të ngelen pjesë e SUT. Shpenzimet që bën për riparimin,

mirëmbajtjen dhe rikonstrukcionet e nevojshme përballohen nga vetë OE. Për instalime të reja teknologjike që mund të bëhen nga OE, me perfundimin e kontratës ato i mbeten SUT-së.

- *Përgjegjësi i OE, të jetë me arsim të lartë dhe të ketë njohuri të mjaftueshme për shërbimin e pastrimit të sipërfaqeve të brendshme.*
- *Personeli i OE për zbatimin e kontratës është përgjegjës për njohjen dhe zbatimin e rregullave të pastrimit në SUT,*
 - *Personeli të zbatojë në punë orarin e caktuar nga AK.*
 - *Personeli të ketë etikë dhe komunikim gjatë procesit të punës.*
- *Personeli të jetë bashkëpunues në rastet e nevojshme dhe të veçanta për ofrimin e këtij shërbimi dhe tu përgjigjen kërkesave dhe rregullores së S.U.T-së.*
- *Trajnimi i personelit të pastrimit do të bëhet me shpenzimet e OE.*
- *Personeli të zbatojë me përpikmëri zërat e preventivit, sipas planit mujor.*
- *Personeli do të jetë i veshur me veshjet përkatëse identifikuese dhe mbrojtëse (të miratuara nga AK), me kartat identifikuese të personelit (të miratuara nga AK), si dhe do të zbatojnë rregullat e brendshme të vendosura nga AK.*
- *Sipërmarrësi është i detyruar të sigurojë me shpenzimet e veta pajisjet, makineritë dhe veglat e punës që nevojiten për përmbushjen e kontratës. Këto pajisje, makineri dhe vegla duhet që sipërmarrësi t'i sigurojë që me fillimin e punës.*

Solucionet dhe produktet lares dhe dizinfektues:

1. *Solucionet dhe produktet lares per perdorim ditor qe perdoren per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve ne ambjentet e dhomave te pacienteve, njesite e kujdesit intensive, sallat e operacionit, korridoreve, tualetet e personelt dhe pacienteve qe jane me risk te mesem dhe te larte infektimi jane:*
 - *Disinfektant dhe pastrues ditor qe hollohet ne uje me perqendrim 3%-10% me baze peroksidi hidrogjeni I cili perdoret per siperfaqet e e forta dhe te buta, porose dhe jo-pprose, nuk le shenja, me nje spekter shume te madh per luftimin e viruseve dhe baktereve.*
 - *Disinfektant dhe pastrues ditor qe hollohet ne uje me perqendrim 3%-10% me baze peroksidi hidrogjeni I cili perdoret per tavilonat e mjekeve, tavolinat e pacienteve, dollapet dhe cdo materiali tjeter qe ka rrezik per perhapjen e viruseve.*
2. *Solucionet dhe produktet lares per perdorim ditor qe perdoren per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve ne njesite e kujdesit intensive, sallat e operacionit, qe jane me risk shume te larte infektimi jane:*
 - *Produkte gati per perdorim pastrues dhe disinfektues per luftimin e sporicideve me perqendrim 3%-10% te peroksidit te hidrogjenit.*
 - *Peceta disinfektimi per luftimin e sporicideve me nje perdorim per pastrim dhe disinfektim me baze peroksidit hidrogjeni me perqendrim 3%-10%.*


Keto produkte jane te miratuara nga MSHMS per perdorim ne ambiente spitalore, ne listen e lendeve vepruese te miratuara shtojca V. Duke qene se jane produkte per perdorim spitalor dhe kane nje rendesi te vecante ne kete procedure ato duhet te shoqerohen me certifikaten e te dhenave

te sigurise, me etiketen perkatese si dhe me certifikimet perkatese ku vertetohet qe keto produkte ose ato ekuivalente te luftojne ne nje spekter shume te gjere te viruseve, baktereve dhe sporicideve ne menyre efektive dhe per nje kohe shume te shpejte. Per produktet spitalore qe kerkohen, OE duhet te demostroje lidhje midis tij dhe prodhuesit ose distributorit te autorizuar.

3. Solucion zbardhues qe perdoret per pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve. Te heqe pikat e bardha te ujit. Te perdoret edhe per larjen e pllakeve te poshtme te tualeteve me hollim 1-150 ne 1-200 me uje. Masat nga 1-10 litra. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(1-2)
4. Solucion per larje pllakash dyshemeje. Te jete sa me I koncentruar (1-200 me uje). Te lere arome te lehte pas larjes. Te jete prodhim me standarte te EU dhe I certifikuar sipas ketyre standarteve. Te kete kartat e sigurise dhe perberjes. Masa nga 1 deri ne 10 litra. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(8+/-5%)
5. Solucion per larje xhamash (me spray). Te jete prodhim me standarte te EU dhe I certifikuar. Te kete kartat e sigurise dhe perberjes. Te kete arome te lehte. Masa te jete 500-800 ml me spray. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(8.5-9)
6. Solucion per larje mobiljesh (me spray) 500 ml. Te jete prodhim me standarte te EU dhe I certifikuar. Te kete kartat e sigurise dhe perberjes. Te kete arome te lehte. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(8 -9)

Produktet duhet te jene te pajisura nga prodhuesi me certificate sigurie dhe do te paraqiten nga OE i kontraktuar përpara nënshkrimit të kontratës nga palët.

MBI SHËRBIMIN E PASTRIMIT TË AMBJENTEVE TË JASHTME Me sipërfaqet e jashtme (rrugë, trotuare, sheshe parkimi) të Spitalit Universitar të Traumës do të kuptojmë të gjithë hapësirën rreth e përqark godinave (objektet e ndërtimit) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. Të gjitha sipërfaqet, pronë e SUT-së janë të pasqyruara në këtë hartë topografike.



SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR PASTRIMIN E AMBJENTEVE TË JASHTME

- Shërbimi i Pastrimit të ambienteve të jashtme që kërkohet do të jetë 16 orësh sipas tabelës me të dhënat e sipërfaqeve si më poshtë:

Tabela Nr. 5

Nr	Sipërfaqet e jashtme per tu pastruar	Njesia	Sasia per dy turne	Dite te vitit -Pastrim i sipërfaqeve	Dite te vitit -Larja e sipërfaqeve nga 15 Mars deri ne 31 Tetor
1	Rruge	m ²	8651.9	365	230
2	Trotuare	m ²	2664.3	365	230
3	Parking	m ²	3276.1	365	230
4	Sipërfaqe te tjera te betonuara	m ²	1739	365	230
	Totali I sip. Të jashtme	m²	16331.3	365	230

Shenim:

- Të dhënat e tabelës së mësipërme janë përllogaritur duke u bazuar në të dhënat e hartës topografike të punuar nga gjeodete të certifikuar për matjet e sipërfaqeve që janë pronë e SUT duke zbritur nga totali sipërfaqet në përdorim nga të tretë.
- Këto sasi janë parashikime sipas gjendjes faktike të sipërfaqeve të jashtme që ndodhen në SUT. Këto sasi mund të ndryshojnë sipas viteve në varësi të ndryshimeve që mund të behen duke qënë se në SUT po bëhen rikonstruksione me qëllim ndryshimin e pamjes dhe kushteve sa më cilësore të qëndrimit ne spital. Këto ndryshime do të pasqyrohen në kërkesat e SUT dhe kontratave që do të nënshkruhen mes palëve në tre vitet e Marrëveshjes Kuadër.
- Tabela Nr. 6 Sipërfaqe totale për t'u pastruar

Nr	Pershkrimi I sherbimeve	Njesia	Sipërfaqe totale per tu pastruar	Dite kalendarike	Sasia per 12 muaj (2 turne)	Sasia per 36 muaj (2 turne)
1	Sipërfaqet e jashtme per t'u pastruar	m ²	16331.3	365	5,960,924.50	17,882,773.50
2	Sipërfaqet e jashtme per t'u lare	m ²	16331.3	230	3,756,199.00	11,268,597.00

Me pastrim të jashtëm do të kuptohet pastrimi i sipërfaqeve të rrugëve, trotuareve, parkingut dhe të gjithë sipërfaqeve të tjera të betonuara, pjesë që aktualisht përdoret nga Spitali Universitar i Traumës. Qëllimi ishte (dhe është), pasja e një ambjenti spitalor të pastër, brenda normave dhe kushteve që një spital duhet të ketë, eliminimi i insekteve, aromës së rëndë, dhe kryesorja e këtij shërbimi, është për të pasur në SUT një ambient të pastër dhe të përdorshëm nga të gjithë. OE i kontraktuar duhet të bëjë zëvendësimin dhe mirëmbajtjen e koshave të mbeturinave në ambientet e jashtme. Mbetjet duhet të transportohen cdo ditë në vendin e caktuar nga AK për mbledhjen e mbetjeve urbane.

Për pastrimin ditor të territorit të SUT-së, është e rëndësishme ndarja e këtij territori në zonat si më poshtë, në mënyrë që mbulimi i pastrimit të territorit të bëhet në mënyrë sa më efektive dhe sa më mirë. Shërbimi i pastrimit ditor të sipërfaqeve të jashtme të territorit të SUT do të bëhet në këto ambiente të ndara sipas këtyre zonave:

- *Hyrja kryesore dhe pjesa rreth Godinës 3-kate të Konsultave të Specializuara Ambulatore*
- *Pjesa përpara Ortopedise Nr 1, rruga të Pranim Urgjenca dhe Blloku Operator i Urgjencës dhe në krah të Pranim Urgjences dhe Blloku Operator i Urgjencës.*
- *Pjesa rreth godinës 2 kateshe ku ndodhen ambientet e Shërbimi I Urgjences Paraspitalore + Mjekësia e Trupës Parandaluese +• Sektori Mjekësor I Parandalimit të Infeksioneve Spitalore dhe rreth godinës së Sektori I Statistikes dhe Informacionit Mjekësor*
- *Pjesa e pasme e SUT, pjesa përpara Fizioterapisë dhe përpara Administratës*
- *Pjesa përpara Drejtorisë, Rreth Kirurgjise së Këmbes Diabetike dhe Angiokirurgjise dhe pjesa të ullinjtë.*

Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë, për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penaltete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

Pastrimi i jashtëm do të kryhet minimumi dy here brenda orarit të punës të percaktuar nga AK (çdo ditë dhe në dy turne, të parë dhe të dytë, jo më pak se 2 (dy) herë në ditë) dhe sa here të jete e nevojshme. Pjesët e asfaltuara dhe të betonuara do të lahen me ujë të paktën 1 (një) herë në ditë sipas sezonit për të eliminuar pluhurat dhe mikrobet.

Duhet të merren parasysh nga ana e OE, oraret e pastrimit dhe ndarjes së turneve, si më poshtë përgjatë sezoneve:

1. Sezoni Pranverë -Verë

Fillon nga ora 06:30 deri në orën në 21:00

Turni i paradites: 06:30 – 14:00 (gjysmë ore pushim)

Turni i pasdites: 13:30 – 21:00 (gjysmë ore pushim)

2. Sezoni Vjeshtë -Dimër

Fillon nga ora 06:30 deri në orën në 18:00 (mund ndryshohet me kërkesë të AK)

Turni i paradites: 06:30 – 14:00 (gjysmë ore pushim)

Turni i pasdites: 10:30 – 18:00 (gjysmë ore pushim)

Gjatë orarit të punës nuk do të mungojë për asnjë çast prezenca e punëtorëve, për të mbajtur pastër ambientet e jashtme si rrugët, parkingun, trotualet dhe çdo sipërfaqe tjetër të betonuar të territorit të jashtëm të SUT.

O.E. duhet të ketë numrin e punëtorëve dhe përgjegjësin e tyre (sipas kontratës). Kjo listë emërore do të vihet në dispozicion të A.K. menjëherë me lidhjen e kontratës.

Territori i SUT duhet të jetë i pastër nga mbeturinat e ndryshme si letra, shishe plastike, amballazhe të ndryshme etj. Mbeturinat që do të pastrohen të futen në qese plasmasi dhe të çohen në pikat e grumbullimit të mbeturinave të SUT. Në asnjë rast mbeturinat të mos digjen.

Pas pastrimit në orët e para të mëngjesit, në interval kohor cdo 2 orë do të ketë mbikqyrje të cdo punëtori të pastrimit, për zonën përkatëse.

OE kryen larjen e rrugëve cdo ditë herët në mëngjes, para orës 7.00 për periudhën 15 Mars - 31 Tetor, pra gjithsej 230 ditë. Larja e rrugëve do të bëhet sipas kërkesave të AK.

Larja e sipërfaqeve të jashtme (sipas tabelës nr.4) do të bëhet me makinë larëse (autobot), nga OE dhe jo me ujin e SUT-së.

Detyrat e Kontraktuesit

- *Përgjegjësi i OE, të jetë me arsim të lartë dhe të ketë njohuri të mjaftueshme për shërbimin e pastrimit të sipërfaqeve të brendshme.*
- *Personeli i OE për zbatimin e kontratës, është përgjegjës për njohjen dhe zbatimin e rregullave të pastrimit në SUT.*
- *Veshja e punonjësve do të jetë sipas kërkesave të S.U.T-së.*
- *Personeli të zbatojë në punë orarin e caktuar nga S.U.T-së.*
- *Personeli të ketë etikë dhe komunikim gjatë procesit të punës.*
- *Personeli të jetë bashkëpunues në rastet e nevojshme dhe të veçanta për ofrimin e këtij shërbimi dhe t'u përgjigjen kërkesave dhe rregullores së S.U.T-së.*
- *Trajnimi i personelit të pastrimit do të bëhet me shpenzimet e kontraktuesit.*
- *Punëtorët do të jenë të veshur me veshjet përkatëse identifikuese të pajisur me doreza (të miratuara nga AK), me kartat identifikuese të personelit (të miratuara nga AK), si dhe do të zbatojnë rregullat e brendshme, të vendosura nga AK.*
- *OE është i detyruar të sigurojë me shpenzimet e veta pajisjet, makineritë dhe veglat e punës që nevojiten për përmbushjen e kontratës. Këto pajisje, makineri dhe vegla duhet që ai t'i sigurojë që me fillimin e punës.*

Lidhur me specifikimet teknike të konsideruara si të pa përmbushura nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, KSHA konstaton se një nga elementët kyçë është dorëzimi i fletëve /dokumenteve të të dhënave të sigurisë (MSDS) të produkteve, të lëshuara ekskluzivisht nga prodhuesi i produktit dhe kjo kërkesë ka një funksion thelbësor për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe konformitetit të produktit që do të përdoret nga operatori ekonomik në ofrimin e shërbimit të kërkuar.

MSDS është dokumenti zyrtar ku prodhuesi deklaron përbërjen kimike të produktit, rreziqet e mundshme, masat parandaluese, trajtimin në raste emergjente, mënyrat e përdorimit dhe standardet ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë që ai produkt përmbush. Për këtë arsye, vetëm prodhuesi ka njohurinë teknike, përgjegjësinë juridike dhe autoritetin ligjor për të lëshuar një dokument të tillë. Çdo MSDS që nuk vjen nga prodhuesi, në vetvete, i pavlefshëm, pasi nuk garanton dot as saktësi teknike, as origjinë të produktit, as përgjegjësi ligjore.

Në procedurën e prokurimit publik objekt ankimi, specifikimet teknike kërkojnë qartë dorëzimin e këtyre dokumenteve për të vërtetuar se produktet e ofruara janë në përputhje me standardet e sigurisë dhe kërkesave të kontratës. Operatorët ekonomikë ofertues kishin detyrimin jo vetëm të deklaronin se produktet përputhen me këto kërkesa, por edhe të provonin këtë përputhje me dokumentacion zyrtar të lëshuar nga prodhuesi.

Në rastin e operatorit ekonomik ankimes "Rej" shpk, është konstatuar se MSDS-ja e paraqitur nuk është lëshuar nga prodhuesi, dhe rezulton se subjekti që e ka lëshuar nuk ka statusin dhe

licencimin e nevojshëm për të vepruar si prodhues. Ky fakt e shndërron dhe madje e shteron plotësisht vlerën e dokumentit të paraqitur. Një MSDS e pa lëshuar nga një subjekt prodhues është teknikisht e barabartë me mos paraqitjen e këtij dokumenti, pasi nuk përmbush asnjë funksion dhe nuk ofron asnjë garanci për autoritetin kontraktor.

Ky mosrespektim i kërkesës bazë e bën ofertën teknikisht të pavlefshme, duke pamundësuar vlerësimin e mëtejshëm lidhur me përmbushjen e specifikimeve teknike dhe përbën kusht për skualifikim.

Për sa më sipër, pretendimet e Operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

II.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Rej" shpk për s'kualifikimin e operatorit ekonomik "AIR" shpk lidhur me Licensën e lëshuar nga QKB, me kodin II.8.A.

Në kapacitetin teknik të dokumenteve standarte të tenderit, është përcaktuar që:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me Kodin II.8.A- shërbime ekspertize higjiëno-shëndetësore.

Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, datë 23.09.2025 është argumentuar qartazi se:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 41, pika 4, gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke siguruar kështu AK që shërbimi do të kryhet nga operatorë të cilët disponojnë kapacitetet profesionale për kryerjen e këtij shërbimi, brenda standarteve.

Lloji dhe kategoria e licensës, mbështetet në ligjin nr.10 081, date 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimit nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas vverifikimeve të kryera në të dhënat zyrtare të publikuara të Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstaton se operatori ekonomik "AIR" shpk posedon licenën e kërkuar sipas dokumenteve të tenderit, konkretisht Licensën me Kod II.8.A, LN-7371-05-2019, me kategori "Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjenosanitare" dhe nënkategori "Shërbime ekspertize higjiëno-sanitare", afati i vlefshmërisë "pa afat".

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.5. Lidhur me të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Rej" shpk për s'kualifikimin e operatorit ekonomik "AIR" shpk, KSHA konstaton;

Në Nenin 111, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) parashikohet se: "2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e

ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën".

Në lidhje me përcaktimin ligjor mbi ankesën, ligjvënësi ka parashikuar ndër të tjera se çdo OE ankimues duhet të paraqesë dokumentacionin dhe provat përkatëse mbi të cilat mbështeten pretendimet e ngritura nëpërmjet Formularit të ankesës. Pra, barra e provës për të provuar paligjshmërinë e një vendimarrjeje është e ankimuesit, i cili në çdo rast duhet të paraqesë dokumentacionin provues.

KSHA arsyeton se të gjitha pretendimet e ngritura nga BOE ankimues mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e OE-ve nuk janë të mbështetura mbi fakte e prova, pra janë të ngritura "a priori".

KSHA konstaton se çdo pretendim i parashtruar nëpërmjet Formularit të Ankesës nga Ankimuesi është i ndërtuar mbi njohuritë e tij të përgjithshme si dhe mbi supozimet e vetë ankimuesit dhe në asnjë rast nuk evidentohet asnjë dokumentacion zyrtar apo provë ligjore e bashkëlidhur që të argumentojë dhe të provojë ekzistencën e shkeljeve të pretenduara.

Në kuptim të legjislacionit për prokurimin publik në fuqi, ankimuesi ka detyrimin ligjor për të provuar dhe dokumentuar çdo shkelje të pretenduar. Pra në rastin konkret BOE ankimues duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, fakte, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës provues, në bazë të të cilave do të mund të shqyrtohej kjo ankesë.

Në çdo rast, ankimuesi ka detyrimin që të bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërbushjen e kriterit/kritereve nga ana e Operatorëve ekonomikë të tjerë të kualifikuar.

KSHA gjykon se është në të drejtë të Operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktor për kualifikimin e ofertës së Operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, Operatorët ekonomikë ankimues nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori, duke iu referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, e duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështen pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në Nenin 82, pika 1 të tij se "*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*".

Një ankim pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo një pjesë të elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar, bazuar në LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, konsiderohet abuziv dhe cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KSHA.

Për sa më sipër, pretendimet e Operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

II.5. Lidhur me të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Rej" shpk për shtimin e arsyeve të s'kualifikimit të operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" shpk dhe "Clean Fast" shpk, KSHA konstaton;

Në nenin 109 “E drejta e Ankimit”, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Pas shqyrtimit administrativ, operatorët ekonomikë kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji, si dhe në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës citon se çdo operator ekonomik ka të drejtën të paraqesë një ankesë vetëm për ato çështje që lidhen drejtpërdrejt me pozitën e tij në një procedurë prokurimi dhe me mënyrën se si vendimet e autoritetit kontraktor ndikojnë në të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme. Kjo e drejtë rrjedh nga parimi i interesit të ligjshëm, sipas të cilit një ankesë është e vlefshme vetëm nëse subjekti që ankohet demonstroi se vlerësimi/vendimi i kontestuar ka prodhuar ose mund të prodhojë pasoja ndaj statusit të tij në procedurë.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “Rej” shpk që është vetë i skualifikuar nuk mund të pretendojë në ankesë që “të kualifikohet në mënyrë të tërthortë” duke paraqitur pretendime për një operator tjetër që po ashtu është i skualifikuar. Kjo për faktin se skualifikimi i një operatori tjetër nuk ndryshon dhe nuk përmirëson statusin procedural të vetë operatorit ekonomik ankimes. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave citon se rekursi i tij duhet të kufizohet vetëm te ligjshmëria e skualifikimit të tij, dhe jo te pretendime të pavlefshme për operatorë ekonomikë të tjerë që nuk kanë asnjë ndikim në rivlerësimin e tij.

Për më tepër, një operator i skualifikuar nuk ka as interes dhe as legjitimitet të kërkojë shtimin e arsyeve të skualifikimit për një operator tjetër të skualifikuar, sepse edhe nëse pretendimet e tij do të merreshin parasysh, rezultati përfundimtar nuk do të ndryshonte pozitën e tij, as nuk do të çonte në kualifikimin e tij.

Interesi i tij i ligjshëm përkundrejt procedurës së prokurimit objekt ankimesi është i shtuar, pasi skualifikimi i tij përbën një pengesë juridike të pavarur, të cilën asnjë zhvillim ndaj operatorëve të tjerë nuk mund ta tjetërsojë. Kjo është arsyeja pse ankesa e operatorit ekonomik “Rej” shpk, duhet të kufizohet vetëm tek shqyrtimi i vendimit që lidhet me ofertën dhe dokumentacionin e tij, dhe jo te çështjet që prekin ofertat e subjekteve të tjera, të cilat nuk sjellin asnjë efekt konkret mbi pozicionin e tij.

Në këtë kuadër, kërkesa e një operatori të skualifikuar për të shtuar arsye skualifikimi ndaj një operatori tjetër që është gjithashtu i skualifikuar është e pambështetur ligjërisht, bie ndesh me parimin e interesit të ligjshëm, tejkalon kufijtë e objektit të ankimit dhe nuk ka asnjë lidhje me ripozicionin e tij të mundshëm në këtë procedurë prokurimi objekt ankimesi.

Për sa më sipër, pretendimet e Operatorit ekonomik ankimes nuk merren në shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Të refuzojë ankesën e paraqitur nga Operatori ekonomik "REJ" shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.12. Me shkresën nr. 2982/14 prot, datë 25.11.2025 "Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "REJ" shpk, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: 'Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës'." protokolluar me tonën me nr. 3257/5 prot, datë 27.11.2025, nëpërmjet shërbimit postar është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, "Vendim KSHA 135/2025", datë 21.11.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "REJ" SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, si dhe ka dërguar dokumentacionin fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik "AIR" SHPK.

II.13. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues "REJ" SHPK ka paraqitur informacion shtesë lidhur me pretendimin e tij për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "AIR" SHPK, i cili u protokollua pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3257/6 prot., datë 03.12.2025.

II.14. Në datën 14.11.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6077, datë 14.11.2025 dhe numër protokoll nr. 3276/2025, datë 14.11.2025 e operatorit ekonomik "Clean Fast" SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Clean Fast" SHPK, si dhe kundërshtohet kualifikimi i ofertës së operatorit ekonomik "AIR" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.15. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3276/1 prot, datë 17.11.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Clean Fast"

SHPK, si dhe lidhur me kërkesën për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AIR” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.16. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Clean Fast” SHPK me shkresën “Shkresë sqaruese” e datës 17.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3276/2 prot, datë 18.11.2025 ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik si më poshtë vijon:

“Kompania "Clean Fast" SHPK -me NIPT:L61807037R me adresë- Bulevardi “Bajram Curri”, ETC 13/30 Tiranë, përfaqësuar nga, Eriola Likaj kërkon të bëjë një shkresë sqaruese drejtuar KPP Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me objektin e tenderit: “Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, nga Autoriteti/Enti Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara me vlerë 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtedhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Leke, pa TVSH me Kod CPV 98341130-5.

Në Ankesën drejtuar KPP dhe nënshkruar në e-Albania me nr A/2025/6077 në bazë të njoftimit ditën e sotme nga KPP i është bashkangjitur dokumenti përkatës i ankimit kundrejt objektit të tenderit: “Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”.

Pavarsisht këtij dokumenti që ne i bashkangjitem kryem dhe një aplikim të ri me të njëjtën procedurë ankimi, duke i bashkangjitur dhe mandat pagesën e kryer nga ana jonë ditën e premte datë 14.11.2025 dhe ky aplikim ka marre një numer të ri A/2025/6086 që është indetik me aplikimin e mëparshëm.

Me respektin dhe konsideratën më të lartë!.”.

II.17. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “AIR” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3276/4 prot., datë 20.11.2025.

II.18. Me shkresën nr. 2982/16 prot, datë 27.11.2025 “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “CLEAN FAST” shpk, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: ‘Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës’.” protokolluar me tonën me nr. 3276/5 prot, datë 02.12.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 138/2025”, datë 26.11.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Clean Fast” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit duke argumentuar:

“II.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "CLEAN FAST" shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa I "Shkaqet e

përrjashtimit", Seksioni D:

Në Nenin 2 "Qëllimi" të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

"Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."*

Ndërkohë në Nenin 3 "Parime të përgjithshme" të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale."

Në nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

"1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- dh) falsifikim;*
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve

të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat e rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e

prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.”.

Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga

autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

New pikwn 1 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.”.

New nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuarparashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në

kopje të njësuar me origjinalin.

Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumente në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

Referuar bazës ligjore të lartpërmendur, si edhe legjislacionit në fuqi në tërësi për prokurimin "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", përbën një provë paraprake në vend të disa vërtetimeve/dokumenteve të lëshuara nga ente të caktuara publike ose palë të tjera të treta dhe në këtë kuptim çdo deklaram i bërë përfshirë edhe dhënien e informacioneve të nevojshme ndihmëse për verifikimin e këtyre deklarameve është barrë dhe përgjegjësi e operatorit ekonomik ofertues.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të operatorit ekonomik ankimues, KSHA konstaton se operatori ekonomik "CLEAN FAST" shpk nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referuese për plotësimin e të gjitha rubrikave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Konkretisht për rubrikën "Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. Operatori ekonomik lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. Operatori ekonomik nuk ka masë ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH, nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e të cilit do të kryhet verifikimi.

KSHA gijkon se operatorët ekonomike janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pavlefshme.

Referuar sa më sipër, KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 9, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e nevojshme për dy prej rubrikave të cituara më sipër në këtë vendim siç ky formular parashikon. KSHA gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër, KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues "CLEAN FAST" shpk nuk ka dhënë informacionin e nevojshëm lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur deklarime me karakter thjesht pohues lidhur me respektimin e legjislacionit të punës, mosdiskriminimin, lidhjen e kontratave të punës dhe mungesën e masave ndëshkimore nga ISHPSHSH, këto deklarime nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për qëllimet e një procesi transparent verifikimi. Vetë natyra e pretendimeve të paraqitura kërkon që operatori të ofrojë sqarime të detajuara dhe indiciet dokumentuese që mundësojnë verifikimin objektiv të këtyre pohimeve.

Deklarimet e përgjithshme nuk përbëjnë provë dhe nuk garantojnë se operatori ekonomik ankimues, në praktikë, ka zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara për sigurinë dhe shëndetin në punë, për mbrojtjen nga diskriminimi apo për administrimin e marrëdhënieve të punës. Për të vërtetuar këto elementë, operatori ishte i detyruar të paraqiste indicie ose të citonte dokumentacion mbështetës, si kontrata pune, evidenca të trajnimeve për sigurinë, procesverbale nga kontrollet e ISHPSHSH, raportime të masave të ndërmarra, apo çdo dokument tjetër zyrtar që provon përputhshmerinë me kërkesat ligjore.

Mungesa e këtyre provave dhe informacioneve e bën të pamundur kryerjen e një verifikimi të plotë, të paanshëm dhe të besueshëm, duke çënuar në këtë mënyrë kërkesën që çdo ofertë duhet të jetë e kontrollueshme dhe e bazuar në fakte. Kjo situatë krijon risk që deklarimet të jenë vetëm formale dhe jo reale, prandaj operatori kishte detyrimin material dhe procedural të shoqëronte deklarimet me indicie konkrete dhe sqarime të duhura.

Për më tepër, KSHA thekson se KVO në mbështetje të skualifikimit është referuar dhe në vendimmarrjen e KPP, konkretisht në vendimin Nr.816/2025, datë 27.06.2025. Gjithashtu, në mbështetje të arsyeve të skualifikimit nga KVO të operatorit ekonomik ankimues, KSHA thekson se me të njëjtin arsyetim, KPP në vendimin Nr. 209/2025, datë 07.02.2025 ka gjykuar të drejtë skualifikimin për mosplotësimin e 2 rubrikave të sipërcituara të operatorit ekonomik në procedurën përkatëse, konkretisht me arsyetimin se: "Komisioni konstaton, se operatori

ekonomik ankimues nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referuese për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Konkretisht për rubrikat: Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate; Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë, nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pavlefshme. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 10, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e nevojshme për dy prej rubrikave të cituara më sipër në këtë vendim siç ky formular parashikon, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues "4 S" SHPK ka plotësuar disa prej rubrikave të formularit përmbledhës të vetedeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, ndërsa për dy rubrika të cituara më lart, lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme për kualifikim, nuk ka dhënë informacionin që ky formular kërkon, duke mosplotësuar kështu pikën 2.a të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas Shtojcës.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "CLEAN FAST" shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij lidhur me vlefshmërinë e sigurimit të ofertës, KSHA arsyeton se:

Në nenin 83 "Sigurimi i ofertës" të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar

përcaktohet se:

“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të:

a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;

b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit.

c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse:

a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;

b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit;

c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton përmes Sistemit të Prokurimit Elektronik pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e refuzimit të operatorit ekonomik për nënshkrimin e kontratës, sipas shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.”.

Referuar VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 30 “Sigurimi i ofertës” ku parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

4. Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet:

a) të mos vendosë asnjë kusht për pagimin;

b) të paguajë shumën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës zyrtare të autoritetit/entit kontraktor.

5. Autoriteti/enti kontraktor duhet t’ua kthejë apo t’ua lirojë ofertuesve sigurimin e ofertës jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga:

a) data kur ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës, për të gjithë ofertuesit, përveç ofertuesit/ve fitues;

b) data kur është lidhur kontrata, për ofertuesin/it fitues;

c) data kur janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues, për të gjithë ofertuesit.

6. Autoriteti/enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës, në rast të:

a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;

b) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese;

c) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. Në rast se kontrata nuk nënshkruhet nga ofertuesi fitues për ndonjë situatë të forcës madhore, autoriteti kontraktor nuk mban sigurimin e ofertës.

7. Rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 6, të këtij neni, raportohen nga autoriteti/enti kontraktor pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim veprimin nga kjo e fundit, sipas parashikimeve të nenit 78, të LPP-së.

8. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe asaj në vend të dytë, është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Me të njëjtën rregull, mund të kalohet tek ofertat e renditura në vijim, në rast se diferenca e

ofertës së radhës me ofertën fituese fillestare, të mos jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, të renditur para saj.”.

Referuar VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 24 “Udhëzime për ofertuesit/kandidatët”, pika 8, ku parashikohet shprehimisht se: “8. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 (pesë) ditë përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshmërinë e ofertave, autoriteti/enti kontraktor mund t’i kërkojë ofertuesit, me shkrim, të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton autoritetin/entin kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së autoritetit/entit kontraktor, lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë autoriteti/enti kontraktor do të refuzojë ofertën.

Nëse autoriteti/enti kontraktor nuk ka bërë një kërkesë me shkrim për operatorin ekonomik që të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë mungesë.”.

Në Dokumentet e Tenderit, Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, B "PËRGATITJA E OFERTAVE", Pika 9, citohet se:

- 1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Ofertave të percaktuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.*
- 2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërin nga format e mëposhtme:*
 - a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor;*
 - b) Garanci bankare;*
 - c) Garanci sigurimi.*

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

- 3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t’i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Entin Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së*

vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjale, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën"

Në Dokumentat e Tenderit, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", pika 1, gërma b. përcaktohet se: "Ofertuesi duhet të paraqesë: Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;"

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues "CLEAN FAST" shpk konstaton se për dokumentin e dorëzuar "Sigurim oferte", konstaton se afati 150-ditor nuk fillon nga data e mbylljes së tenderit (20.10.2025) por fillon nga data 16.10.2025 deri më 15.03.2026, kur sipas kërkesës duhej të përfshinte periudhën 20.10.2025 - 18.03.2026 (150 ditë).

Lidhur me pretendimin konkret të operatorit ekonomik "CLEAN FAST" shpk se: "...edhe nëse periudha e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës së shoqërisë "Clean Fast" shpk ishte katër ditë më pak e mbuluar me sigurim oferte (gjë që nuk është e vërtetë sepse nuk thuhet në DST). ..."

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson faktin se njoftimi i shkurtuar i kontratës pjesë e dokumenteve të tenderit, përmban të gjithë informacionin e nevojshëm administrativ që nëpërmjet publikimit i vihet në dispozicion të gjithë palëve të interesuara dhe palëve ofertuese, për përgatitjen e dokumenteve të tyre. Në këtë njoftim ndër të tjera është përcaktuar edhe data e hapjes së ofertave dhe zhvillimit të tenderit por, është detyrë e operatorëve ekonomikë ofertues të dëshmojnë datën e fillimit të vlefshmërisë së një dokumenti e në rastin konkret të sigurimit të ofertës.

Pra, operatori ekonomik "CLEAN FAST" shpk ka dështuar në dëshmimin e datës së fillimit dhe përfundimit të vlefshmërisë së sigurimit të ofertës. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se dokumentet e ofertimit duhet të jenë të sakta, të qarta dhe pavend për interpretime apo nënkuptime, në mënyrë që autoriteti kontraktor të jetë në gjendje të verifikojë objektivisht përmbushjen e kërkesave të tenderit. Mospërcaktimi i datës së fillimit të vlefshmërisë së sigurimit të ofertës përbën një mospërputhje të qartë me këto kërkesa dhe krijon pasiguri lidhur me vlefshmërinë reale të ofertës në momentin e hapjes së tenderit.

Në këte rast, ishte barrë prove e operatorit ofertues të dëshmojë që dokumenti i sigurimit të ofertës ka qënë i vlefshëm që nga data e hapjes së ofertave. Nëse operatori ofertues nuk e provon këtë në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar, atëherë oferta e tij konsiderohet jo në përputhje me kriteret e Dokumenteve të Tenderit dhe përbën kusht për skualifikim.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson, se nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr.

162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin parashikohet se: "1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.". Kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose menyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarim pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se "1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. [...]"

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Clean Fast" shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij lidhur me solucionin për pastrim për mobilie, i cili, sipas të dhënave teknike të paraqitura në katalog, përdoret vetëm për sipërfaqe rezistente ndaj ujit, KSHA arsyeton se:

Në nenin 36 "Specifikimet teknike" të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar) parashikohet shprehimisht se:

"1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane."

Në nenin 41, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

“1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”.

Në Shtojcën 8 të dokumentave të tenderit është përcaktuar se:

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE “SHËRBIM PASTRIMI PËR SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SHËRBIMIN E PASTRIMIT TË AMBIENTEVE TË BRËNDSHME

Solucion per larje mobiljesh (me spray) 500 ml. Te jete prodhim me standarte te EU dhe I certifikuar. Te kete kartat e sigurise dhe perberjes. Te kete arome te lehte. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(8 -9)

Produktet duhet te jene te pajisura nga prodhuesi me certificate sigurie dhe do te paraqiten nga OE i kontraktuar përpara nënshkrimit të kontratës nga palët.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të specifikimeve teknike, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se solucioni i pastrimit i ofertuar është i dedikuar për mobilje me sipërfaqe rezistente ndaj ujit ndërkohë që kërkesa e përcaktuar sipas specifikimeve teknike, pjesë e dokumenteve të tenderit, ka qënë për solucion pastrimi për mobiljet, pra në formë të përgjithshme papërcaktuar natyrën specifike të tyre dhe ëe mund të aplikohet në një gamë më të gjërë sipërfaqesh, duke përfshirë ato që nuk janë rezistente ndaj lagështisë.

Mobiljet mund të kenë sipërfaqe të ndryshme që kërkojnë metoda të ndryshme pastrimi dhe një solucion i përqëndruar vetëm tek pastrimi i sipërfaqeve rezistente ndaj ujit nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e kërkuara. Pjesa më e madhe e mobiljeve kanë sipërfaqe që janë më të ndjeshme ndaj lagështisë dhe nuk mund të pastrohen në të njëjtën mënyrë si ato me sipërfaqe rezistente kundrejt ujit. Pra, kërkesa ishte për solucion pastrimi për sipërfaqe të ndryshme mobiljesh, pra për një gamë më të gjërë materialesh dhe që nuk ka rrezik për t'i dëmtuar ato.

Solucioni i ofertuar nga operatori ekonomik ankimues është shumë specifik dhe i kufizuar për pastrimin e sipërfaqeve të mobiljeve rezistente ndaj ujit dhe nuk i përgjigjet kërkesave për pastrim të të gjitha llojeve të mobiljeve. Në thelb, ofrimi i një solucioni të tillë është shumë kufizues dhe nuk e plotëson kërkesën për një pastrim të përgjithshëm, që duhet të jetë më fleksibël dhe të mundësojë trajtimin e një spektri më të gjërë sipërfaqesh të mobiljeve. Për më tepër, solucionet që janë të dedikuara për sipërfaqe mobiljesh rezistente ndaj ujit kanë përbërës dhe janë të përshtatshëm për materiale që mund të përthithin lagështinë psh: dru të lyer, lekurë, por këta përbërës janë të dëmshëm dhe jo të përshtatshëm për materialet e tjera si tekstilet ose plastika.

Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura nga operatori ekonomik, u verifikua artikulli "Solucion për larje mobiljesh (me spray) 500 ml", për të cilin në dokumentet e tenderit, specifikimet teknike përcaktojnë kërkesa shumë të qarta: produkti duhet të jetë i prodhuar sipas standardeve të Bashkimit Europian, i certifikuar, i shoqëruar me kartat e sigurisë dhe të përbërjes, me aromë të lehtë, të jetë pjesë e një linje profesionale dhe të ketë nivel pH midis 8-9. Këto kritere synojnë garantimin e cilësisë, sigurisë dhe përshtatshmërisë së produktit për përdorim të përgjithshëm në mobilje.

Megjithatë, nga dokumentacioni teknik i paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se produkti i ofertuar është një solucion pastrimi i destinuar specifikisht vetëm për mobilje rezistente ndaj ujit.

Kjo kufizon ndjeshëm fushën e përdorimit të tij dhe bie ndesh me kërkesën e tenderit për një solucion të përgjithshëm për pastrim mobiljesh, pa kufizime mbi llojin e materialit. Për pasojë, produkti i ofertuar nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara dhe operatori ekonomik ofertues nuk mund të konsiderohet përmbushës për këtë artikull.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Clean Fast" shpk për paraqitjen e autorizimit fotokopje, mos marrjen në konsideratë të dokumentit MSDS për këtë arsye si dhe mungesa e koherencës së datave në dhënien e autorizimit të prodhuesit.

Në kapacitetin teknik të dokumentrave të tenderit është përcaktuar që:

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, për solucionet e renditur në pikën 3,4,5,6 "Solucionet dhe produktet lares dhe dizifektues", Seksioni 2- Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm", Shtojca 8 "Specifikimet teknike") duhet të paraqesë:

- dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenit 13 dhe 15 të Ligjit nr.27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve", VKM nr.9 datë 09.01.2019 "Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë". Është vlerësuar e rëndësishme që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentin me të dhënat e sigurisë të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të produkteve të cituar në këtë kriter, me qëllim që të sigurohet një nivel i lartë mbrojtje ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit, duke shmangur çdo efekt të dëmshëm që mund të vijë nga përdorimi i tyre.*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide (nëse ofron një lëndë biocide) të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ligjit 95/2015 "Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020 "Përcaktimi i rregullave për vlerësimin e produkteve biocide dhe i procedurës për dhënien e autorizimit për vendosjen e tyre në treg", ky kriter është thelbësor për sigurimin e përdorimit korrekt, të sigurt dhe në përputhje me ligjin të produkteve biocide. Ky kriter garanton që operatori ekonomik ka njohuri teknike për produktin, duke shmangur rreziqet për shëndetin publik gjatë përdorimit dhe gjithashtu ndihmon në gjurmueshmërinë dhe ruajtjen e standarteve profesionale në treg.*

Gjithashtu është përcaktuar se:

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë”, pika 2 të VKM NR. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”.

Në manualin "Për Regjistrimin Operatorëve Ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik", miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik me Vendim Nr. 13, datë 28.12.2021, në pikën 3 "Dorëzimi i ofertës në procedurat pa lote", faqe 19 ndër të tjera përcaktohet se: "Para se të filloni me ngarkimin e dokumentave, duhet të siguroheni që të gjithë dokumentat të jenë të konvertuara në mënyrë elektronike në formatin pdf në kompjuterin tuaj. Dokumentat e skanuara duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar. Versioni i skanuar i këtyre dokumentave, pasi hidhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për një procedurë prokurimi konkrete është i barazvlefshëm me dokumentin original, ose kopjen e noterizuar.".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se dokumenti autorizim prodhuesi është fotokopje i panoterizuar. Në këtë kontekst, referuar DT dhe pikës 3 të manualit "Për Regjistrimin Operatorëve Ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik", ku përcaktohet se të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, mosparaqitja e një dokumenti origjinal ose kopje e noterizuar e tij, konsiderohet kusht për skualifikim. Mungesa e noterizimit çënon vlefshmërinë formale të dokumentit dhe nuk garanton autenticitetin e tij. Për këtë arsye, dokumenti nuk mund të merret si provë e plotë dhe e besueshme për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vëren gjithashtu se edhe skeda e të dhënave të sigurisë (MSDS), e cila është paraqitur nga operatori ekonomik në mbështetje të autorizimit të prodhuesit, nuk mund të merret në konsideratë. Kjo, pasi dokumenti MSDS, pavarësisht rëndësisë së tij teknike për përshkrimin e karakteristikave të produktit, nuk shërben si provë ligjore për vërtetimin e marrëdhënies zyrtare midis operatorit ekonomik dhe prodhuesit. Në mungesë të një autorizimi origjinal ose të noterizuar, MSDS nuk e kompenson dot këtë mangësi, sepse nuk përmban elementë që vërtetojnë të drejtën e operatorit për të vepruar në emër të prodhuesit.

Dokumenti MSDS ka funksion thjesht informues dhe teknik, duke përshkruar përbërjen kimike, rreziqet, masat e sigurisë dhe parametrat e përdorimit të produktit. Ai nuk ka natyrë autorizuese dhe nuk ka fuqinë juridike për të konfirmuar autorizim, përfaqësim, apo marrëdhënie kontraktuale.

Për më tepër, fleta MSDS mund të jetë dokument i aksesueshëm publikisht ose i shpërndarë në mënyrë të përgjithshme për të gjithë përdoruesit e produktit, gjë që nuk e bën një dokument të personalizuar për operatorin ekonomik ofertues.

Për këto arsye, edhe pse është paraqitur si dokument, MSDS për solucionin larës për mobilje, nuk përbën provë të mjaftueshme dhe të vlefshme për të mbështetur pretendimin e operatorit mbi ekzistencën apo vlefshmërinë e autorizimit të prodhuesit. Komisioni thekson se përmbushja e kërkesave duhet të bëhet me dokumente të cilat kanë forcë ligjore dhe garantojnë autenticitet, saktësi dhe lidhje direkte midis palëve të interesuara."

Për më tepër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nga vlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave vëren se: "Autorizimi i lëshuar nga prodhuesi (Johannes Kiehl KG) për distributorin "Globi" shpk mban datën 13.10.2025, nëpërmjet të cilit konfirmohet se "Globi" shpk është përfaqësuesi i vetëm zyrtar për produktet "Kiehl" në Shqipëri. Kjo Certifikatë hyn në fuqi nga data e lëshimit dhe është e vlefshme "deri në revokim". Ndërkohë, Autorizimi i lëshuar nga distributori (Globi SHPK) për shoqërinë "Clean Fast" Sh.p.k mban datë lëshimi 01.10.2025, nëpërmjet të cilit Globi SHPK autorizon Clean Fast SHPK të përdorë produktet "Kiehl Group" dhe dokumentacionin teknik për një procedurë të caktuar prokurimi".

Gjithashtu, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton mospërputhjen kohore ndërmjet dy autorizimeve. Autorizimi që prodhuesi "Johannes Kiehl KG" i jep "Globi" sh.p.k mban datën 13.10.2025 dhe është i vlefshëm vetëm nga data e lëshimit të tij e në vijim. Kjo do të thotë se statusi i "Globi" sh.p.k si përfaqësues i vetëm zyrtar i produkteve "Kiehl" në Shqipëri ka filluar vetëm nga data 13.10.2025. Ndërkohë, "Globi" sh.p.k i ka lëshuar "Clean Fast" sh.p.k një autorizim më herët, konkretisht me 01.10.2025 - pra 12 ditë para se "Globi" të pajisej vetë me autorizimin zyrtar nga prodhuesi. Kjo krijon një situatë juridike të pamundur, në datën 01.10.2025, "Globi" shpk nuk kishte ende asnjë të drejtë ligjore ose kontraktuale nga prodhuesi për të deleguar autorizime të tilla tek palë të treta. Në thelb, "Globi" i ka kaluar "Clean Fast"-it një të drejtë të cilën vetë nuk e kishte në momentin e lëshimit të dokumentit.

Referuar të drejtës civile dhe në praktikat e prokurimit zbatohet parimi i përgjithshëm juridik "nemo dat quod non habet" sipas të cilit askush nuk mund të transferojë një të drejtë që vetë nuk e zotëron.

Në datën 01.10.2025, "Globi" shpk nuk ishte ende përfaqësues zyrtar i "Johannes Kiehl KG". Për rrjedhojë nuk kishte të drejtë ekskluziviteti, nuk kishte autorizim për përdorimin e dokumentacionit teknik, nuk kishte të drejtë të autorizonte operatorë të tjerë për të marrë pjesë në tender me produktet "Kiehl". Çdo autorizim i dhënë nga "Globi" shpk para datës 13.10.2025 është i pavlefshëm në vetvete, pavaresisht përmbajtjes që ai mund të mbajë. Kjo

pavlefshmëri nuk është formale, por thelbësore, sepse prek të drejtën themelore të përfaqësimit të markës dhe autenticitetin e dokumentacionit teknik - elementë që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, origjinën dhe garancinë e produkteve të ofruar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, konstatohet se autorizimi i operatorit ekonomik ofertues "CLEAN FAST" shpk nuk mund të konsiderohet i vlefshëm retroaktivisht. Pretendimi i ankimuesit se nocioni i vlefshmërisë "deri në revokim" nënkupton që dokumenti mund të mbulojë edhe periudha të mëparshme ose se prodhuesi e njeh me efekt retroaktiv marrëdhënien e përfaqësimit. Por në këtë rast, Autorizimi është i vlefshëm vetëm nga data e lëshimit, siç është shprehur qartë, në mënyrë eksplicite se hyn në fuqi më 13.10.2025. Në SPE nuk është paraqitur asnjë referencë për vlefshmëri retrospective dhe gjithashtu minimalisht prodhuesi nuk ka dhënë asnjë deklaratë plotësuese që të justifikojë delegimin e të drejtave para datës së autorizimit. Kjo e bën juridikisht të pamundur që autorizimi i prodhuesit të përdoret si bazë për një autorizim të lëshuar 12 ditë më herët. Pra, duke qënë se autorizimi i paraqitur nga "Clean Fast" shpk bazohet në një dokument të lëshuar nga një subjekt që në atë moment nuk kishte kompetencën e delegimit, ky autorizim është i pavlefshëm dhe nuk provon dot përfaqësim të ligjshëm të produkteve "Kiehl". Kjo pavlefshmëri nuk lidhet me një mangësi të thjeshtë formale, nuk mund të korrigjohet nëpërmjet plotësimit të mëvonshëm dhe cënon një kriter thelbësor kualifikimi.

Ndërsa lidhur me pretendimin e ankimuesit se subjekti "Globi" shpk e ka marrë një autorizim që në datë 29.01.2024, pra më herët në periudhe kohore, KSHA thekson se nëse një dokument nuk është paraqitur në sistem gjatë fazës së ofertimit, ai konsiderohet i munguar dhe nuk mund të merret parasysh në fazën e shqyrtimit të ankesës, pasi kjo cënon rënde parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Prandaj, edhe nëse dokumenti ekziston fizikisht, ligjërisht ai është i pavlefshëm për këtë procedurë, sepse është paraqitur me vonesë, në një fazë kur sistemi nuk lejon me korrigjime apo dokumente të reja.

Organi i ankimimit nuk ka kompetencë të pranojë dokumente të reja, por vetëm të shqyrtojë ligjshmërinë e procedurës mbi bazën e dokumenteve të dorezuara brenda afatit.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

II.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "CLEAN FAST" shpk për s'kualifikimin e operatorit ekonomik "AIR" shpk lidhur me Licensën e lëshuar nga QKB, me kodin II.8.A.

Në kapacitetin teknik të dokumentave standarte të tenderit është përcaktuar se:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me Kodin II.8.A- shërbime ekspertize higjiëno-shendetësore.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), të Ligjit nr. 162/2020*

“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke siguruar kështu AK që shërbimi do të kryhet nga operatorë të cilët disponojnë kapacitetet profesionale për kryerjen e këtij shërbimi, brenda standarteve.

Lloji dhe kategoria e licensës, mbështetet në ligjin nr.10 081, date 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimit nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas verifikimeve të kryera në të dhënat zyrtare të publikuara të Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstaton se operatori ekonomik "AIR" shpk posedon licensën e kërkuar sipas dokumenteve të tenderit, konkretisht Licensën me Kod II.8.A, LN-7371-05-2019, me kategori "Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjenosanitare" dhe nënkategori "Shërbime ekspertize higjeno-sanitare", afati i vlefshmërisë "pa afat".

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.6. Lidhur me të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "CLEAN FAST" shpk për skualifikimin e operatorit ekonomik "AIR" shpk, KSHA konstaton;

Në Nenin 111 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) përcaktohet se: “2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështetin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.”.

Në lidhje me përcaktimin ligjor mbi ankesën, ligjvënosi ka parashikuar ndër të tjera se çdo OE ankimues duhet të paraqesë dokumentacionin dhe provat përkatëse mbi të cilat mbështeten pretendimet e ngritura nëpërmjet Formularit të Ankesës. Pra, barra e provës për të provuar paligjshmërinë e një vendimarrjeje është e ankimuesit, i cili në çdo rast duhet të paraqesë dokumentacionin provues.

KSHA arsyeton se të gjitha pretendimet e ngritura nga BOE ankimues mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e OE-ve nuk janë të mbështetura mbi fakte e prova, pra janë të ngritura "a priori".

KSHA konstaton se çdo pretendim i parashtruar nëpërmjet Formularit të Ankesës nga Ankimuesi është i ndërtuar mbi njohuritë e tij të përgjithshme, si dhe mbi supozimet e vetë ankimuesit dhe në asnjë rast nuk evidentohet asnjë dokumentacion zyrtar apo provë ligjore e bashkëlidhur që të argumentojë dhe të provojë ekzistencën e shkeljeve të pretenduara.

Në kuptim të legjislacionit për prokurimin publik në fuqi, ankimuesi ka detyrimin ligjor për të provuar dhe dokumentuar çdo shkelje të pretenduar. Pra në rastin konkret BOE ankimues duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, fakte, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës provues, në bazë të të cilave do të mund të shqyrtohej kjo ankesë.

Në çdo rast, ankimuesi ka detyrimin që të bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë të kualifikuar.

KSHA gjykon se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktor për kualifikimin e ofertës së Operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë ankimues nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori, duke iu referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, e duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështeten pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në Nenin 82, pika 1 të tij se: "Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj."

Një ankim pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo një pjesë të elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar, bazuar në LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, konsiderohet abuziv dhe çënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KSHA.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

- 1. Të refuzojë ankesën e paraqitur nga Operatori ekonomik "CLEAN FAST" shpk.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*

4. *Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkates.*
5. *Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”*

II.19. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues “*REJ*” SHPK ka paraqitur informacion shtesë për skualifikimin e operatorit ekonomik “*Clean Fast*” SHPK, i cili është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3276/6 prot., datë 03.12.2025.

II.20. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues “*REJ*” SHPK ka paraqitur informacion shtesë për skualifikimin e operatorit ekonomik “*Clean Fast*” SHPK, të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3276/7 prot., datë 05.12.2025.

II.21. Në datën 17.11.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6086, datë 17.11.2025 dhe numër protokoll nr. 3297/2025, datë 17.11.2025 e operatorit ekonomik “*Clean Fast*” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Clean Fast*” SHPK, si dhe kundërshtohet kualifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “*AIR*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.22. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3297/1 prot, datë 18.11.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Clean Fast*” SHPK, si dhe lidhur me kërkesën për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*AIR*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.23. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “*AIR*” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3297/2 prot., datë 20.11.2025.

II.24. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues “*REJ*” SHPK ka paraqitur informacion shtesë për skualifikimin e operatorit ekonomik “*Clean Fast*” SHPK, të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3297/3 prot., datë 03.12.2025.

II.25. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK ka paraqitur informacion shtesë për skualifikimin e operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK, të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3297/4 prot., datë 05.12.2025.

II.26. Me shkresën nr. 3297/5 prot., datë 09.01.2025 me lëndë “Kërkesë për verifikim pagese” KPP ju drejtua sektorit të financës në KPP me kërkesën për verifikimin e pagesës për ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/6086, datë 17.11.2025 dhe nr. 3297/2025 prot., datë 17.11.2025 të operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK.

II.27. Me shkresën nr. 3297/6 prot., datë 15.01.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” Sektori i Financës në KPP ka kthyer përgjigje mbi kërkesën e mësipërme duke u shprehur se: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3297/5 prot., datë 09.01.2026, me lëndë: "Kërkesë për verifikim pagese", ju bëjmë me dije se për ankesën me nr.3297/2025 prot., datë 17.11.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/6086, të Operatorit ekonomik "Clean Fast" Shpk, Sektori i Financës ka deklaruar që mandati nuk është në rregull, duke evidentuar me shënim në sistemin e ankesave elektronike se operatori ekonomik ka përdorur të njëjtin mandat arkëtimi që ka përdorur në ankesën me nr.aplikimi online A/2025/6077.*

Në vijim të shkresës tuaj i është kërkuar Degës së Thesarit raporti për arketimet, ku sipas verifikimeve të kryera me raportin e dërguar më datë 14.01.2026 për arketimet e kryera për muajin Nëntor-Dhjetor 2025, rezulton se Operatori Ekonomik "Clean Fast" Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”

II.28. Në datën 17.11.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6090, datë 17.11.2025 dhe numër protokoli nr. 3308/2025, datë 18.11.2025 e operatorit ekonomik “Pasrime Silvio” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, si dhe kundërshtohet kualifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “AIR” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.29. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3308/1 prot, datë 19.11.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, si dhe lidhur me kërkesën për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AIR” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.30. Në datë 25.11.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 2982/10 prot, datë 21.11.2025,

protokolluar me tonën me nr. 3308/2 prot, datë 25.11.2025, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 134/2025”, datë 21.11.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit duke argumentuar: “II.1. Në datën 18.11.2025, Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet portalit e-Albania, pranë Komisionit të Prokurimit Publik me numër protokoll 3308/2025, datë 18.11.2025 dhe Nr aplikimi të ankesës online: A/2025/6090, nga ku rezulton se nuk është paraqitur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur).

Në nenin 111 “Paraqitja e ankesës” të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, me anë të rubrikës “Kërkesë për informacion OE’ nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datë 18.11.2025 dërgoi kërkesën për plotësimin e mangësisë së konstatuar lidhur me dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Plotësimi i kësaj mangësie nuk u korrigjua brenda dy ditëve nga njoftimi.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimes nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së

ankimimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të përmbajë një ankimim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se përderisa operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” shpk nuk ka arritur që brenda afatit 2 ditor, të plotësojë mangësitë e konstatuara lidhur me elementët përmbajtësorë të ankesës, kjo e fundit konsiderohet si e pa paraqitur.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar ne nenin 114 ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankeses,

VENDOSI

- 1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” shpk.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”*

II.31. Me shkresën nr. 2982/10 prot, datë 21.11.2025 “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: ‘Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës’.” protokolluar me tonën me nr. 3308/3 prot, datë 25.11.2025, nëpërmjet shërbimit postar është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 134/2025”, datë 21.11.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.32. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK ka paraqitur informacion shtëse lidhur me pretendimet e tij për kualifikimin e operatorit ekonomik “AIR” SHPK, të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3308/4 prot., datë 05.12.2025.

II.33. Me shkresën nr. 3308/5 prot., datë 09.01.2025 me lëndë “Kërkesë për verifikim

pagesë” KPP ju drejtua sektorit të financës në KPP me kërkesën për verifikimin e pagesës për ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/6090, datë 17.11.2025 dhe nr. 3308/2025 prot., datë 18.11.2025 të operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK.

II.34. Me shkresën nr. 3308/6 prot., datë 15.01.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” Sektori i Financës në KPP ka kthyer përgjigje mbi kërkesën e mësipërme duke u shprehur se: “Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3308/5 prot., date 09.01.2026, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bejmë me dije se për ankesën me nr.3308/2025 prot., datë 18.11.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/6090, Operatori ekonomik “PASTRIME SILVIO” Shpk nuk ka paraqitur dokumentin bankar që të vërtetojë pagesën.

Në vijim të shkresës tuaj i është kërkuar Degës së Thesarit raporti për arkëtimet, ku sipas verifikimeve të kryera me raportin e dërguar më datë 14.01.2026 për arkëtimet e kryera për muajin Nëntor-Dhjetor 2025, rezulton se Operatori Ekonomik “PASTRIME SILVIO” Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen, si në vijim: “1. Operatori ekonomik “Rej” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:

- Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;

- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;

- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklaratimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.

KVO konstaton që operatorit ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme.

Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane të vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Përmbledhës i

Vetëdeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj, duke dhënë deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të cilës/cilit autoriteti mund të bëjë verifikimin e vetdeklarimeve dhe mosplotësimi i tij në të gjithë seksionet përkatëse përbën kusht skualifikimi”.

Të njëjtin qëndrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, datë 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, datë 17.09.2025.

Përsa më sipër, operatori ekonomik skualifikohet.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në pikën 1 “KRITERET E PËRGGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 11 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktur kriteret e përgjithshme të kualifikimit, si më poshtë:

Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të

përrjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet : Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

III.1.2. Në pikën 2.1/a “KRITERET E VEÇANANTA TË KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 11 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin e veçantë të kualifikimit, si më poshtë:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12.”.

III.1.3. Në pikën A “DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRZGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” të Seksionit “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit” dhe në pikën D “DEKLARATA ‘Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës’” të Seksionit “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit” të Shtojcës 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRZGJITHSHME TË

KUALIFIKIMIT

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

-

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i

punës në fuqi.

- *Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.*
- *Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.*

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

...

Ju lutemi sigurohuni që:

- ***Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.***
- ***Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.***
- ***Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.***
- ***Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.***

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- ***Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.***
- ***Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.***

- *Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.*
- *Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.*

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.4. Për përmbushjen e kriterëve kualifikuesë të sipërpërmendura operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK në dokumentacionin e ofertës së dorëzuar ka paraqitur dokumentin si më poshtë:

Shtojcës 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të vulosur dhe firmosur nga administratori i shoqërisë “REJ” SHPK, ku në pikën A “DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” dhe në pikën D “DEKLARATA ‘Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës’” të Seksionit “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit” ka deklaruar, si më poshtë:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Ekstrakt i thjeshtë dhe Historik Leshuar nga QKB***

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vërtetimi Gjëndjes Gjyqesore për Subjektin REJ shpk Lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve***

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

EMËR	MBIEMËR	DATËLINDJE	NR. ID/NIPT
L	K	X	X
M	K	X	X
G	S	X	X
K	S	X	X
K	shpk	X	X

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vërtetimi Gjëndjes Gjyqësore për z. L. K., z.M.K, G. S, K. S Lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve***

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vërtetimi Gjëndjes Gjyqësore për Subjektin REJ shpk Lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve***

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vërtetim Statusi Aktiv lëshuar nga e-albania***

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vërtetim për pagim detyrimesh, Vërtetim për pagimin e kontributeve nga subjekti leshuar nga e-albania.***

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vërtetim Debie leshuar nga FSHU / OSHEE***

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetim nga APP qe eshte nuk eshte i perjashtuar si***

dhe ky informacion mund te sigurohet nga Buletini i Prokurimeve Publik dhe Vertetim Mosperjashtimi nga e-albania.

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Vertetim mbi pronaretr përfitues nga e-albania Ekstrakt Historik i leshuar nga QKB

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Operatori ekonomik dekalron se zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Shoqëria “REJ” Shpk nuk është në Listën e Operatoreve Ekonomik të përjashtuar për të fituar Kontrata Publike në përputhje me Nenin 78 të LPP-së, Vërtetim APP

-

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Shoqëria “REJ” shpk ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin mjedisor, social dhe atë të punës.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik REJ shpk garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.*
- Operatori ekonomik REJ shpk lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë*

të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- *Operatori ekonomik REJ shpk nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.*

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

”1. Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë eficiencyn dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.6. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.8. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”.

III.1.9. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”.

III.1.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë

që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumente në origjinal ose të njësuara me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.1.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.12. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ofertues “REJ” SHPK

ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, shtojcën 12 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*”, në përmbushje të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 1/a “*KRITERET E VEÇANANTA TË KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 11 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT*”. Në këtë formular vetëdeklarimi, sikurse paraqitet edhe në pikën III.1.4 të këtij vendimi, vërehet se operatori ekonomik “*REJ*” SHPK, në pikën A “*DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES TË KUALIFIKIMIT*” përsa i përket kriterit të përgjithshëm të kualifikimit të përcaktuar në pikën 1/k “*KRITERET E PPËRZGJËEDHJES TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 11 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka deklaruar, si në vijim: “Operatori ekonomik deklaron se zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.”, ndërkohë që vërehet se në pikën D “*DEKLARATA ‘Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës’*” përsa i përket kriterit të përgjithshëm të kualifikimit të përcaktuar në pikën 1/g “*KRITERET E PPËRZGJËEDHJES TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 11 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka deklaruar, si në vijim: “• Operatori ekonomik REJ shpk garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

• Operatori ekonomik REJ shpk lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

• Operatori ekonomik REJ shpk nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.” .

Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në pikën 1/g dhe 1/k “*KRITERET E PPËRZGJËEDHJES TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 11 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka bërë deklaratimet e kërkuara sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 12 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të dokumentave të tenderit dhe përcaktimet e nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” pika 2, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik ankimues “*REJ*” SHPK, si në vijim: “*1. Operatori ekonomik “Rej” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:*

• Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;

- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;
- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklarimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedurë. Komisioni gjykon se ajo nuk qëndron, pasi referuar përcaktimeve të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 6, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ofertues për deklaratimet e pikës “f” dhe “l” të përcaktuara po në nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 6, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përveçse ka plotësuar rubrikat përkatëse të pikës A “DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” por edhe ka dhënë indicien në pikën D “DEKLARATA ‘Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës’” duke deklaruar se i zbaton dispozitat ligjore në marrëdhëniet e punës. Në çdo rast ashtu sikurse pika 7 e nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar e përcakton, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 12, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke bërë deklaratimet e nevojshme siç ky formular parashikon. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen, si në vijim: “2. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. nuk ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7, e cila përcakton se:

“Operatori ekonomik ofertues, për solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues të renditura në pikën 3, 4, 5, dhe 6 të Seksionit 2 Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit, Shtojca 8, duhet të paraqesë: dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.”

Në përmbushje të kësaj kërkesë, operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim datë 09.10.2025, të lëshuar nga shoqëria “GET klin” sh.p.k., me NIPT: L82420502U, i cili paraqitet në dokument si prodhues i detergjenteve, së bashku me dokumente MSDS për produktet përkatëse.

Nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në rubrikën “Leje/Licenca të lëshuara nga QKB”, rezulton se subjekti “GET klin” sh.p.k., NIPT: L82420502U, nuk është i pajisur me Leje/Licencë per Prodhim te Detergjenteve dhe nuk është i pajisur me asnjë lloj Licence tjetër si prodhues apo leje mjedisore si prodhues i Detergjentëve sipas nenit 4 të Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe Shtojcën 1 të këtij ligji (ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020), ku përcaktohet qartë se: “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”

Kjo do të thotë se, çdo subjekt që ushtron aktivitet prodhimi ose përpunimi të detergjentëve, duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”, të lëshuar nga autoritetet kompetente.

Në mungesë të një Leje që vërteton se kjo shoqëri është prodhues i produkteve detergjentë, rezulton se MSDS-të nuk janë të lëshuara nga prodhuesi, siç kërkohet shprehimisht nga dokumentet e tenderit.

Për rrjedhojë, KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.7, pasi dokumentet e paraqitura nuk i referohen një prodhuesi të ligjshëm të detergjentëve, duke mos garantuar kështu përmbushjen e specifikimeve teknike dhe kërkesave të sigurisë të parashikuara në tender.

Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. skualifikohet nga procedura e prokurimit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 11 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin e veçantë të kualifikimit, si më poshtë:

“2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, për solucionet e renditur në pikën 3, 4, 5, 6 “Solucionet dhe produktet larës dhe dizifektues”, Seksioni 2- Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm”, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”) duhet të paraqesë:
- dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.”

III.2.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të datës 23.09.2025 të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) autoriteti kontraktor ka vendosur kriterin e mësipërm të kualifikimit, duke argumentuar, si më poshtë vijon:

“Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenit 13 dhe 15 të Ligjit nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, VKM nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”. Është vlerësuar e rëndësishme që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentin me të dhënat e sigurisë të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të produkteve të cituar në këtë kriter, me qëllim që të sigurohet një nivel i lartë mbrojtje ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit, duke shmangur çdo efekt të dëmshëm që mund të vijë nga përdorimi i tyre.

III.2.3. Në Shtojcën 12 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka përcaktuar specifikimet teknike të solucioneve dhe produkteve larës e dizinfektues që do të përdoren për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“SHËRBIM PASTRIMI PËR SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët “ose ekuivalent”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) *Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*
- b) *Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit*
- c) *Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

.....

Solucionet dhe produktet lares dhe dizifektues:

1. ***Solucionet dhe produktet lares per perdorim ditor qe perdoren per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve ne ambientet e dhomave te pacienteve, njesite e kujdesit intensive, sallat e operacionit, korridoreve, tualetet e personelt dhe pacienteve qe jane me risk te mesem dhe te larte infektimi jane:***
 - *Disifektant dhe pastrues ditor qe hollohet ne uje me perqendrim 3%-10% me baze peroksidi hidrogjeni I cili perdoret per sipërfaqet e e forta dhe te buta, porose dhe jo-prose, nuk le shenja, me nje spekter shume te madh per luftimin e viruseve dhe baktereve.*
 - *Disifektant dhe pastrues ditor qe hollohet ne uje me perqendrim 3%-10% me baze peroksidi hidrogjeni I cili perdoret per tavilonat e mjekeve, tavolinat e pacienteve, dollapet dhe cdo materiali tjetër qe ka rrezik për përhapjen e viruseve.*
2. ***Solucionet dhe produktet lares per perdorim ditor qe perdoren per asgjesimin, parandalimin dhe perhapjen e viruseve dhe baktereve ne njesite e kujdesit intensive, sallat e operacionit, qe jane me risk shume te larte infektimi jane:***
 - *Produkte gati per perdorim pastrues dhe disinfektues per luftimin e sporicideve me perqendrim 3%-10% te peroksidit te hidrogjenit.*
 - *Peceta disinfektimi per luftimin e sporicideve me nje perdorim per pastrim dhe disifektim me baze peroksidit hidrogjeni me perqendrim 3%-10%.*

Keto produkte jane te miratuara nga MSHMS per perdorim ne ambiente spitalore, ne listen e lendeve vepruese te miratuara shtojca V. Duke qene se jane produkte per perdorim spitalor dhe kane nje rendesi te vecante ne kete procedure ato duhet te shoqerohen me certifikaten e te dhenave te sigurise, me etiketen perkatese si dhe me certifikimet perkatese ku vertetohet qe keto produkte ose ato ekuivalente te luftojne ne nje spekter shume te gjere te viruseve, baktereve dhe sporicideve ne menyre efektive dhe per nje kohe shume te shpejte. Per produktet spitalore qe kerkohen, OE duhet te demonstroje lidhje midis tij dhe prodhuesit ose distributorit te autorizuar.

3. *Solucion zbardhues qe perdoret per pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve. Te heqe pikat e bardha te ujit. Te perdoret edhe per larjen e pllakeve te poshtme te tualeteve me hollim 1-150 ne 1-200 me uje. Masat nga 1-10 litra. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(1-2)*
4. *Solicion per larje pllakash dyshemeje. Te jete sa me I koncentruar (1-200 me uje). Te lere arome te lehte pas larjes. Te jete prodhim me standarte te EU dhe I certifikuar sipas ketyre standarteve. Te kete kartat e sigurise dhe perberjes. Masa nga 1 deri ne 10 litra. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(8+/-5%)*
5. *Solicion per larje xhamash (me spray). Te jete prodhim me standarte te EU dhe I certifikuar. Te kete kartat e sigurise dhe perberjes. Te kete arome te lehte. Masa te jete 500-800 ml me spray. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(8.5-9)*
6. *Solucion per larje mobiljesh (me spray) 500 ml. Te jete prodhim me standarte te EU dhe I certifikuar. Te kete kartat e sigurise dhe perberjes. Te kete arome te lehte. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(8 -9)*

Produktet duhet te jene te pajisura nga prodhuesi me certificate sigurie dhe do te paraqiten nga OE i kontraktuar përpara nënshkrimit të kontratës nga palët.

III.2.4. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentin si më poshtë:

- *Dokumentin e emërtuar “Autorizim prodhuesi per detergjentet trauma sherbim pastrimi”, ku gjenden dokumentat si më poshtë vijon:*
 - *Dokumenti “Autorizim prodhuesi” nr. 22 prot, datë 09.10.2025, lëshuar nga shoqëria “GET Klin” SHPK për shoqërinë “REJ” SHPK, ku citohet si në vijim: “Subjekti Get Klin shpk me Administrator ZT. Dhimiter Roko me NIPT: L82420502U me objekt” “Prodhim Detergjente sipas QKR” autorizon subjektin REJ shpk me Nipt nr. J937116090 për të ofertuar këto produkte në procedurën e organizuar nga: Operatori i Blerje të Përqëndruara me objekt: “Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës.*
 - 1.Solacion larje për mobilje
 - 2.Solucion zbardhues/dezinfektues
 - 3.Solucion për larje xhamash.
 - 4.Solucion për larje pllakash.”.
 - *Dokumenti “Buletini i të dhënave sigurisë (MSDS Sheet) për produktin “Rea triplex 1-2.5 litra (Zbardhues dizinfektues)” lëshuar nga shoqëria “GET Klin” SHPK.*
 - *Dokumenti “Buletini i të dhënave sigurisë (MSDS Sheet) për produktin “Rea Cristal (pastrim xhamash)” lëshuar nga shoqëria “GET Klin” SHPK.*
 - *Dokumenti “Buletini i të dhënave sigurisë (MSDS Sheet) për produktin “Solo Pavimenti 1L (pastrim dyshemeje)” lëshuar nga shoqëria “GET Klin” SHPK.*
 - *Dokumenti “Buletini i të dhënave sigurisë (MSDS Sheet) për produktin “ANA mobilje 0.5-0.75 l (pastrim mobiljesh)” lëshuar nga shoqëria “GET Klin” SHPK.*

III.2.5. Nga verifikimet në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit lidhur me regjistrin tregtar dhe regjistrin e licensave të shoqërisë "GET Klin" SHPK, Komisioni konstatoi si më poshtë:

-EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR", ku rezulton se shoqëria "GET Klin" SHPK është krijuar në datën 19.12.2018 dhe ka objekt veprimtarie, si në vijim: "Prodhimin e pluhurave larës dhe lëngjeve larës dhe çdo lloj detergjenti, tregtim me shumicë e pakicë, import - eksport të pluhurave larës të lëngjeve larës, të lëndës së parë bazë të çdo detergjenti, aromatikëve që përdoren në industrinë e detergjentëve, prodhimin dhe ambalazhimin e artikujve dhe produkteve të pastrimit, artikujve industrial, kimik, kozmetik, etj. Import - eksport dhe tregtim i të gjitha llojeve të detergjentëve, lëndëve të pastrimit, kimike e jo kimike, të gjitha tipave dhe formave, produkteve për pastrim. Import eksport, tregtim, makinerive, mekanizmave të pastrimit. Përpunimi i lëndëve gjysëm të gatshme, të gatshme për prodhimin e lëndëve të pastrimit, produkteve të pastrimit, shërbimeve të pastrimit për hoteleri-turizëm. Shërbim higjienizimi, deratizimi dhe dezinfektimi për ambiente dhe lokale të ndryshme. Transport kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash të ndryshme për vete dhe për të tretë. Shoqëria sipas 2 nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt.14.04.08). Dhenie me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira."

-AKT MIRATIMI "Leje Mjedisit Tipi B" nr. 1342 prot, datë 21.11.2025, lëshuar nga Ministri i Mjedisit për shoqërinë "GET klin" SHPK, me përshkrim të veprimtarisë prodhuese "4.9 Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/detergjent".

-Leja me numër nr; PN-2487-11-2025, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit më datë 25.11.2025, për shoqërinë "GET Klin" SHPK, me përshkrim të veprimtarisë prodhuese "4.9 Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/detergjent".

III.2.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "REJ" SHPK përse i përket arsyes së mësipërme të skualifikimit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor me vendimin "Vendim KSHA 135/2025", datë 21.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3257/5 prot, datë 27.11.2025 ka argumentuar si në vijim: "Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues konstatohet se dokumenti me të dhënat e sigurisë për solucionet përkatëse (MSDS) është lëshuar nga subjekti "GET klin". Referuar kriterit të sipërcituar është kërkuar qartë që ky dokument duhet të jetë lëshuar nga një subjekt në cilësinë e prodhuesit. Nga verifikimet kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është konkluduar se subjekti "GET klin" nuk rezulton të jetë prodhues përderisa nuk zotëron asnjë leje/licensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit çka e bën të pamundur ushtrimin e aktivitetit si prodhues në rastin konkret i detergjentëve dhe solucionëve përkatëse të kësaj fushe.

Ky fakt është thelbësor, pasi licencimi përkatës është një kërkesë ligjore e domosdoshme, jo

vetëm lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimimi, por për vetë ushtrimin e aktivitetit ekonomik dhe teknik në Republikën e Shqipërisë. Mungesa e licencës së prodhimit vërteton qartë se subjekti "GET Klin" nuk ka kapacitetin përkatës për të realizuar objektin e kontratës. Si rrjedhojë, deklarimi i tij si prodhues dhe paraqitja e dokumentit me të dhënat e sigurisë (MSDS), bie ndesh me të dhënat zyrtare publike dhe përbën një mospërputhje thelbësore me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit publik, legjitimiteti i aktivitetit të operatorit ekonomik është një element themelor për garantimin e konkurrencës së ndershme, cilësisë së produktit dhe sigurisë së produkteve që do të përdoren në shërbim. Mosplotësimi i këtij kushti e vë subjektin në pozitë të pabarabartë ndaj operatorëve të tjerë që kanë investuar dhe operojnë në përputhje me kuadrin ligjor.

Gjithashtu, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se dokumenti MSDS, sipas standardeve ndërkombëtare dhe kërkesave ligjore në fuqi, duhet të lëshohet vetëm nga prodhuesi real i produktit, i cili zotëron formulën përkatëse kimike, asetet teknike dhe përgjegjësinë ligjore për sigurinë e tij. Marrja e MSDS-së nga një subjekt që nuk është prodhues, dhe që për më tepër nuk disponon as licencë apo leje për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit, krijon një risk lidhur me origjinën, cilësinë dhe legjitimitetin e vetë produktit të ofruar. Për rrjedhojë, operatori ekonomik ankimues nuk mund të provojë gjurmueshmërinë dhe autenticitetin e produkteve që pretendon se do të furnizojë.

Dokumenti me të dhënat e sigurisë lidhur me produktet kimike si detergjentë apo solucione të ngjashme është një dokument zyrtar që certifikon përpunueshmërinë me kërkesat e sigurisë, si për përdoruesit, ashtu edhe për ambientin. Kur një MSDS nuk buron nga prodhuesi legjitim, ajo humb çdo vlerë ligjore dhe teknike, dhe nuk mund të konsiderohet si e vlefshme nga autoriteti kontraktor.

Në këtë kuptim, mospërmbushja e kërkesave ligjore për licencim nuk është një mangësi formale, por një element thelbësor që cënon integritetin dhe vlefshmërinë e ofertës. Për këto arsye, dokumenti i marrë nga subjekti "GET Klin" nuk mund të konsiderohet i vlefshëm dhe në këtë kontekst operatori ekonomik "Rej" shpik ka dështuar të paraqesë një dokument me të dhënat e sigurisë për solucionet dhe produktet larës dhe dizifektues nga një subjekt prodhues, duke mospërmbushur kriterin e përcaktuar sipas pikës 2.3.7, të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.”

III.2.7. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

”1. Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat

e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.2.8. Në neni 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.9. Në nenin 77, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.2.10. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.2.11. Në nenin 41 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit, do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar, se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për

operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim, në përputhje me fondin total të përlllogaritur”

III.2.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.13. Nisur nga arsyeja skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, dokumentacionin e cituar në pikën III.2.4 të këtij vendimi. Nga mënyra e hartimit të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik në kriteret e vecanta të kualifikimit vihet re që është kërkuar: “2.3.7. *Operatori ekonomik ofertues, për solucionet e renditur në pikën 3, 4, 5, 6 “Solucionet dhe produktet larës dhe dizifektues”, Seksioni 2- Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm”, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”)* duhet të paraqesë: dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.” Në këtë kuadër ndryshe nga sa

pretendon ankimesi se skualifikimi është kryer mbi bazën e një kriteri të pa kërkuar, KPP gjykon se për të vlerësuar dokumentin me të dhënat e sigurisë “MSDS” i cili sipas kriterit duhet të jetë i lëshuar nga prodhuesi, me domosdoshmëri do të vlerësojë nëse ky dokument për t’u konsideruar legjitim ka buruar nga një subjekt i cili në datën e hapjes së ofertave (më 20.10.2025) ka gëzuar këtë status (*të prodhuesit*) apo jo. Duke qenë se dokumenti i sigurisë “MSDS” i ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik për produktet e renditura në pikën 3, 4, 5, 6 “*Solucionet dhe produktet larës dhe dizifektues*”, Seksioni 2- *Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm*”, Shtojca 8 “*Specifikimet teknike*”) është lëshuar nga subjekti “Get Klin” SHPK në cilësinë e prodhuesit, KPP ju drejtua dokumenteve “AKT MIRATIMI “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 1342 prot, datë 21.11.2025 dhe Lejes me numër nr; PN-2487-11-2025 datë 25.11.2025 lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për këtë subjekt për të vlerësuar nëse në datën e hapjes së ofertave (më 20.10.2025) ky subjekt e mbante këtë cilësi. Nga verifikimi i “AKT MIRATIMI “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 1342 prot, datë 21.11.2025 miratuar nga Ministri i Mjedisit për subjektin “Get Klin” SHPK përcaktohet se pas shqyrtimit të kërkesës për leje mjedisi Agjencia Kombëtare e Mjedisit propozon dhënien e lejes me kushtet bashkëngjitur ndër të cilat konkretisht citoj : “2.2 *Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapaciteti prodhues: ID 4.9 Prodhim dhe përpunim/përzierja e produkteve të pastrimit/detergjenteve.*”, dhe “*Vlefshmëria e kësaj leje fillon menjëherë nga data e miratimit saj.* Po këtu, Komisioni vëren se mes opsioneve “Kërkesë për leje mjedisi” dhe “Ndryshim të kushteve të lejes” është vendosur shenja “✓” te opsioni i parë. Ndërsa Leja me numër nr; PN-2487-11-2025 datë 25.11.2025 lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektin “Get Klin” SHPK në seksionin “*Emërtimi përshkrues i veprimtarisë*” përcakton: “*Industria Kimike ID 4.9 Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/detergjenteve.*” Nga shqyrtimi i këtyre dy dokumentave, ato i japin KPP-së një panoramë të qartë për të konkluduar se subjekti “Get Klin” SHPK i cili ka lëshuar certifikatat e sigurisë MSDS në cilësinë e prodhuesit në datën e hapjes së ofertave me 20.10.2025 nuk e gëzonte këtë cilësi pasi sic vihet re akti “AKT MIRATIMI “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 1342 prot, për subjektin “Get Klin” SHPK me përshkrim të veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues “*ID 4.9 Prodhim dhe përpunim/përzierja e produkteve të pastrimit/detergjenteve.*” është miratuar nga Ministri i Mjedisit me datë 21.11.2025, pra pas hapjes së ofertave dhe ku siç vetë kjo leje përcakton *vlefshmëria* e saj fillon menjëherë nga data e miratimit. Gjithashtu edhe Leja me numër nr; PN-2487-11-2025, është lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit më datë 25.11.2025, për shoqërinë “GET Klin” SHPK, me përshkrim të veprimtarisë prodhuese “*4.9 Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/detergjent*” pra pas datës së hapjes së ofertave, çfarë do të thotë që në këtë datë ky subjekt nuk e gëzonte statusin e prodhuesit të detergjenteve dhe solucioneve që lidhen me objektin e prokurimit. Statusi i prodhuesit në momentin e hapjes së procedurës për subjektet lëshues të MSDS ka qenë kusht për të gjykuar mbi legjitimitetin e certifikatave të sigurisë. Mungesa e licencës së prodhimit në datën e hapjes së ofertave vërteton se subjekti “Get Klin” SHPK në këtë datë nuk ka patur kapacitetin për të realizuar objektin e kontratës dhe deklarimi i tij si prodhues në këtë datë si dhe paraqitja e dokumentit me të dhënat e sigurisë MSDS nuk përkon me të dhënat e dokumentave zyrtare të cilat këtë status e afirmojnë në një datë të mëvonshme duke passjellë edhe mospërmbushjen e kriterit kualifikues. Gjithashtu KPP nuk mund të gjykojë mbi vlefshmërinë asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një

gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë. Vlerësimi i dokumentacionit, i cili do të sigurohej në të ardhmen nga operatorët ekonomikë, do të cenonte në thelb konceptin e prokurimit publik, i cili i nënshtrohet afateve të përcaktuara procedurale ligjore. KPP nuk mund të vlerësojë një fakt apo dokument të ri pas datës së hapjes së ofertave, në respektim të parimit të barazisë, mosdiskriminimit, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Siç u arsyetua, referuar dokumentacionit më sipër duke qenë se në momentin e hapjes së ofertave me datë 20.10.2025, mungesa e licensës së prodhimit për subjektin “Get Klin” SHPK vërteton se ai nuk ka patur kapacitetin për të përmbushur objektin e kontratës rrjedhimisht kjo sjellë mopërmushjen nga operatori ekonomik “Rej” SHPK të kriterit 2.3.7 të kapacitetit teknik në kriteret e veçanta të kualifikimit.*

Sa më lart pretendimi i ankimuesit “ Rej” SHPK nuk qëndron.

III.3. Gjithashtu, referuar çështjeve të mësipërme, KPP gjykon, se ky rast duhet t’i referohet Agjencisë së Prokurimit Publik për nisjen e hetimit administrativ për operatorin ekonomik “Rej” SHPK bazuar në nenin 23 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, pasi deklarimi nga ana e tij i subjektit “Get Klin” SHPK si prodhues në momentin e hapjes së ofertave (më 20.10.2025) dhe paraqitja e dokumentit me të dhënat e sigurisë (MSDS) nga ky subjekt nuk përkon me të dhënat e dokumentave zyrtare të cilat këtë status (të prodhuesit) e afirmojnë në një datë të mëvonshme nga data e hapjes së ofertave.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Rej” SHPK për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit ato nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi në procesin e shqyrtimit administrativ pasi gjendja juridike dhe faktike e operatorit ekonomik “Rej” SHPK do të vazhdojë të mbetet e skualifikuar edhe pas arsyetimit më sipër të KPP-së.

III.5. Ndërsa lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Rej” SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Air” SHPK dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “Clean Fast” SHPK dhe “Pastrime Silvio” SHPK nga

procedura e prokurimit objekt ankim, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.5.1. Parashikimi i nenit 94 pika 1 e VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elemente janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin.

III.5.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.5.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi, është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pas shqyrtimit nga KPP të pretendimeve mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Rej” SHPK, gjendja faktike juridike e tij, mbetet e skualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për skualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

III.6. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të ankimuesit “Clean Fast” SHPK, KPP gjen me vend të sqarojë dy momente;

Së pari, nga shqyrtimi i materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se ky operator ekonomik ka paraqitur dy ankesa për të njejtën procedurë prokurimi konkretisht me nr. A/2025/6077 datë 14.11.2025 dhe me nr. 3276 prot., datë 14.11.2025 si dhe me nr. A/2025/6086, datë 17.11.2025 dhe me nr. 3297/2025, datë 17.11.2025 duke e konsideruar ankesën e dytë si identike me ankesën e mëparshme. Në këtë kuadër, KPP do ta konsiderojë ankesën e dytë si plotësim i ankesës së parë dhe tarifa e pagesës dhe respektimi i afateve të ankimit do të vlerësohen lidhur me ankesën e parë me nr. ankimi elektronik A/2025/6077 datë 14.11.2025 dhe me nr. 3276 prot., datë 14.11.2025.

Së dyti, ndryshe nga sa pretendon ankimuesi “Rej” SHPK se ankesa e operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK me nr. ankimi elektronik A/2025/6077 datë 14.11.2025 dhe me nr. 3276 prot., datë 14.11.2025 është paraqitur jashtë afati, në vlerësim të Vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit., **Pika III. Vlerësimi i Gjykatës, 31. Për kushtin tjetër formal të padisë, respektimin e afatit ligjor.....**,: “... *Praktika gjyqësore e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. (00-2017-927) 670, datë*

30.05.2017, konfirmon të njëjtin qëndrim: "... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Tiranës e ka zbatuar gabim ligjin për përlogaritjen e afatit të prerë të ankimit administrativ. Në këtë pjesë të çështjes, Kolegji konfirmon plotësisht bazueshmërinë në ligj të qëndrimit të Gjykatës Administrative të Apelit, se... edhe afatet e parashikuara nga neni 63 i Ligji për prokurimin publik duhet të interpretohet sikur rregullojnë të gjithë ligjet procedurale, sikur neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative apo neni 148, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile. **Sipas gjykatës së apelit, afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...**", si dhe duke u mbështetur në nenin 97 pika 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: "5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse." Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, është 10 ditë nga dita e nesërme nga marrja e njoftimit për këtë vendim dhe në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të aktit rregullator të sipërcituar nuk do të përfshihet dita e marrjes së njoftimit. Në këtë kuadër, duke qenë se referuar raportit të auditit njoftimi i pjesëmarrësve mbi vendimin e përzgjedhjes është kryer me datë 04.11.2025, paraqitja e ankesës nga operatori ekonomik "Clean Fast" SHPK me datë 14.11.2025 ka respektuar kushtet formale për paraqitjen e ankesës lidhur me afatin e ankimit.

III.7. Lidhur me pretendimet e ankimesit "Clean Fast" SHPK prë skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsye se: "2. Sigurimi i ofertës i paraqitur nga operatori ekonomik "Clean Fast" sh.p.k., edhe pse në vlerë të saktë, nuk përmbush kriterin 1, shkronja b), pasi afati 150-ditor nuk fillon nga data e mbylljes së tenderit (20.10.2025) por fillon nga data 16.10.2025 deri më 15.03.2026, kur sipas kërkesës duhej të përfshinte periudhën 20.10.2025 – 18.03.2026 (150 dite). Ndryshe nga rasti i trajtuar nga Komisioni i Prokurimeve Publike me Vendimin Nr.1459/2025, datë 16.10.2025, ku sigurimi i ofertës i operatorit Mine Lloshi P.F. ishte lëshuar përpara datës së hapjes së tenderit, por specifikonte se (sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në (njoftimin e kontratës ose ftesën për tender) 150 ditë), në rastin aktual periudha e sigurimit të ofertës nga "Clean Fast" nuk mbulon plotësisht afatin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, operatori "Clean Fast" sh.p.k. skualifikohet, duke u bazuar në kriterin specifik të dokumenteve të tenderit që kërkon mbulimin e të gjithë periudhës së 150 ditëve nga data e dorëzimit të ofertave." KPP vëren se,

III.7.1. Në shtojcën 11 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.1.b të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

III.7.2. Në shtojcën 5 “*Formulari i Sigurimit të Ofertës*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;*
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;*
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.*

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

III.7.2. Në Seksionin 3: “*Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike*”, pika 3.1 “*Sigurimi i ofertës*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mënyrën e paraqitjes, afatin dhe vlerën e sigurimit të ofertës, si më poshtë:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 *Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 5.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 4,900,711.27 (katër milion e nëntëqind mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë pikë njëzet e shtatë) lekë, ose 50,611.5 (pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë pikë pesë) Euro.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ (shuma, monedha)

Loti 2 _____ (shuma monedha)

3.1.2 *Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor:*

Credins Bank

SWIFT:CDISALTRXXX

NR.LLOGARIE: 00002032030

3.1.3 *Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:*

i. garancisë bankare X

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente X

3.2 *Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 DITË nga autoritetet kompetente X*

3.2 *Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 DITË (shprehur në ditë)*

III.7.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Clean Fast” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Formularin e Sigurimit të Ofertës me numër BND0023709 në emër të “Clean Fast” SHPK, të lëshuar më datë 16.10.2025, nga shoqëria e sigurimeve “Intersig Vienna Insurance Group” SHA për Operatorin e Blerjeve të Përqëndruara sh.a, me kohëzgjatje të sigurimit: Fillon më 16.10.2025- Mbaron me 15.03.2026, afati 150 ditë në të cilën vërteton se Operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK është garantuar pranë “Intersig Vienna Insurance Group” SHA me një shumë prej 4,900,711.27 lek si kusht për sigurimin e ofertës dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

III.7.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin

vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.7.5. Në neni 83, pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.”

III.7.6. Në nenin 30 pika 3 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit²⁴. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.”

III.7.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 2.1.b të Shtojcës 11 të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve të ligjore të sipërpërmendura ka përcaktuar që ofertuesit të dorëzojnë në momentin e ofertimit, sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 5 të këtyre dokumenteve, si dhe sipas përcaktimeve në pikat 3.1.3, 3.1.2 dhe 3.1.3 të Seksioni 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” autoriteti kontraktor ka përcaktuar format alternative të paraqitjes së sigurimit të ofertës, në formën e garancisë bankare ose nga një shoqëri e licencuar nga autoritetet kompetente sikurse parashikohet dhe në nenin 83 të LPP-së, gjithashtu ka parashikuar edhe

vlerën e sigurimit prej 4,900,711.27 (katër milion e nëntëqind mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë pikë njëzet e shtatë) lekë, ose 50,611.5 (pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë pikë pesë) Euro, si dhe afatin e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës për një periudhë prej 150 ditë.

III.7.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se referuar “Formularit të Sigurimit të Ofertës” me numër: BND0023709 të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Clean Fast” SHPK ai është lëshuar në njëërën prej formave të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur nga shoqëri të licencuara nga autoritetet kompetente dhe përkatësisht shoqëria e sigurimit “Intersig Vienna Insurance Group” SHA, është sipas Shtojcës 5 të dokumenteve të tenderit të publikuara nga ana e autoritetit kontraktor, si dhe ky formular është sipas vlerës së kërkuar nga autoriteti kontraktor në Seksioni 3: “*Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike*” të dokumenteve të tenderit. Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik ankimues, Komisioni vëren se arsyeja e skualifikimit në thelb është e lidhur me periudhën e afatit të vlefshmërisë së sigurimit të ofertës të ankimuesit, duke pretenduar se nuk ka siguruar ofertën e tij për afatin 150 ditor të përcaktuar në dokumentet e tenderit, pasi formulari i sigurimit të ofertës është lëshuar nga shoqëria e sigurimit më datë 16.10.2025, ndërkohë që procedura e prokurimit është zhvilluar më datë 20.10.2025 dhe sipas autoritetit kontraktor afati 150-ditor nuk fillon nga data e mbylljes së tenderit (20.10.2025) por fillon nga data 16.10.2025 deri më 15.03.2026, kur sipas kërkesës duhej të përfshinte periudhën 20.10.2025 – 18.03.2026 (150 dite). Mbi këtë pretendim të autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon, se formulari i sigurimit të ofertës i paraqitur nga ankimuesi, me të vërtetë është lëshuar nga shoqëria e sigurimeve më datë 16.10.2025, por ka një afat të qartë fillimi 16.10.2025 dhe përfundimi 15.03.2026, i cili nuk mbulon periudhën 150 ditore sic kërkohet në dokumentat e tenderit. Arsyeja e skualifikimit nga autoritetit kontraktor qëndron, pasi sipas arsyetimit të KPP me të vërtetë afati i vlefshmërisë së sigurimit të ofertës prej 150 ditësh fillon nga data e fundit për dorëzimin e ofertave dhe jo nga data e lëshimit të formularit të sigurimit të ofertës por në këtë rast kompania e sigurimit ka përcaktuar qartë afatin e fillimit 16.10.2025 dhe të mbarimit 15.03.2025 duke mos mbuluar

periudhën 150 ditore nga hapja e ofertave me 20.10.2025. Komisioni gjithashtu sqaron se ndryshe nga sa pretendon ankimuesi “Clean Fast” SHPK se:

“ Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatuar, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatuar të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën.”

Pra referuar pikës së mësipërme të DST-së edhe nëse periudha e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës së Shoqërisë “Clean Fast” shpk ishte katër ditë më pak e mbuluar me sigurim oferte (gjë që nuk është e vërtetë sepse nuk thuhej kjo në DST), përsëri Operatori i Blerjeve të Përqendruara nuk mund të procedonte me skualifikim, por duhet të njoftonte Shoqërinë “Clean Fast” shpk të paraqiste një sigurim të zgjatuar edhe me katër ditë të ofertës (siç përcaktohet në Seksionin 1, pjesa e përgjithshme, Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika 13, numri 3) dhe vetëm nëse Shoqëria “Clean Fast” shpk do të refuzonte, vetëm atëherë Autoriteti Kontraktor mund të procedonte me skualifikimin.” në këtë rast nuk jemi para këtij parashikimi ligjor sepse zgjatja e periudhës së vlefshmërisë së ofertave nga autoritet kontraktor mund të kërkohet në ato raste kur së pari ofertuesit kanë dëshmuar me dokumenta konkrete se përmbushin periudhën e sigurimit të ofertës të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe mbi këtë të vlerësojë zgjatjen e vlefshmërisë së saj. Konkretisht siç kemi arsyetuar me sipër operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK gjendet përballë faktit që me dokumenacionin konkret nuk provon mbulimin e të gjithë periudhës së kërkuar në dokumentat e tenderit për sigurimin e ofertës dhe rrjedhimisht nuk mund të gjykohet mbi kërkesa për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë pasi duhet të provohet kjo gjendje që të kërkohet zgjatja e periudhës së saj.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se ankimuesi me dokumentacionin e dorëzuar nuk e ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.b të Shtojcës 11 të dokumenteve të tenderit, pasi afati i vlefshmërisë së formularit të sigurimit të ofertës nuk është sipas përcaktimeve në Seksionin 5 të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Clean Fast” SHPK nuk qëndron.

III.8. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me

interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]

III.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Clean Fast” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen, si në vijim: “1. Operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:

- Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;
- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklaratimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.

KVO konstaton që operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme.

Qëndrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane të vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj, duke dhënë deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të cilës/cilit autoriteti mund të bëjë verifikimin e vetdeklarimeve dhe mosplotësimi i tij në të gjithë seksionet përkatëse përbën kusht skualifikimi”.

Të njëjtin qëndrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, datë 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, datë 17.09.2025.

Përsa më sipër, operatori ekonomik skualifikohet.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1.Në pikën 1 “KRITERET E PPËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 11 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktur kriteret e përgjithshme të kualifikimit, si më poshtë:

Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
 - b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
 - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
 - ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
 - d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
 - dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
 - e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
 - gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
 - h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
 - i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
 - j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
 - k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar
- Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet : Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

III.9.2. Në pikën 2.1/a “KRITERET E VEÇANANTA TË KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 11 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin e veçantë të kualifikimit, si më poshtë:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;

III.9.3. Në pikën A “DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” të Seksionit “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit” dhe në pikën D “DEKLARATA ‘Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës’” të Seksionit “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit” të Shtojcës 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent

kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

-

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.*
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.*
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur*

janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e
nevojshme _____

...

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*
- *Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.*
- *Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.*

- *Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.*

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.9.4. Për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të sipërpërmendura operatori ekonomik ankimes “Clean Fast” SHPK në dokumentacionin e ofertës së dorëzuar ka paraqitur dokumentin si më poshtë:

Shtojcës 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të vulosur dhe firmosur nga administratori i shoqërisë “Clean Fast” SHPK, ku në pikën A “DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” dhe në pikën D “DEKLARATA ‘Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës’” të Seksionit “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit” ka deklaruar, si më poshtë:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Ekstrakt i regjistrit tregtar i thjeshtë dhe historik

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Vertetim nga gjykata penale Administrator/e + Kompania dhe Vertetim nga prokuroria Administrator/e + Kompania

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

Emer: E. _____ **Mbiemer: L.** _____ **Atesi: H.** _____ **Amesi: XH** _____ **Datelindje:** _____

Vendlindje: ' _____ **Numer personal:** _____

ID ADMINISTRATOR / E E _____ **L** _____

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetim i gjendjes gjyqësore Administrator/e + Kompania**

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetim nga gjykata administrative Kompania + Administrator/e**

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetim statusi aktiv**

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.


Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetim likuidimi i taksave dhe tarifave vendore, Bashkia Tiranë; Listepagesa te punonjesve te kompanise janar-shtator 2025; Vertetim per pagimin e kontributeve te sigurimeve shoqerore e shendetesore shtator 2025; Vertetim per pagim detyrimesh**

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetim debie OSHEE**

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.



Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _ Vertetim realizim Kontrate Spitali Psikiatrik Ali Mihali + Fatura 2022+ Fatura 2023+ Fatura 2024 +Fatura 2025, Vertetim realizim kontrate OSHEE + Kontrate OSSH+ FSHU 2024- Kontrate OSSH+ FSHU 2025 + Fatura 2022 -2024, Fatura 2025 ,Vertetim Realizim Kontrate Safe Security albania + Fatura 2022- 2025 + Situacione 2024- 2025 , Vertetim realizim Kontrate BKT 2022, 2024, 2025 Situacione 2024- 2025 , Fatura 2022-2025, Vertetim realizim Kontrate Procredit Bank + Fatura 2023-2025, Vertetim realizim Kontrate Union Bank + Fatura 2022-2025, Vertetim realizim Kontrate Banka e Shqiperise, Vertetim realizim kontrate TEG, Fatura 2022-2025 + Situacion 2024-2025

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Ekstrakt i pronareve përfitues /ID Administratore Eriola Likaj;**

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Listepagesa te punonjesve janar - shtator 2025**

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetim mosperjashtimi nga APP**

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _ **Certifikata ISO 9001 (Sistemet e menaxhimit të cilësisë);**

ISO 14001 (Sistemet e menaxhimit mjedisor);

ISO 45001 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë);

Licencë me kod III.2.A Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

(Auditim mjedisor dhe ndikim në mjedis);

Licencë me kod III.2.B Ngarkim, grumbullim, transportim dhe depozitim i mbetjeve urbane;
II.8.A SHERBIME EKSPERTIZE HIGJENO SHENDETESORE;

Licencë me kod II.8.A për Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore

Licencë me kod II.8.B Deratizim, dezinfektim, dezinfektim.;

Licencë me kod II.8.C Veprimtari në fushën e Shëndetit Publik që nuk liçencohen sipas një kategorie tjetër.;

Licencë II.4 PRODHIM DHE TREGTIM I FARAVE DHE FIDANEVE;

Licencë I.2.A STUDIMI DHE PERGATITJA E PROJEKTEVE MBI MASAT E MBROJTJES NGA ZJARRI TE NDERTESAVE TE CDO LLOJI.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- *Operatori ekonomik CLEAN FAST SHPK garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.*
- *Operatori ekonomik CLEAN FAST SHPK lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.*
- *Operatori ekonomik CLEAN FAST SHPK nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.*

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

III.9.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

”1. Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.9.6. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.9.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.9.8 Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.9.9. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”.

III.9.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet

publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose

dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumente në origjinal ose të njësuara me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.9.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e

përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.9.12. Nisur nga arsyeja skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ofertues "Clean Fast" SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, shtojcën 12 "FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT", në përmbushje të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 1/a "KRITERET E VEÇANANTA TË KUALIFIKIMIT" të Shtojcës 11 "FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT". Në këtë formular vetëdeklarimi, sikurse paraqitet edhe në pikën III.9.4 të këtij vendimi, vërehet se operatori ekonomik "Clean Fast" SHPK, në pikën A "DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT" përsa i përket kriterit të përgjithshëm të kualifikimit të përcaktuar në pikën 1/k "KRITERET E PPËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT" të Shtojcës 11 "FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka deklaruar, si në vijim: "Listepagesa të punonjësve janar-shator 2025", ndërkohë që vërehet se në pikën D "DEKLARATA 'Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës" përsa i përket kriterit të përgjithshëm të kualifikimit të përcaktuar në pikën 1/g "KRITERET E PPËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT" të Shtojcës 11 "FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka deklaruar, si në vijim:

- Operatori ekonomik CLEAN FAST SHPK shpk garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimin dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik CLEAN FAST SHPK lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik CLEAN FAST SHPK nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH."

Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimes për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në pikën 1/g dhe 1/k "KRITERET E PPËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT" të Shtojcës 11 "FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJËEDHJES/KUALIFIKIMIT" të dokumentave të tenderit të

procedurës së prokurimit objekt ankimi ka bërë deklaratimet e kërkuara sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 12 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të dokumentave të tenderit dhe përcaktimet e nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” pika 2, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Clean Fast” SHPK, si në vijim: “1. Operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:

- Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;
- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklaratimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedurë.” Komisioni gjykon se ajo nuk qëndron, pasi referuar përcaktimeve të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” pika 6, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, operatori ekonomik ofertues për deklaratimet e pikës “f” dhe “ll” të përcaktuara po në nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” pika 6, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar përveçse ka plotësuar rubrikat përkatëse të pikës A “*DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT*” por edhe ka dhënë indicien në pikën D “*DEKLARATA ‘Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës’*” duke deklaruar se i zbaton dispozitat ligjore në marrëdhëniet e punës. Në çdo rast ashtu sikurse pika 7 e nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar e përcakton, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 12, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke bërë deklaratimet e nevojshme siç ky formular parashikon. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e

dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “*Clean Fast*” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Clean Fast*” SHPK qëndron.

III.10. Ndërsa lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “*Clean Fast*” SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Air*” SHPK nga procedura e prokurimit objekt ankim, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.10.1. Parashikimi i nenit 94 pika 1 e VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elemente janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin.

III.10.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.10.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi, është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pas shqyrtimit nga KPP të pretendimeve mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Clean Fast*” SHPK, gjendja faktike juridike e tij, mbetet e skualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për skualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

III.11. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK në

datën 17.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, me numër ankimi elektronik A/2025/6090 si dhe nr. Protokollit 3308/2025 datë 18.11.2025, për procedurën e prokurimit *E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-62426-09-23-2025, me objekt: “Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 245,035,563.59 (*dyqind e dyzet e pesë milion e tridjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë*) lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë), zhvilluar në datën 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara ShA, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, si dhe kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik “AIR” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar ku parashikohet se:

- “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.
2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.
3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.
4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.11.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

- a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.11.2. Me datë 21.11.2025 autoriteti kontraktor përmes shkresës me nr. 2982/10 prot., datë 21.11.2025 ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike Vendimin e KSHA (KSHA.134/2025 me nr. 2982/9 prot., datë 21.11.2025), për Shqyrtimin e Ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK, protokolluar me tonën me nr. 3308/2

prot., datë 25.11.2025, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur **mos pranimin** e ankesës duke argumentuar:

“.....Referuar bazës ligjore të sipërcituar, KSHA, me anë të rubrikës “kërkesë për informacion OE” nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datë 18.11.2025 dërgoi kërkesën për plotësimin e mangësisë së konstatuar lidhur me dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Plotësimi i kësaj mangësie nuk u korrigjua brenda dy ditëve nga njoftimi”.

III.11.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, sikurse është formulari përkatës dhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë *apriori*, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk çënon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të depozituar në KPP, me datë 21.11.2025, nga ana e autoritetit kontraktor, përmes shkresës me nr. 2982/10 prot., datë 21.11.2025 të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike, Vendimin e KSHA (KSHA.134/2025 me nr. 2982/9 prot., datë 21.11.2025), për Shqyrtimin e Ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Pastrime Silvio” SHPK, protokolluar me tonën me nr. 3308/2 prot., datë 25.11.2025, rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse në datë 18.11.2025 përmes sistemit të ankesave elektronike, i ka kërkuar operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimesimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga

lex specialis, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit përmes sistemit të ankesave elektronike, më datë 18.11.2025 e ka njoftuar ankimuesin në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara mbi elementet formale të ankesës, konkretisht pagesën e tarifës së ankesës, nga ku konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë të autoritetit kontraktor, duke mos rregulluar të metat e ankesës.

Gjithashtu përmes shkresës me nr. 3308/6 prot., datë 15.01.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” Sektori i Financës në KPP ka njoftuar se: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3308/5 prot., date 09.01.2026, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bejmë me dije se për ankesën me nr.3308/2025 prot., datë 18.11.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/6090, Operatori ekonomik “PASTRIME SILVIO” Shpk nuk ka paraqitur dokumentin bankar që të vërtetojë pagesën.*

Në vijim të shkresës tuaj i është kërkuar Degës së Thesarit raporti për arkëtimet, ku sipas verifikimeve të kryera me raportin e dërguar më datë 14.01.2026 për arkëtimet e kryera për muajin Nëntor-Dhjetor 2025, rezulton se Operatori Ekonomik “PASTRIME SILVIO” Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”
Sa më sipër, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK pranë Komisionit Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës së ankimit, kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicën e anëtarëve,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: “Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë “Rej” SHPK dhe “Clean Fast” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet sipas konstatimeve më sipër.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ti propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për operatorin ekonomik “Rej” SHPK sipas konstatimeve të mësipërme.
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Rej” SHPK dhe “Clean Fast” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2026.01.22
04:17:57



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i
Prokurimit Publik
Date:2026/01/22 11:33:12 +02'00'
43bd9094144e4fd9b717ee45b305b0a3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i Anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Gjergj Mersini, në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsyetimit të vendimit të themelit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ‘Rej’ SHPK, konkretisht nuk jam dakord lidhur me arsyetimin në pikën III.2.13, III.3., III.4., III.5., III.5.1, III.5.2, III.5.3 si dhe nuk jam dakort me dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me

Objekt: “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: “Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

Lidhur me arsyetimin e shumicës në pikat, III.2.13, III.3., III.4., III.5., III.5.1, III.5.2, III.5.3, gjykoj se;

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” sh.p.k, mbi kundërshtimin e vendimit për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “Per dhe produktet larës dhe dezinfektues të renditura në pikën 3, 4, 5, dhe 6 të Seksionit 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit, Shtojca 8, duhet të paraqesë: dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim datë 09.10.2025, të lëshuar nga shoqëria “GET

klin” sh.p.k., me NIPT: L82420502U, i cili paraqitet në dokument si prodhues i detergjenteve, së bashku me dokumente MSDS për produktet të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në rubrikën “Leje/Licenca të lëshuara nga QKB”, rezulton se subjekti “GET klin” sh.p.k., NIPT: L82420502U, nuk është i pajisur me Leje/Licencë per Prodhim te Detergjenteve dhe nuk eshte i paji prodhues apo leje mjedisore si prodhues i Detergjenteve sipas nenit 4 të Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe Shtojcën 1 të këtij ligji (ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020), ku përcak Prodhimi dhe përpunimi/përzjerja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve” Kjo do të thotë se, çdo subjekt që ushtron aktivitet prodhimi ose përpunimi të detergjentëve, duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore “Për veprimtarinë 4.9 – produkteve të pastrimit/ detergjenteve”, të lëshuar nga autoritetet kompetente. Në mungesë të një Leje që vërteton se kjo shoqëri është prodhues i produkteve detergjentë, rezulton se MSDS-të nuk janë të lëshuara nga prodhuesi, siç k tenderit. Për rrjedhojë, KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.7, pasi dokumentet e paraqitura nuk i referohen një prodhuesi të ligjshëm të detergjentëve, duke mos garantuar kështu përmbushjen e specifikimev parashikuara në tender. Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. skualifikohet nga procedura e prokurimit.”, vërej se:

III.1.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7 dhe 2.3.8 të dokumenteteve t të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, për solucionet e renditur në pikën 3,4,5,6 “Solucionet dhe produktet lares dhe dizifektues”, Seksioni 2- Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm”, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”) duhet të paraqesë:

- dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide (nëse ofron një lëndë biocide) të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

III.1.2. Gjithashtu referuar Procesverbali i argumentimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi në lidhje me dy kriteret e mësipërme, autoriteti kontraktor ka argumentuar si më poshtë vijon:

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, për solucionet e renditur në pikën 3,4,5,6 “Solucionet dhe produktet lares dhe dizifektues”, Seksioni 2- Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm”, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”) duhet të paraqesë:

- dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenit 13 dhe 15 të Ligjit nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, VKM nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”. Është vlerësuar e rëndësishme që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentin me të dhënat e sigurisë të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të produkteve të cituar në këtë kriter, me qëllim që të sigurohet një nivel i lartë mbrojtje ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit, duke shmangur çdo efekt të dëmshëm që mund të vijë nga përdorimi i tyre.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide (nëse ofron një lëndë biocide) të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020 “Përcaktimi i rregullave për vlerësimin e produkteve biocide dhe i procedurës për dhënien e autorizimit për vendosjen e tyre në treg”, ky kriter është thelbësor për sigurimin e përdorimit korrekt, të sigurt dhe në përputhje me ligjin të produkteve biocide. Ky kriter garanton që operatori ekonomik ka njohuri teknike për produktin, duke shmangur rreziqet për shëndetin publik gjatë përdorimit dhe gjithashtu ndihmon në gjurmueshmërinë dhe ruajtjen e standarteve profesionale në treg.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “REJ” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Autorizim nr. 22 protokollit datë 9.10.2025 nga prodhuesi GentKlin shpk
- Certifikatë MSDS për produktin Rea triplex 1-2.5 litra
- Certifikatë MSDS për produktin Solo Pavimenti 1L
- Certifikatë MSDS për produktin REA Cristal
- Certifikatë MSDS për produktin REA Cristal
- Certifikatë MSDS për produktin ANA mobilje 0.5 -0.75 l
- Shtojcën 12 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”

III.1.4. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.1.5. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë tale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktorë, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.6. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat për shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Neni 82 pika 2 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, të barazisë dhe të mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjykoj, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët

ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatoj se autoriteti kontraktor në kriteret e vecanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikuar se operatori ekonomik në përpmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.6. *për solucionet e renditur në pikën 3,4,5,6 “Solucionet dhe produktet lares dhe dizifektues”, Seksioni 2- Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm”, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”)* duhet të paraqesë: - dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.

Gjithashtu, në dokumentet e procedurës së prokurimit, kriteret e vecanta të kualifikimit por edhe në argumentimin e kriterëve të vendosur nga autoriteti kontraktor dhe të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kërkuar një document të posacëm për subjekte të treta jo pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi sikundër është edhe prodhuesi i solucioneve të renditura nga autoriteti kontraktor. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar vetëm disponueshmërinë e certifikatave MSDS të lëshuar nga prodhuesi, dokumente të cilat janë dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në nenin 77 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të ndryshuar parashikohet se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kriterëve.” Gjithashtu në nenin 92 pika 3 të ligjit të prokurimit publik parashikohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.” Në rastin konkret, konstatoj se autoriteti kontraktor vlerësuar dhe skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “REJ” shpk referuar një kriteri të pa kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit. Akoma më tej edhe nga verifikimi i argumentimit të kriterëve, konstatoj se baza ligjore e përdorur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është pasqyruar as në dokumentet e procedurës dhe as në arsyetimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “REJ” qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” sh.p.k, mbi kundërshtimin e vendimit për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet se:

“3. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin n pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve”) produktin “Rea Triplex”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k. Pas shqyrtimit të

dokumentacionit teknik dhe MSD nuk përmbush kërkesat e Specifikimeve Teknike për arsytet si vijon:

- Dokumentacioni i paraqitur nuk përmban asnjë referencë që produkti të përdoret specifikisht për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve, siç kër përmendet se produkti heq pikat e bardha të ujit (lloji i mbetjeve gëlqerore që formohen në sipërfaqe sanitare).
- Nuk jepen udhëzime për raportin e hollimit 1:150–1:200 me ujë, siç kërkon specifikimi teknik. (Në specifikimin teknik të produkti të përdoret edhe për larjen e pllakave të poshtme të tualeteve me hollim 1:150 – 1:200 me ujë. Në MSDS-në e paraqitur nga operatori ekonomik për produktin “Rea Triplex”, nuk jepen udhëzime mbi raportin e hollimit ose mën aplikimit praktik.
- Dokumenti nuk provon se produkti bën pjesë në një linjë profesionale pastrimi, siç kërkohet për produktet e kategorisë sanitare industriale dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 te Ligjit Nr.10 216, dat percaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”. Për sa më sipër, produktit “Rea Tripl teknike dhe dokumentare me kërkesat e artikullit 3 të Specifikimeve Teknike dhe me kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7 (MSDS të lëshuar nga prodhuesi). Si rrjedhojë, operatori ekonomik nuk konsiderohet përmbushës për këtë artik konsideratë për përmbushjen e kërkesave të kontratës”

“4. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur, për artikullin nr. 4 (“Solucion për larje pllakash dysHEMEJE”), produktin “Rea Triplex”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Klin” sh.p.k. Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, që lidhen me solucionet e renditura në pikat 3, 4, 5 dhe 6 “Solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues”, për arsytet si më poshtë: Sipas specifikimeve teknike, për artikullin Nr.4, kërko dysHEMEJE. Të jetë sa më i koncentruar (1:200 me ujë). Të lërë aromë të lehtë pas larjes. Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar sipas këtyre standardeve. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Masa nga 1 deri në 10 (8 +/- 5%).” Operatori ekonomik i referuar më sipër ka paraqitur MSDS për produktin “Solo Pavimenti 1L”, i cili, sipas dokumentit, është zbardhues dhe dezinfektues. Nga analiza rezulton se ky produkt nuk përmbush specifikimet teknik pasi:

- Nuk jep udhëzime për hollim 1:200 me ujë, siç kërkon specifikimi teknik;
- Nuk jep asnjë informacion që vërteton se produkti është pjesë e një “linje profesionale”, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin percaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiak referencë ndaj përdorimit industrial ose profesional,
- Mungojnë të dhënat për certifikimet ose standardet e aplikueshme (p.sh. EN, ISO, ose CE), që të konfirmonin klasifikimin e produktit sipas standardeve të Bashkimit Evropian.”

“ 5. Op për artikullin nr. 5 (“Solucion për larje xhamash”) produktin “Rea Cristal”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k. Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së par kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, për arsytet si më poshtë: Sipas

“Solucion për larje xhamash (me spray). Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Masa të jetë 500–800 ml me spray. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (produktit “Rea Cristal” rezulton se: • Megjithatë, MSDS nuk përmban asnjë informacion për masën, paketimin apo ekzistencën e mekanizmit “spray” (500–800 ml), që është kërkesë eksplicite e DST-së; • Dokumenti është përpiluar nga produkti është “prodhim me standarde të BE-së”, siç kërkohet në DST; • Në MSDS nuk specifikohet klasifikimi profesional i produktit (“përdorim profesional”), çka nuk lejon verifikimin nëse produkti i përket “linjës profesionale” të kërkuar “Perkufizime”, pika 12 te Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” ne te cilin percaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte shtëpiake.”; Për rrjedhojë, operatori ekonomik skualifikohet pasi nuk përmbushë kriteret e kualifikimit.” vërej se:

III.2.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7 dhe 2.3.8 të dokumenteteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, për solucionet e renditur në pikën 3,4,5,6 “*Solucionet dhe produktet lares dhe dizifektues*”, Seksioni 2- *Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm*”, Shtojca 8 “*Specifikimet teknike*”) duhet të paraqesë:

- dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide (**nëse ofron një lëndë biocide**) të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

III.2.2. Gjithashtu referuar Procesverbali i argumentimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi në lidhje me dy kriteret e mësipërme, autoriteti kontraktor ka argumentuar si më poshtë vijon:

2.3.6. *Operatori ekonomik ofertues, për solucionet e renditur në pikën 3,4,5,6 “Solucionet dhe produktet lares dhe dizifektues”, Seksioni 2- Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm”, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”) duhet të paraqesë:*

- dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenit 13 dhe 15 të Ligjit nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, VKM nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike,

përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”. Është vlerësuar e rëndësishme që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentin me të dhënat e sigurisë të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të produkteve të cituar në këtë kriter, me qëllim që të sigurohet një nivel i lartë mbrojtje ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit, duke shmangur çdo efekt të dëmshëm që mund të vijë nga përdorimi i tyre.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide (nëse ofron një lëndë biocide) të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020 “Përcaktimi i rregullave për vlerësimin e produkteve biocide dhe i procedurës për dhënien e autorizimit për vendosjen e tyre në treg”, ky kriter është thelbësor për sigurimin e përdorimit korrekt, të sigurt dhe në përputhje me ligjin të produkteve biocide. Ky kriter garanton që operatori ekonomik ka njohuri teknike për produktin, duke shmangur rreziqet për shëndetin publik gjatë përdorimit dhe gjithashtu ndihmon në gjurmueshmërinë dhe ruajtjen e standarteve profesionale në treg.*

Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka përcaktuar edhe specifikimet teknike të solucioneve me të cilat do të kryhet shërbimi si më poshtë vijon:

- 1. Solucion zbardhues që përdoret për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve. Te heqë pikat e bardha të ujit. Te përdoret edhe për larjen e pllakeve të poshtme të tualeteve me hollim 1-150 në 1-200 me uje. Masat nga 1-10 litra. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(1-2)*
- 2. Solucion për larje pllakash dyshemeje. Te jete sa me I koncentruar (1-200 me uje). Te lere arome të lehte pas larjes. Te jete prodhim me standarte të EU dhe I certifikuar sipas këtyre standarteve. Te kete kartat e sigurise dhe perberjes. Masa nga 1 deri ne 10 litra. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(8+/-5%)*
- 3. Solucion për larje xhamash (me spray). Te jete prodhim me standarte të EU dhe I certifikuar. Te kete kartat e sigurise dhe perberjes. Te kete arome të lehte. Masa te jete 500-800 ml me spray. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(8.5-9)*
- 4. Solucion për larje mobiljesh (me spray) 500 ml. Te jete prodhim me standarte të EU dhe I certifikuar. Te kete kartat e sigurise dhe perberjes. Te kete arome të lehte. Te jete linje profesionale. Niveli I PH-(8 -9)*

Produktet duhet te jene te pajisura nga prodhuesi me certificate sigurie dhe do te paraqiten nga OE i kontraktuar përpara nënshkrimin të kontratës nga palët

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “REJ” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Autorizim nr. 22 protokolli datë 9.10.2025 nga prodhuesi GentKlin shpk
- Certifikatë MSDS për produktin Rea triplex 1-2.5 litra
- Certifikatë MSDS për produktin Solo Pavimenti 1L
- Certifikatë MSDS për produktin REA Cristal
- Certifikatë MSDS për produktin REA Cristal
- Certifikatë MSDS për produktin ANA mobilje 0.5 -0.75 l

III.2.4. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.5. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e

kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktorë, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.6. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat për shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Neni 82 pika 2 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e

kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, të barazisë dhe të mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjykoj, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.8. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatoj se autoriteti kontraktor në kriteret e vecanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikuar se operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.6. *për solucionet e renditur në pikën 3,4,5,6 “Solucionet dhe produktet lares dhe dizifektues”, Seksioni 2- Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm”, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”)* duhet të paraqesë: - **dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.**

Gjithashtu, në dokumentet e procedurës së prokurimit, kriteret e vecanta të kualifikimit por edhe në argumentimin e kriterëve të vendosur nga autoriteti kontraktor dhe të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kërkuar një document të posacëm për subjekte të treta jo pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi sikundër është edhe prodhuesi i solucioneve të renditura nga autoriteti kontraktor. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar vetëm disponueshmërinë e certifikatave MSDS, kriter i cili nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar si më poshtë vijon: : *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenit 13 dhe 15 të Ligjit nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, VKM nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”.* Është vlerësuar e rëndësishme që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentin me të dhënat e sigurisë të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të produkteve të cituar në këtë kriter, me qëllim që të sigurohet një nivel i lartë mbrojtje ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit, duke shmangur çdo efekt të dëmshëm që mund të vijë nga përdorimi i tyre.

III.2.9. Në pikën 8 të “Përkufizimeve” të VKM nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë” parashikohet “MSDS”, Dokumenti me të Dhënat e Sigurisë që shoqëron kimikatin, sipas kreut V dhe formatit të përcaktuar në këto rregulla.

Në shtojcën 2 të VKM nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë” përcaktohen edhe edhe seksionet e detyrueshme të cilat duhet të përmbajë formati i MSDS-së sipas parashikimeve të aktit në fuqi të cilat janë: “ 1. SEKSIONI 1: Identifikimi i substancës/ përzierjes dhe i kompanisë/ndërmarrjes /2. SEKSIONI 2: Identifikimi i rreziqeve/SEKSIONI 3: Përbërja/informacioni mbi përbërësit /4. SEKSIONI 4: Masat e ndihmës së parë/5. SEKSIONI 5: Masat për fikjen e zjarrit/6. SEKSIONI 6: Masat e shkarkimit aksidental/7. SEKSIONI 7: Trajtimi dhe ruajtja /8. SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/ mbrojtja personale /9. SEKSIONI 9: VETITË FIZIKE DHE KIMIKE/10. SEKSIONI 10: Stabiliteti dhe reaktiviteti /11. SEKSIONI 11: Informacioni toksikologjik /12. SEKSIONI 12: Informacioni ekologjik /13. SEKSIONI 13: Konsiderata në lidhje me/për asgjësimin /14. SEKSIONI 14: Informacioni i transportit/15. SEKSIONI 15: Informacioni rregullator /16. SEKSIONI 16: Informacione të tjera ”

III.2.10.Konstatohet se referuar kriterëve të vecanta të kualifikimit, për tu garantuar për cilësinë e produkteve me të cilat do të kryhet shërimi i pastrimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar dorëzimin e certifikatës MSDS për produktet me numër rendor 3,4,5,6. Për produktet e mësipërme, gjykoj se autoriteti kontraktor **nuk ka përcaktuar në asnjë rast dorëzimin e katalogëve/skedave teknike të produkteve** me qëllim verifikimin e përpuetshmërisë së specifikimeve teknike të propozuara me ato të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Së pari, vlerësoj se ka një dallim të qartë mes kërkesës për dorëzimin e katalogëve/skedave teknike nga prodhuesit dhe kërkesës për dorëzimin e certifikatës MSDS. Skedat teknike/katalogjet e prodhuesit, apo dëshmi të testimeve zyrtare parashikohen si një dokument që autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë në përputhje me nenin 40 pika 6 gërma b dhe c të vendimit nr. VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë: “fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Ndërkohë dokumenti i kërkuar në përmbushjen e kriterit të kërkuar në rastin konkret nga ana e autoritetit kontraktor është e një natyre tjetër juridike nga ajo e skedave teknike, pasi ka një rregullim të posaçëm ligjor mbi formën dhe përmbajtjen e dokumentit. Kështu, gjykoj se në skedën e sigurisë MSDS autoriteti kontraktor mund të kryejë verifikime për aq sa është parashikuar në formatin e MSDS-së sipas parashikimeve të aktit nënligjor dhe jo të cdo specifikimi teknik të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor vecanërisht ato në terma funksionalë (heqja e njollave, etj), pasi në këtë rast është tej qëllimit të hartimit të MSDS-së sipas përcaktimeve të VKM-së.

Gjithashtu, pretendimi i autoritetit kontraktor për interpretimin në mënyrë të kombinuar të kriterit mbi dorëzimin e MSDS (kriteri 2.36-) me specifikimet teknike nuk qëndron. Në rastin konkret, gjykoj se këto janë dy elemente të ndryshme. Gjithashtu, referuar shtojcës 2 të VKM 9/2019 mbi formatin e MSDS në asnjë prej kërkesave të këtij formati nuk parashikohet se produkti duhet të përshkruajë llojin e përdorimit të produktit (industrial ose jo).

Gjithashtu në lidhje me pretendimet për produktin produktin “Rea Triplex”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k. se : “Nuk jepen udhëzime për raportin e hollimit 1:150–1:200 me ujë, siç kërkon specifikimi teknik. (Në specifikimin teknik të produkti të përdoret edhe për larjen e pllakave të poshtme të tualeteve me hollim 1:150 – 1:200 me ujë. Në MSDS-në e paraqitur nga operatori ekonomik për produktin “Rea Triplex”, nuk jepen udhëzime mbi raportin e hollimit ose mën aplikimit praktik”, gjykoj se Skeda MSDS e dorëzuar është në përputhje me formatin e përcaktuar në VKM dhe në seksion të posacëm jepet informacioni se: **“Disponimi i Lendes : Treteni materialin me uje te bollshem . Merni masat e kerkuara”** Pra, në rastin konkret skeda MSDS jep indicie të plotë mbi metodën e hollimit të produktit, ndërkohë që nëse autoriteti kontraktor ka dyshime ka mundësinë që bazuar në nenin 82 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: “Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.” Pra, nëse autoriteti kontraktor ka dyshime mbi produktin ka patur mundësinë të kërkoj sqarime drejtpërdrejtë tek prodhuesi referuar të dhënave të deklaruar nga ana e operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Në lidhje me arsyen e skualifikimit se ndokumentacioni i paraqitur nuk përmban asnjë referencë që produkti të përdoret specifikisht për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve, siç kër përmendet se produkti heq pikat e bardha të ujit (lloji i mbetjeve gëlqerore që formohen në sipërfaqe sanitare). gjykoj se ky është një përshkrim funksional i specifikimeve teknike dhe nuk përmban një të dhënë teknike në fushën e përcaktimeve të elementëve që duhet të përmbajë formati i MSDS-së sipas të VKM nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”. Akoma më tej, autoriteti kontraktor ka mundësinë që bazuar në nenin 82 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: “Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.” Pra, nëse autoriteti kontraktor ka dyshime mbi produktin ka patur mundësinë të kërkoj sqarime drejtpërdrejtë tek prodhuesi referuar të dhënave të deklaruar nga ana e operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Në lidhje me arsyen e skualifikimit për artikullin nr. 4 (“Solucion për larje pllakash dysHEMEJE”), produktin “Rea Triplex”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave t Klin” sh.p.k:

Nga analiza rezulton se ky produkt nuk përmbush specifikimet teknik pasi: • Nuk jep udhëzime për hollim 1:200 me ujë, siç kërkon specifikimi teknik; Skeda MSDS e dorëzuar është në përputhje me formatin e përcaktuar në VKM dhe në seksion të posacëm jepet informacioni se: **“Disponimi**

i Lendes : Treteni materialin me uje te bollshem . Merni masat e kerkuara ” Pra, në rastin konkret skeda MSDS jep indicie të plotë mbi metodën e hollimit të produktit, ndërkohë që nëse autoriteti kontraktor ka dyshime ka mundësinë që bazuar në nenin 82 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuarn ku parashikohet se: “Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.” Pra, nëse autoriteti kontraktor ka dyshime mbi produktin ka patur mundësinë të kërkoj sqarime drejtpërdrejtë tek prodhuesi referuar të dhënave të deklaruar nga ana e operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Në lidhje me arsyen për produktin “Solo Pavimenti 1L”, i cili, sipas dokumentit, është zbardhues dhe dezinfektues. Nga analiza rezulton se ky produkt nuk permbush specifikimet teknik pasi: • Nuk jep udhëzime për hollim 1:200 me ujë, siç kërkon specifikimi teknik; konstatoj se Skeda MSDS e dorëzuar është në përputhje me formatin e përcaktuar në VKM dhe në në seksionin të dhëna ekologjike dhe lëvizshmëria të dokumentit përshkruhet se: **“Disponimi i Lendes : Treteni materialin me uje te bollshem . Merni masat e kerkuara”**

Pra, në rastin konkret skeda MSDS jep indicie të plotë mbi metodën e hollimit të produktit, ndërkohë që nëse autoriteti kontraktor ka dyshime ka mundësinë që bazuar në nenin 82 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuarn ku parashikohet se: “Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.” Pra, nëse autoriteti kontraktor ka dyshime mbi produktin ka patur mundësinë të kërkoj sqarime drejtpërdrejtë tek prodhuesi referuar të dhënave të deklaruar nga ana e operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Në lidhje me arsyen e skualifikimit se *Mungojnë të dhënat për certifikimet ose standardet e aplikueshme (p.sh. EN, ISO, ose CE), që të konfirmonin klasifikimin e produktit sipas standardeve të Bashkimit Evropian*. Gjykoj se kjo arsye është bazuar në një kriter të pa kërkuar. Konstatoj se nga ana e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike është kërkuar në mënyrë narrative që produkti *Te jete prodhim me standarte te EU dhe I certifikuar sipas ketyre standarteve.*, ndërkohë në dokumentet e procedurës së prokurimit si në shtojcën mbi specifikimet teknike ashtu edhe në shtojcën mbi kriteret e vecanta të kualifikimit nuk **është përcaktuar një standard konkret** që operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë, por thjesht në përshkrim të përgjithshëm. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar vetëm disponueshmërinë e certifikatave MSDS të lëshuar nga prodhuesi, dokumente të cilat janë dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në nenin 77 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: “5.

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Gjithashtu në nenin 92 pika 3 të ligjit të prokurimit publik parashikohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.” Në rastin konkret, konstatoj se autoriteti kontraktor ka vlerësuar dhe skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “REJ” shpk referuar një kriteri të pa kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit. Akoma më tej, konstatoj se në certifikatat MSDS të dorëzuar nga operatori ekonomik në seksionin “*Informacione të tjera*” ndër të tjera ka deklaruar përpuethshmërinë e produktit me rregullat e Bashkimit Europian si: *Burimet e informacioneve :Udhezimi 91/155 Komunitet iEuropian Udhezimi 94 69 L 381/94 D 96/54 Komunitet iEuropian Udhezimi 91/325 Komunitet iEuropa Udhezimi 99 Komunitet iEuropian* duke dhënë kështu një indicie të qartë për autoritetin kontraktor. Kështu nëse autoriteti kontraktor ka patur dyshime gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka patur në dispozicion momentin procedural të kërkimit të kryerjes së verifikimeve bazuar në nenin 82 pika 2 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

Në lidhje me pretendimin se “*Dokumentacioni i paraqitur nuk përmban asnjë referencë që produkti të përdoret specifikisht për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve, siç kër përmendet se produkti heq pikat e bardha të ujit (lloji i mbetjeve gëlqerore që formohen në sipërfaqe sanitare)*” gjykoj se ky është një përshkrim funksional i specifikimeve teknike dhe nuk përmban një të dhënë teknike në fushën e përcaktimeve të elementëve që duhet të përmbajë formati i MSDS-së sipas të VKM nr.9 datë 09.01.2019 “*Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë*”. Akoma më tej, autoriteti kontraktor ka mundësinë që bazuar në nenin 82 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: “Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.” Pra, nëse autoriteti kontraktor ka dyshime mbi produktin ka patur mundësinë të kërkoj sqarime drejtpërdrejtë tek prodhuesi referuar të dhënavë të deklaruar nga ana e operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Në lidhje me arsyen e skualifikimit *për produktin r. 5 (“Solucion për larje xhamash”) produktin “Rea Cristal”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k. • Megjithatë, MSDS nuk përmban asnjë informacion për masën, paketimin apo*

ekzistencën e mekanizmit “spray” (500–800 ml), që është kërkesë eksplicite e DST-së; konstatoj se në seksionin *Informacioni i Transportit* të certifikatës MSDS është deklaruar ndër të tjera: *Menyra e transportimit : ne bidona plastike sipas formatit te prodhimit.* konstatoj se operatori ekonomik ka dhënë një indicie të qartë për verifikim për autoritetin kontraktor në lidhje me formatin e paketimit, ku krahas saj ka dorëzuar edhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku ndër të tjera ka deklaruar edhe përmbushjen e specifikimeve teknike, ku një prej të cilave është edhe formati i paketimit të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Akoma më tej, autoriteti kontraktor ka mundësinë që bazuar në nenin 82 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: “Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.” Pra, nëse autoriteti kontraktor ka dyshime mbi produktin ka patur mundësinë të kërkoj sqarime drejtpërdrejtë tek prodhuesi referuar të dhënave të deklaruar nga ana e operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Gjithashtu, konstatoj se referuar VKM nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë referuar shtojcës 2, nënseksioni 14 *Informacioni i transportit*, parashikohet se: “14.4 Grupi i paketimit: Numri i grupit të paketimit do të sigurohet nga Rregulloret Model të OKB-së, nëse është e aplikueshme. Numri i grupit të paketimit i caktohet substancave të caktuara në përputhje me shkallën e yre të rrezikut.” Pra, referuar aktit nënligjor që rregullon formatin e MSDS nuk është detyrim deklarimi i formatit të paketimit, por grupi I paketimit.

Në lidhje me arsyen e skualifikimit se “*Dokumenti është përpiluar nga produkti është “prodhim me standarde të BE-së”, siç kërkohet në DST*”. Gjykoj se kjo arsye është bazuar në një kriter të pa kërkuar. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike është kërkuar në mënyrë narrative që produkti *Te jete prodhim me standarte te EU dhe I certifikuar sipas ketyre standarteve.*, ndërkohë në dokumentet e procedurës së prokurimit si në shtojcën mbi specifikimet teknike ashtu edhe në shtojcën mbi kriteret e vecanta të kualifikimit nuk është përcaktuar një standard konkret që operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë, por thjesht në përshkrim të përgjithshëm. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar vetëm disponueshmërinë e certifikatave MSDS të lëshuar nga prodhuesi, dokumente të cilat janë dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në nenin 77 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Gjithashtu në nenin 92 pika 3 të ligjit të prokurimit publik parashikohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin

e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.” Në rastin konkret, konstatohet se autoriteti kontraktor vlerësuar dhe skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “REJ” shpk referuar një kriteri të pa kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit. Akoma më tej, konstatohet se në certifikatat MSDS të dorëzuara nga operatori ekonomik në seksionin “*Informacione të tjera*” ndër të tjera ka deklaruar përpuethshmërinë e produktit me rregullat e Bashkimit Europian si: *Burimet e informacioneve :Udhezimi 91/155 Komunitet iEuropian Udhezimi 94 69 L 381/94 D 96/54 Komunitet iEuropian Udhezimi 91/325 Komunitet I Europia Udhezimi 99 Komunitet iEuropian* duke dhënë kështu një indicie të qartë për autoritetin kontraktor. Kështu nëse autoriteti kontraktor ka patur dyshime gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka patur në dispozicion momentin procedural të kërimit të kryerjes së verifikimeve bazuar në nenin 82 pika 2 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

Në lidhje me pretendimet se në *MSDS nuk specifikohet klasifikimi profesional i produktit (“përdorim profesional”)*, Kështu, gjykoj se në skedën e sigurisë MSDS autoriteti kontraktor mund të kryejë verifikime për aq sa është parashikuar në formatin e MSDS-së sipas parashikimeve të aktit nënligjor dhe jo të cdo specifikimi teknik të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor vecanërisht ato në terma funksionalë (heqja e njollave, etj), pasi në këtë rast është tejet qëllimor të hartimit të MSDS-së sipas përcaktimeve të VKM-së. Gjithashtu, pretendimi i autoritetit kontraktor për interpretimin në mënyrë të kombinuar të kriterit mbi dorëzimin e MSDS (kriteri 2.36-2.37) me specifikimet teknike nuk qëndron. Në rastin konkret, gjykoj se këto janë dy elemente të ndryshme dhe dy regjime të ndryshme ligjore sikundër sqaruar më sipër. Gjithashtu, referuar shtojcës 2 të VKM 9/2019 mbi formatin e MSDS në asnjë prej kërkesave të këtij formati nuk parashikohet se produkti duhet të përshkruajë llojin e përdorimit të produktit (industrial ose jo).

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “REJ” shpk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” sh.p.k, mbi kundërshtimin e vendimit për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: *“Operatori ekonomik “REJ” Sh prodhuesi ose distributori i autorizuar për lëndët biocide që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit. Sipas pikës 2.3.8 të specifikimeve teknike, çdo ofrues që përdor lëndë biocide duhet të vërtetojë lidhjen me prodhuesin ose distribut e plota të kontaktit për verifikim nga Autoriteti Kontraktor. Sipas analizës së specifikimeve teknike, përdorimi i lëndëve biocide është i paevitueshëm, sepse shërbimi objekt prokurimi kërkon dezinfektim dhe kontroll të mikroorganizmave në Ambjentet e Kujdesit Intesiv dhe në ambjentet e tjera Spitalore që janë me risk shumë të lartë infektimi, për të garantuar standardet e sigurisë dhe higjienës të përcaktuara. Pa përdorimin e biocideve të autorizuara, nuk mund të arr mbrojtjes, çka e bën të pamundur*

përmbushjen e kushteve teknike të kontratës. Për shkak të mungesës së dokumentacionit të autorizimit përkatës, oferta skualifikohet.” vërej se:

III.3.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.8 2.3.8. është parashikuar Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide (**nëse ofron një lëndë biocide**) të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

III.3.2. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.3. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë tale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktorë, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat për shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Neni 82 pika 2 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës,

të barazisë dhe të mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjykoj, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.3.6. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatoj se autoriteti kontraktor në kriteret e vecanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikuar se operatori ekonomik në përpmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën Në shtojcën 11 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.8 2.3.8. Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide (**nëse ofron një lëndë biocide**) të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Në nenin 77 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Gjithashtu në nenin 92 pika 3 të ligjit të prokurimit publik parashikohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

Në rastin konkret, konstatoj se autoriteti kontraktor vlerësuar dhe skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “REJ” shpk referuar një kriteri i cili vetë nga autoriteti kontraktor është lënë në vlerësim të operatorit ekonomik për tu përmbushur, pasi lidhet me faktin nëse operatori ekonomik ofron një lëndë biocide dhe jo në të gjithë rastet e tjera. Pra, autoriteti kontraktor ka parashikuar detyrimin e përmbushjes së këtij kriteri vetëm në rastet se operatori ekonomik pjesëmarrës do të paraqesë produkte biocide.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “Clean Fast” SHPK dhe “Pastrime Silvio” SHPK nga procedura e prokurimit objekt ankimi ato nuk do të marr në shqyrtim pasi jam dakort me arsyetimin e vendimit të themelit ku edhe pas shqyrtimit të pretendimeve të

ngritura nga këta operatorë ekonomik gjendja juridike dhe faktike e tyre do të vazhdojë të mbetet e skuallfikuar duke përmbushur edhe interesin e ankimuesit.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” sh.p.k, mbi kundërshtimin e vendimit për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AIR” shpk për mos përmbushje të kriterit 2.3.4 *kapaciteti teknik* gjykoj se:

III.5.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.4 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të jashtme e të brendshme, objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 50 (pesedhjetë) punonjës, si më poshtë:

Nr.	Pozicioni i punes	Numri i punonjësve
1	Përgjegjës Shërbimi	2 (dy)
2	Punonjës pastrimi/sanitar	47(dyzeteshatë)
3	Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuara	1 (një)
	Totali	50 (pesedhjetë)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

a) Për Përgjegjësin e Shërbimit:

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/kimist/biokimist dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë
- CV ku te deshmohet eksperience pune ne kontrata te ngjashme
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi.

b) Për punonjësit e pastrimit/ sanitar, të paraqitet:

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

c) Për punonjësit shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi në përputhje me mjetet e kërkuara, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë i angazhuar për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës dhe mund të ndryshohet vetëm me miratimin e AK përfitues.

III.5.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Marrëveshjen datë 15.10.2025 mbi mbështetjen në kapacitete. Në nenin 2 të marrëveshjes është deklaruar edhe objekti I mbështetjes në kapacitete si më poshtë vijon:

“ Pika 2.2.1- DST-provimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar

Pika 2.3.4 e DST- kapaciteti teknik

Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të jashtme e të brendshme, objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 50 (pesedhjetë) punonjës, si më poshtë:

- Nr. 2 Punonjës pastrimi/sanitar: 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës pastrimi/sanitar në përputhje me kërkesat e DST 2.3.4 pika nr.2
- Nr. 3 Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuar: 1 (një) shofer në përputhje me kërkesat e DST 2.3.4 pika nr.3

Pika 2.3.5 – duhet të disponojë mjetet si më poshtë:

- **Kosha të transportit të mbetjeve të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapakë: 30** (tridhjetë) copë në përputhje me kërkesat e DST 2.3.5 pika nr.5
- **Makinë për larjen e rrugëve (autobot), të pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesët anësore të tij me kapacitet mbajtës, jo më pak se 5000 litra ujë,** 1 (një) copë në përputhje me kërkesat e DST 2.3.5 pika nr.5

- Shtojca 12 “Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të operatorit ekonomik subjekt mbështetës “Silver” shpk ku ndër të tjera ka deklaruar në seksionin B të shtojcës “Deklaratë mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” ka deklaruar disponueshmërinë e 56 punonjësve dhe angazhimin e 18 punonjësve (pastrim/sanitar) në përmbushje të kriterit 2.3.4/2 dhe 1 shofer në përmbushje të kriterit 2.3.4 3.

-Shtojca 12 “Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të operatorit ekonomik “AIR” shpk ku ndër të tjera ka deklaruar në seksionin B të shtojcës ku ka deklaruar:

- z.A.P – përgjegjës shërbimi biokimist me diplomë
- z.A.P -përgjegjës shërbimi inxhinier agro mjedisi.

III.5.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.5.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.5.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.5.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: 1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP- së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë

i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi; l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga

legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

III.5.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, gjykoj, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.5.8. Referuar shtojcës 11 kriteret e vecanta të kualifikimit, konstatoj se autoriteti kontraktor ka kërkuar që **Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/kimist/biokimist dhe për këtë punonjës.**

Gjithashtu, ky kriter është arsyetuar nga ana e autoritetit kontraktor se *”Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK.*

Përgjegjësi i shërbimit nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, me qëllim që shërbimi objekt prokurimi të kryhet sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës.

Duke vlerësuar që shërbimi i pastrimit të ambjenteve të brendshme e të jashtme të spitalit, është një shërbim gjatë kryerjes të së cilit kërkohet përdorimi i produkteve që përmbajnë kimikate, përdorimi i produkteve që mund të çojnë në lëshimin e ndotësve të ajrit të brendshëm, të cilat mund të jenë të dëmshme për shëndetin e pacientëve dhe stafit, përdorimi i makinerive të pastrimit, të cilat kontribuojnë në emetimin e gazrave të dëmshëm, vlerësohet që përgjegjësi i shërbimit të jetë inxhinier mjedisi/kimist/biokimist, i cili do të kryejë mbikëqyrjen e realizimit të shërbimit, objekt prokurimi, konform kushteve dhe standarteve të kërkuara për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në specifikimet teknike. Pra, referuar arsytimit të kriterit autoriteti kontraktor **ka kufizuar profilin** e drejtuesit teknik në tre degë: **inxhinier mjedisi/kimist dhe biokimist**, ndërkohë referuar vetëdeklarimit të operatorit ekonomik ky i fundit ka deklaruar disponueshmërinë e përgjegjësve të shërbimit: - z.A.P – përgjegjës shërbimi **biokimist** me diplomë - z.A.P -përgjegjës shërbimi **inxhinier agro mjedisi**. Konstatoj se operatori ekonomik “AIR” shpk ka vërtetuar përmbushjen e kriterit vetëm **për një nga dy inxhinierët** e kërkuar sipas profilit të përcaktuar nga ana e autoritetit

kontraktor, pasi vetëm për z. AP është deklaruar inxhinier biokimist, ndërsa inxhinieri tjetër z. A.P është deklaruar agro-mjedis, një profil i ndryshëm nga ai i kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor duke mos përmbushur kështu kriterin e vecantë për kualifikim. Akoma më tej, konstatoj se edhe në deklaratën e mbështetjes në kapacitete ky I fundit nuk është mbështetur në kapacitetet për disponueshmërinë e përgjegjës të shërbimit, por ka deklaruar se I përmbush me kapacitetet e tij, megjithëse nga verifikimi rezulton se nuk disponon dy përgjegjës shërbimi sipas përcaktimit të profileve të autoritetit kontraktor duke rënë ndesh me kriteret e vecanta të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “REJ” shpk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “REJ” sh.p.k, mbi kundërshtimin e vendimit për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AIR” shpk për mos përmbushje të kriterit 2.3.5 *kapaciteti teknik* gjykoj se:

III.6.1. Në shtojcës 11 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.5 të dokumenteve të procedurës autoriteti kontraktor ka parashikuar se: “Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Makineri larëse tharëse për ambjentet e brendëshme	Copë	2 (dy)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
2	Makineri larese per te gjitha llojet e shtresave (mokat, beton, laminat, etj)	Copë	2 (dy)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
3	Pajisje për larje në lartësi deri në 20 m me ujë te purifikuar	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
4	Pompa sperkatese me mjegull të ftohtë, per aplikimin e kimikateve dezinfektues me bateri ose me korent	Copë	10 (dhjetë)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
5	Kosha të transportit të mbetjeve të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapakë	Copë	20 (njëzetë)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
6	Karrela për pastrimin me të gjitha mjetet e nevojshme për pastrim	Copë	20 (njëzetë)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
7	Makinë për larjen e rrugëve (autobot), të pajisur me pompë për	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim

	larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesët anësore të tij me kapacitet mbajtës, jo më pak se 5000 litra ujë,			
8	Fshese me vakum elektrike per fshirjen e rrugëve, i pajisur me tub thithes per mbeturina urbane (si cigare, shishe plastike te medha dhe te vogla, letra, gjethe pemesh, jashteqitjet e kafsheve si dhe cdo lloj mbeturine tjeter)	Copë	2 (dy)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Për Mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë (të vlefshëm), si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, operatori ekonomik, duhet të paraqese dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.6.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Marrëveshjen datë 15.10.2025 mbi mbështetjen në kapacitete. Në nenin 2 të marrëveshjes është deklaruar edhe objekti I mbështetjes në kapacitete si më poshtë vijon:

“ Pika 2.2.1- DST-provimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar

Pika 2.3.4 e DST- kapaciteti teknik

Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të jashtme e të brendshme, objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 50 (pesedhjetë) punonjës, si më poshtë:

- Nr. 2 Punonjës pastrimi/sanitar: 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës pastrimi/sanitar në përputhje me kërkesat e DST 2.3.4 pika nr.2
- Nr. 3 Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuar: 1 (një) shofer në përputhje me kërkesat e DST 2.3.4 pika nr.3

Pika 2.3.5 – duhet të disponojë mjetet si më poshtë:

- **Kosha të transportit të mbetjeve të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapakë: 30** (tridhjetë) copë në përputhje me kërkesat e DST 2.3.5 pika nr.5
 - **Makinë për larjen e rrugëve (autobot), të pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesët anësore të tij me kapacitet mbajtës, jo më pak se 5000 litra ujë, 1 (një) copë** në përputhje me kërkesat e DST 2.3.5 pika nr.5
- Shtojca 12 “Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të operatorit ekonomik subjekt mbështetës “Silver” shpk ku ndër të tjera ka deklaruar në seksionin B të shtojcës “Deklaratë mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” ka deklaruar disponueshmërinë e:
- Në përmbushje të kriterit 2.3.5 të kapacitetit teknik nr. 5, kriteri i përmbushur nga subjekti “Silver” shpk: 30 Kosha të transportit të mbetjeve të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapakë me faturë nr.
 - Në përmbushje të kriterit 2.3.5 të kapacitetit teknik nr. 7, kriteri i përmbushur nga subjekti “Silver” shpk: Autobot me targë nr.X

-Shtojca 12 12 “Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të operatorit ekonomik “AIR” shpk ku ndër të tjera ka deklaruar në seksionin B të shtojcës ku ka deklaruar:

- Në përmbushje të kriterit 2.3.4 nr. 5 të DST, AFA Group shpk fatura nr.X datë 16/8/2024 kosha mbeturinash 20 copë
- Në përmbushje të kriterit 2.3.4 nr. 5 të DST kriteri i përmbushur nga subjekti mbështetës “Silver” shpk, 30 Kosha të transportit të mbetjeve të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapakë me faturë Dion-AL- shpk nr. X datë 27/8/2025/

III.6.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.6.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë

dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.6.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.6.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: 1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP- së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve

të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi; l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij . Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

III.6.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, gjykoj, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.6.8. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet: 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.6.9. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat për shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet

shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.6.10. Në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.”.

III.6.11. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet: 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.6.12.Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. Sqaroj se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjykoj, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.6.13. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën “2.3.5” konstatoj, se ky i fundit ka paraqitur formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të subjektit mbështetës dhe të vetë operatorit ekonomik pjesëmarrës “AIR” shpk.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “REJ” shpk, konstatoj, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “AIR” SHPK, nuk e ka përmbushur kriterin e sipërcituar. Së pari referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se për disponueshmërinë e mjeteve të pastrimit, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkuar disponueshmërinë e 20 koshave **të transportit të mbetjeve të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapakë**. Këto kosha referuar kriterit të vendosur nga vetë autoriteti kontraktor duhet të përmbushin 3 kriteret: të jenë të mëdhenj, të psoacëm dhe të mbyllur me kapak. Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 30 kosha të njëjtit përshkrim nga subjekti mbështetës dhe 20 kosha disponon në pronësi referuar edhe deklarimeve të faturës tatimore. Referuar faturës tatimore të dorëzuar nga vetë subjekti në procedurën e prokurimit dhe të

administruar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik referuar dokumentacionit të administruar nga ana e autoritetit kontraktor **rezulton se fatura nr. 71 datë 16/8/2024 e deklaruar nga ana e operatorit ekonomik vërteton disponueshmërinë e 20 kazanëve të mbeturinash të vegjël dhe 6 kazanë mbeturinash.** Sa më sipër rezulton se 20 koshat e deklaruar nga ana e operatorit ekonomik si të disponueshme nga ky i fundit në përmbushje të kriterit të vecantë të kualifikimit nuk përmbushin kapacitetin teknik të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor pasi: - janë të vegjël dhe jo të mëdhenj, jo të posacëm dhe jo të mbyllur me kapakë. Konstatohet se ky kriter përmbushet vetëm nga mbështetësi subjekti “Silver” shpk. Gjithashtu sjell në vëmendje se në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar qartë se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;” Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: **“4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”** Në rastin konkret duke gjykuar se operatori ekonomik “AIR” SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “Silver” SHPK, lidhur me plotësimin e kriterit të mësipërm, gjykoj t’i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se: **“4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”** Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik “AIR SHPK si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera duhet të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar rezulton të jetë mbështetur plotësisht te subjekti mbështetës “Silver” SHPK pasi nuk plotëson disponueshmërinë e të paktën 50 % të këtij kapaciteti. Gjykoj se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohej e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar që jo vetëm duhet të deklarohet në dokumentet e ofertës mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera por janë përcaktuar edhe kriteret për këtë mbështetje, njëri prej të cilëve është që në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, dispozitë e cila në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur nuk plotësohet nga ankimuesi pasi ai është mbështetur plotësisht te operatori ekonomik “Silver” SHPK lidhur me disponimin e koshave të mëdhenj. Akoma më tej sqarohet, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në

dokumentet e tenderit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, arrij në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “REJ” SHPK qëndron.

III.6.14. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimes “REJ” shpk, ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës operatorit ekonomik “AIR” shpk, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, gjykoj se, për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë dhe gjendja e operatorit ekonomik “AIR” SHPK faktike juridike pas arsyetimit të mësipërm do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Sa më sipër, pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimes “REJ” SHPK nuk merren në shqyrtim.

Si rrjedhojë e arsyetimit të bërë më sipër, për disa prej pikave të vendimit të themelit të cituara në këtë mendim me të cilat nuk jam dakort, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 34 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, gjykoj:

1. Të pranoj ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: “Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit duke kualifikuar operatorin ekonomik “Rej” SHPK në përputhje me konstatimet e mësipërme.
3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit duke skualifikuar operatorin ekonomik “Air” SHPK në përputhje me konstatimet e mësipërme.
4. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

5. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK.
6. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
7. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
8. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Rej” SHPK dhe “Clean Fast” SHPK.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
11. Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

Anëtar

Gjergj Mersini